

SHOQATA E TË BURGDSURVE POLITIKE TË KOSOVËS
LIDHJA E HISTORIANËVE E KOSOVËS "ALI HADRI"



**MASAKRA
NË BURGUN E DUBRAVËS
19 – 24 MAJ 1999**

Sesion shkencor, më 23 maj 2004

Massacre in the Prison of Dubrava 19 – 24 May 1999

Scientific Session, on 23 May 2004

PRISHTINË, 2005

Këshilli organizativ

**Selatin Novosella (kryetar), Prof. Dr. Muhamet Pirraku,
Bajrush Xhemaili, Bislim Zogaj, Kadri Dërguti, Ismet Mahmuti, Ukë
Thaçi, Besim Zymberi, Enver Dugolli, Hajredin Hyseni, Mr. Adem
Murati, Isak Shabani (anëtarë) dhe Xhevat Haziri (sekretar)**

R e d a k t o r

Prof. Dr. Muhamet Pirraku

*MBAJTJEN E SESIONIT SHKENCOR E NDIHMOI
A V N I M A X H U N I, P R O N A R I F I R M Ě S “R E Z I S T E N C A” N G A
P R I S H T I N A, K U R S E P Ě R G A T I T J E N D H E B O T I M I N E L I B R I T E
F I N A N C O I S H I Q E R I I D R I Z M O R I N A N G A H O D O N O C I I
D A R D A N Ě S, P U N Ě T O R N Ě Z V I Ć Ě R - K U S H T U A R V Ě L L A I T,
M U S A H I D R I Z M O R I N A, I L I N D U R M Ě 1 0 N Ě N T O R*

**1966, I SHKOLLUAR NË VENDLINDJE DHE NË GJILAN, I
ARRESTUAR NË DARDANË DHE I MARTIRIZUAR NË BURGUN E
DUBRAVËS, MË 22 MAJ 1999.**

**“Fëmijëve, nënave, pleqve që do t’i takosh, thuaju se Papa
është me ta e me ta do të jetë përherë, derisa të gëzojnë një paqe
të drejtë e të qëndrueshme. Tepër gjak e tepër lot ka parë të
rrjedhin kjo popullsi gjatë gjithë shekullit XX”.**

Gjon Pall II - Imzot Cordes-It, më 31 mars 1999

*** * ***

FJALA E HAPJES E KRYETARIT TË SHBPK-SË

Të nderuara familje të të pushkatuarve në
Burgun e Dumbravës,
Të nderuar të mbijetuar të Masakrës së Dubravës,
I nderuari Kryeministër i Kosovës,
Auditor shumë i respektuar,

Pas copëtimit të tokave etnike shqiptare më
1913 dhe mbetjes së territoreve të banuara
plotësisht, ose me shumicë shqiptare, nën pushtimet
e Serbisë, të Malit të Zi dhe të Greqisë, populli
shqiptar nuk pushoi së përpjekuri t’i ribashkonte
territoret e copëtuara në një shtet natyror, të
përbashkët – në Shqipërinë Etnike. Për të arritur në
ditët e lavdisë më të madhe, në ditët e fitoreve të
Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat sa kemi nisur t’i

jetojmë, u deshën një det përpjekjesh, sakrificash dhe luftërash. “Në rrugën e dritës, dritën e syve duke lypur, hijet më kanë ndjekur, hijet më kanë mbytur,” – do të thoshim me vargjet e një poeti, i cili një pjesë të jetës e kaloi në qelitë e burgjeve të Serbo-Jugosllavisë.

Në këtë *Rrugë të Dritës*, me organizime herë në fshehtësi të thellë e herë të hapur (në grupe, në organizata e në parti politike), me ngritje flamujsh e me shkrime parullash, me greva e demonstrata, gjithnjë me sy e me zemër nga Tirana, u burgosën mijëra veprimtarë të devotshëm të çështjes kombëtare.

“Që nga viti i largët, 1945, e këndej, për asnjë ditë të vetme burgjet e Jugosllavisë nuk ishin pa të burgosur politikë shqiptarë, ku mbi 80% e të gjithë të të burgosurve politikë ishin mu të burgosurit shqiptarë” – do të konstatojë i pathyeshmi, i pamposhturi – *Adem Demaçi*, i cili me aq pa të drejtë krahasohet me *Mendelën*, në vend që *Ai* të krahasohej me *Demaçin*.

Burg në *Rrugën e Dritës*, para dhe pas *Adem Demaçit - Bacit*, pothuaj për nëntëdhjetë vjet robërie serbo-jugosllave, kishin vuajtur breza e gjenerata të panumërta atdhetarësh. Këta të burgosur, për t'i mbrojtur shokët dhe bashkëveprimtarët e tyre në hetimet e UDB-së famëkeqe, për t'i mbrojtur qëllimet dhe idealin, shumë prej tyre u mbytën nën tortura, vdekje kjo më e tmerrshme nga të gjitha

vdekjet. Të tjerë u dënuan dhe u pushkatuan, me gjyqe ose pa to, kurse shumica dërrmuese pësuan pasoja gjatë vuajtjes së dënimeve në kazamatet e *Goli Otokut*, të *Nishit*, të *Mitrovicës së Sremit*, të *Beogradit*, të *Spuzhit*, të *Idrizovës*, të *Lepogllavës* e të *Stara Gradishkës*, e gjithandej *Jugosllavisë Versajase e Avnojiste*.

Në këtë kalvar të sakrificave dhe të vuajtjeve të të burgosurve politikë shqiptarë në Kosovë dhe në viset e tjera të pushtuara nga ngrehina evropianoruse Jugosllavi, një vend tepër të veçantë e zë, gjithsesi, *Masakra serbe në Burgun e Dubravës*, më 19-24 maj 1999. Mendoj se kur të shkruhet historia e Evropës së pas *Luftës së Dytë Botërore*, kjo masakër do të shënohet me shkronjat më të zeza, si ndër krimet më të llahtarshme që kanë ndodhur në një institucion në të cilin me ligjet ndërkombëtare, edhe në kohë luftërash, së bashku me shkollat, me çerdhet e fëmijëve dhe me spitalet, janë strehe të shënuara me flamuj të bardhë, neutralë, më të sigurta dhe më të mbrojtura.

Andaj, ky *Sesion shkencor* i kushtohet pikërisht zbardhjes së kësaj masakre të pashembullt në historinë më të re të botës, ku u ekzekutuan mbi 150 dhe mbi 200 të tjerë, të burgosur shqiptarë, u plagosën. Disa qindra të tjerë u traumatizuan për jetë. Rezultatet shkencore të këtij sesiioni njëkohësisht vihen në themele të aktakuzës me

karakter ndërkombëtar kundër një pushtuesi racist dhe gjakësor, i cili ende synon të rikthehet në Kosovën kasaphanë serbe mbi shqiptarët përreth nëntëdhjetë vjet, e çliruar me luftën çlirimtare të UÇK-së me aleatët NATO në krye me SHBA-të, më 22 qershor 1999.

Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, në kuadër të veprimtarisë së saj shkencore, përveç të tjerash, deri tash ka organizuar edhe këto aktivitete: Më 27 nëntor 1998, me rastin e 30-vjetorit të *demonstratave të '68-tës*, së bashku edhe me *Partinë Parlamentare të Kosovës*, me *Unionin e Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës* dhe me *Këshillin Koordinues të Degëve të Partive Politike të Prishtinës*, ka organizuar Sesionin shkencor *Vetëvendosja – kërkesë kryesore e demonstratave të '68-tës*; më 2 prill 2001, me rastin e 20-vjetorit të *Demonstratave të vitit 1981*, së bashku me *Shoqatën e Veteranëve të Luftës së UÇK-së* dhe me *Unionin e Pavarur të Studentëve*, ka organizuar tribunën *Rëndësia historike e Pramverës Shqiptare të '81-shit* dhe më 14 e 15 dhjetor 2002 ka organizuar Sesionin shkencor: *Të burgosurit politikë të Kosovës*, në të cilin u lexuan 37 kumtesa nga studiues të Kosovës, të Iliridës dhe të Shqipërisë.

Duke i dëshiruar punë të suksesshme sesionit shkencor *Masakra serbe në burgun e Dubravës 19 – 24 maj 1999*, ju lus që me një minutë heshtje t'i përkujtojmë dhe t'i nderojmë, së bashku, të

ekzekutuarit dhe përjetuesit e këtij kalvarizmi të shqiptarësisë së Kosovës nga okupatori serb.

Lavdi e përjetshme!

Selatin Novosella

FJALA E KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS

Të nderuar ish të burgosur politikë,
Të nderuar veprimtarë të çështjes kombëtare,
Të mbijetuar të Masakrës së Dubravës,
Historianë të çmuar,
Të nderuar pjesëmarrës të këtij sesioni,

Më lejoni që paraprakisht të përshëndes organizatorët e sesionit shkencor, për njërën prej ngjarjeve më të dhembshme dhe më tragjike të historisë sonë më të re. *Shoqata e të Burgosurve Politikë*, veçanërisht anëtarët e saj, të cilët e kanë përjetuar këtë masakër, e kanë për detyrë të dëshmojnë, të flasin dhe të shkruajnë për të. Ndërkaq, *Lidhja e Historianëve të Kosovës* është e thirrur që këtë ngjarje të përgjakshme në historinë tonë ta shtrojë për ndriçim shkencor, ta zbardhë mbi bazë të fakteve relevante dhe t'ia kalojë kujtesës historike vendore dhe ndërkombëtare.

Masakra serbe e Dubravës nuk ishte e vetme as e fundit që e përjetoj Kosova, por ajo ishte ndërkombëtarisht më e palejueshme, për faktin se

ishte një masakër e planifikuar dhe e zbatuar nga shteti. Në rrethana të luftës, të burgosurit janë kategoria njerëzore më e mbrojtur në një zonë ndërluftuese dhe sipas të gjitha konventave ndërkombëtare për luftën, përkujdesjen ndaj të burgosurve e ka shteti që i ka arrestuar.

Të burgosurit kosovarë në burgjet e okupatorit serb fillimisht ishin të burgosur politikë, më pastaj u shndërruan në pengje dhe në robër të luftës nga shteti serb. Së këndejmi, kjo tragjedi meriton jo vetëm vëmendjen e historianëve dhe të juristëve, por edhe të humanistëve në përgjithësi. Ajo duhet të ndriçohet në tërësinë e saj dhe t'i bëhet e njohur opinionit botëror dhe brezave të ardhshëm.

Për shkak të së ardhmes dhe lirisë, ne jemi ithtarë të idesë se duhet të falim, por jo edhe të harrojmë. Amnisti po, amnezi jo.

Ne jemi të vendosur të luftojmë çfarëdo forme të urrejtjes dhe të dhunës mbi baza etnike, racore, ideologjike, religjioze etj. Institucionet e Kosovës, *Qeveria* që kryesoj, është thellësisht e angazhuar të hapë perspektivë për qytetarët e Kosovës, të ndërtojë shtetin e së drejtës, garantues i lirisë dhe i demokracisë për të gjithë.

Uroj që nga ata që e përjetuan këtë masakër dhe nga studiues të historisë, kësaj masakre do t'i ngritet një monument i madh përkujtues shkencor,

derisa institucionet shtetërore të fitojnë fuqinë e duhur, për të ngritur një monument të vërtetë, ashtu siç bëjnë shtetet dhe kombet e qytetëruara.

Edhe një herë i uroj punë të mbarë dhe suksese këtij sesi.

Ju faleminderit

Dr. Bajram Rexhepi

FJALA E KRYETARIT TË KMDLNJ TË KOSOVËS

Të mbijetuar të nderuar të Masakrës së Dubravës,
I nderuari Kryeministër,
Zonja dhe zotërinj,

Marr pjesë në sesionin shkencor “*Masakra serbe në Burgun e Dubravës 19-24 maj 1999*” për të përshëndetur organizuesit e këtij sesi dhe për të ndarë me ju, pjesëmarrës të nderuar, dashurinë dhe dhembjen e njëkohshme ndaj martirëve dhe të mbijetuarve të kësaj masakre. Në këtë ambivalentë ndjenjash, fjalën time të shkurtër dua ta filloj me mendimin se ky sesion shkencor, në mënyrën më të mirë, ndërpret heshtjen tonë ndaj zbardhjes të së vërtetës për kampin e përqendrimit dhe të shfarosjes së shqiptarëve në Dubravën e viteve tetëdhjetë e nëntëdhjetë të shekullit njëzet.

Pikërisht me mënyrën e masakrimit të rreth 150 pengjeve shqiptare dhe me plagosjen e mbi 200 pengjeve të tjera u manifestua tendenca e krimit më të rëndë të organeve të pushtetit serb ndaj shqiptarëve, sepse nga të gjithë tipat e masakrave ndaj shqiptarëve masakra në *Burgun e Dubravës* e dëshmon plotësisht projektin e shtetit të *Milosheviqit* për krime dhe gjenocid ndaj shqiptarëve të Kosovës të viteve nëntëdhjetë dhe vërteton këto fakte:

- “Mëshira” e okupatorit të Kosovës kishte humbur kuptimin e së drejtës humanitare në luftë, sepse:

- Duke ndryshuar destinimin e objektit të *Burgut të Dubravës* dhe duke mos përdorur simbole ndërkombëtare për objekte të burgosurish *Shtatmadhoria serbe* ka gënjyer forcat ndërkombëtare të paqes;

- Epshet e ulëta të gardianëve dhe të trupave mbrojtës të të burgosurve kanë lejuar që zemrat njerëzore të shqiptarëve t’u jepeshin për ushqim eprorëve të tyre të pangopur, sepse:

- Derisa në luftërat ballkanike të viteve 1912/13 suksesi i ushtarit serb matej me numrin e krerëve të prerë të “*arnautëve*”, tash, pas afër nëntë dekadash, suksesi ushtarak i serbëve të rekrutuar në ushtrinë dhe në policinë serbe matej me numrin e shqiptarëve civilë të robëruar e të masakruar që do

të mund t'ua vinin në dispozicion kolonelëve dhe kryekomandantit të ushtrisë serbe, dhe sepse:

- Tendenca e krimit kundër njerëzimit dhe e gatishmërisë për gjenocid ndaj shqiptarëve nga ana e organeve të pushtetit serb u tregua e pranishme dhe e qëndrueshme si gjithmonë.

Masakra serbe e Dubravës, e majit të vitit 1999, është “ballkë” përforcuese e zinxhirit të pandërprerë të krimit të rëndë, e cila, po qe se nuk ndriçohet në pikëpamje historiografike, juridike, politiko-logjike, sociologjike etj., i dëmton keq virtytet e lirisë, të humanizmit e të paqes në këtë vend, ku *Organizata e Kombeve të Bashkuara*, me gjithë fuqinë e vet, strategjinë serbe të tokës shqiptare të djegur, po përpiqet ta zëvendësojë me strategji të rendit e të paqes, të lirisë dhe të mirëqenies.

Ne, vendorët, kosovarët në përgjithësi, me heshtje të paarsyeshme ndaj masakrimit dhe institucioneve të masakrimit ndaj shqiptarëve po vështirësojmë dhe po e pengojmë realizimin e mesazheve për liri dhe pavarësi të Kosovës. Prandaj, heshtjen e gjertanishme të *Masakrës serbe në Burgun e Dubravës* e konsideroj fshehje të krimit më të rëndë që kanë bërë forcat serbe ndaj shqiptarëve, të cilin krim, në mënyrë të modifikuar, duke heshtur, sikur po e mbështesim edhe ne.

Zonja dhe zotërinj,

Në vitet '90-ta të shekullit njëzet të gjithë shqiptarët e Kosovës kanë qenë në burg. Ndërkaq, rreth 1000 veta kanë qenë në kampin e përqendrimit, në kampin e vdekjes e të shfarosjes në Dubravë. Sasia dhe niveli i njohurive tona për këtë kamp është i pamjaftueshëm dhe jo i plotë. Ne, as pas pesë vitesh nuk dimë saktësisht sa shqiptarë kanë qenë në këtë kamp, çfarë ka qenë struktura vendore, moshore, gjinore dhe e përkatësisë politike të tyre. Ende nuk janë zbardhur format e dhunës e të torturimit dhe të masakrimit të tyre.

Mjerisht, okupatori i ka fshehur ose i ka asgjësuar argumentet e krimit dhe tashti, hëpërhë, kemi pak informacione e dëshmi për përqendrimin e të burgosurve në kampin e përqendrimit e të shfarosjes në Dubravë dhe kjo çështje e dhembshme e tragjike as nuk është prekur deri me këtë sesion.

Këtu duhet të theksohet ky fakt: Pavarësisht se autorësia e kësaj masakre i atribuohet pushtetit serb, përgjegjësia individuale e udhëheqësve të këtij kampi, e gardianëve dhe e eprorëve të tyre, ende nuk është ndriçuar.

Le të jetë ky sesion shkencor ngacmues që troket në ndërgjegjen tonë e të kompetentëve ndërkombëtarë.

Ju dëshiroj sukses në punën e përbashkët.

Prof. dr. Pajazit Nushi

Prof. Dr. Muhamet Pirraku

**PLATFORMAT SERBE PËR PLOJAT DHE MASAKRAT
MBI SHQIPTARËT NË FUNKSION TË STRATEGJISË GJENOCIDALE**

Platformat serbe për plojat dhe masakrat ndaj shqiptarëve datojnë nga periudha e ngritjes së shtetit të Serbisë. Ato i përuroi vojvoda *Milosh Obrenoviç*, me urdhëresën e vitit 1832: *T'i jepen "25 të rëna me shkop"* akëcilit shqiptar a boshnjak që do të kapet në *Principatën e Serbisë*, kurse më 1834 përdori ushtrinë *"për t'ua djegur fshatrat"* dhe *"kuartet në qytete"*, ngase shqiptarët dhe boshnjakët ishin vu në lëvizjen kombëtare për çlirimin nga *Perandoria Osmane* dhe çlirimi i *Shqipërisë* dhe i *Bosnjës* do të bëhej pengesë për zgjerime të reja të *Serbisë*.

Këtu e tutje të gjitha *zgjerimet e Serbisë me toka të Shqipërisë* u kryen me përdorim të ployave dhe të masakrave ndaj popullsisë shqiptare. Kjo strategji ishte institucionalizuar me platformën politike dhe juridike të shtetit serb nacional - *"Naçertania"* të vitit 1844, ku thuhej: *"Serbia duhet të orvatet që nga godina e shtetit turk të heqë vetëm gur pas guri e t'i marrë ato që mundet nga ky material i mirë dhe mbi themelin e vjetër e të*

mirë të perandorisë së lashtë serbe të ndërtojë sërish e të mund të ngritë shtetin e ri serb”.

Vërtet, në periudhën e *Krizës Lindore* nga fillimvitet e '50-ta të shekullit XIX dhe të *Luftës rusoturke të viteve 1877-1878*, një botë e tërë e krishterë (evropiane e ruse), do të përlyhej me gjakun shqiptar. Madje, historiografia serbe kurrë nuk e ka fshehur urdhëresën e *Princ Milan Obrenoviçit* për ushtarakët e paramilitarët serbë: *"Sa më tepër shqiptarë të shpërngulni, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja para atdheut...!"*. Urdhëresa kishte forcën e ligjit serb për etnocit ndaj shqiptarëve. Me strategjinë *"Toka e djegur"* u bë spastrimi shqiptar etnik i mbi 640 fshatrave dhe qyteteve shqiptare të *Sanxhakut të Nishit*.

Bashkëkohësi dhe përjetuesi i mizorive kanibaliste obrenoviçiane, *Mita Petroviq*, duke folur për pushtimin e *Toplicës* dhe të *Kosaonicës* nga ushtria serbe, u ndal në mynxyrat në fshatin *Topanicë*, ku kishte 500 familje shqiptare. Shkroi: *"Në fshat pati gra dhe fëmijë, por askush nuk i shpëtoi dënimit. Të gjithë u vranë..."* Sipas kësaj strategjie u masakruan më se 70 mijë shqiptarë nga të dy gjinitë dhe nga të gjitha moshat.

Aeropagu evropian - *Kongresi i Berlinit* (13 qershor – 13 korrik 1878) e shpërbleu gjenocidin e krishterë ortodoks të shteteve fshqinje të Shqipërisë, duke ua njohur të drejtën në rreth $24\,458\text{ km}^2$ të tokës

shqiptare. Viset e aneksuara u dealbanizuan sipas strategjisë “*Toka e djegur*”, duke shpërngulur me dhunë etnocidale të llahtarshme rreth 250 – 300 mijë shqiptarë etnikë. Pas copëtimit ndërkombëtar të përgjakshëm, më 1878, *Njësia etnokulturore dhe gjeopolitike e Shqipërisë*, e ndarë në katër njësi administrative dhe ushtarake osmane, kapte 90 100 – 90 270 km².

Në prag të copëtimit të dytë, më 1912/13, *Shqipëria* kishte 3 804 000 banorë, prej të cilëve mbi tre milionë shqiptarë. Këso kohe *Vilajeti i Kosovës* kishte 32 900 km² me mbi 1 270 000 banorë. Shqiptarët përbënin mbi 65% të banorëve, kurse të tjerët ishin bullgaro-maqedonas, vllah (cincarë), serbë, turq, romë, ebrej etj. Territori i Kosovës aktuale, prej 10 887 km², më 1912, kishte vetëm rreth 3.7 për qind serbë, ndonëse *Cvijiq* flet për 5 për qind.

Viti 1912, me *Kryengritjen e Përgjithshme të Shqipërisë* nën udhëheqjen e *Hasan Prishtinës*, shënoi kthesën vendimtare për *autonominë e Shqipërisë*. Për ta penguar këtë fitore shqiptare, *Rusia* e hodhi në luftë *Aleancën ballkanike*, nën parullën: “*Luftë për t'i çliruar popullsitë e krishtera nga pushtuesi shekullor turk dhe nga tirania islame...!*”. Së këndejmi, meqë kombi shqiptar në vendin *Shqipëri* ishte rreth 88% i përkatësisë fetare myslimane, lufta e *Aleancës ballkanike* në fakt ishte ndërmarrje kulturocidale, etnocidale dhe

gjenocidale sllave e greke ortodokse antishqiptare me përkrahjen e Ruisë dhe të Evropës.

Çdo rezistencë shqiptare do të shuhej me gjak, ploja e masakra të shpërblyera nga Rusia dhe Evropa ngjashëm me ato në vitet 1877-1881, të rezistencës së *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*. Për këtë fakt fliste qartë proklamata shqip me cirilik: "*T'ton fiseve n'Shqipni, Or vllažni!*", e gjeneralit *Bozhidar Janke*, drejtuar shqiptarëve porsa soldateska serbe shkeli në *Mërdar e Përpallac*, më 18 tetor 1912. Në këtë thirrje vihej në pah kërcënimi barbar kanibalist serb ndaj shqiptarëve: "*Pushkë'n kemi me qit m qato qi qet me nee, elle na lasht zoti, shkrum kemi me e bo qat shpi, e katundin, qi na kten pushkë'n, e qato qi na pret vllažnisht kemi me prqaf vllažnisht, si kur vllau vllaun, se po bim m një dor: bes'n e zotit, drejtn e njerzın, e me qetrn po bajim arm e zjarm...!*"

Këtë platformë serbe për plojat mbi qenien shqiptare të Kosovës historike e legalizonte ndërkombëtarisht kërkesa publike e *princit* të Serbisë, *Aleksie Karagjorgjeviç*, porsa shkeli në tokën shqiptare në vise të Kumanovës: "*Unë dëshirojë vetëm që këtu të vijnë disa mijëra njerëz evropianë me përgjegjësi e të shohin shqiptarët, të cilët ne i kemi zënë robër, dhe ata të binden se këta njerëz mezi mund të quhen njerëz dhe të përfitojnë bindjen se Ballkani patjetër duhet të spastrohet nga këto egërsira...!*"

Fitorja e *Aleancës ballkanike* u kurorëzua në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, e cila, nga Shqipëria e vitit 1912, shpërndi 61 510 km² dhe mbi tre milionë banorë me shumicë absolute shqiptare. Konferenca e Londrës, më 29 korrik 1913, e aprovoi projektin e "*Principatës së Shqipërisë*", një shtet shëmtirë, pa trup të plotë, tepër i gjymtuar, pa asnjë gjymtyrë për jetë. Ky shtet do të kishte rreth 28 760 km² me rreth 800 mijë banorë.

Okupatorët serbë, malazez, bullgarë e grekë, më 1912/13, ushtruan kulturocid, etnocid dhe gjenocid në tokat shqiptare njësoj si në vitet 1877-1881. Mbi platformën e këtij shkretimi hodhën dritë tre bashkëkohës. Ushtaraku serb *Dimitrie Tucović*, socialist, duke informuar opinionin për krimet serbe në një fshat shqiptar në *Lumë*, më 1913, shkroi: "*Fshati ka qenë i zhdukur për dy orë, me skena që është vështirë të pasqyrohen. Plutonët kanë rrëzuar gratë që mbanin foshnjat në gjë; pranë nënave të vdekura klithnin foshnjat e tyre, të cilat qenë të kursyera rastësisht nga plumbat; trupat si bredh të malësoreve të bukura janë gërryer si krimbat nëpër lëndinë; gratë kanë lindur nga frika, për dy orë janë likuiduar rreth 500 shpirtra (...), kufomat janë hedhur në shtëpi, e shtëpitë janë djegur – ashtu që krimet t'i mbulohet gjurma. Kjo është e vërteta për këtë egërsi të tmerrshme*".

Ky pasqyrim është më i plotë po t'i shtohet konstatimi i socialistit, *M. Kacleroviç* - "*Armata serbe*

ka djegur 35 fshatra shqiptare, pa u lejuar banorëve të tyre që të largohen (...). Armata serbe me urdhrin e qeverisë së vet ka masakruar 120 mijë shqiptarë”. Sipas të dhënave të sistematizuara nga studiuesi italian, *A. Baldacci*, - *“janë nja 150 mijë shqiptarë të vrarë nga serbët në vitin 1912-13”*.

Vërtet, të dhënat burimore flasin qartë se gjatë luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore në viset e Shqipërisë Etnike, përpos numrit të të vrarëve të përmendur më lart, me strategjinë *“Toka e djegur”* u rrafshuan përtokë mbi 800 lokalitete shqiptare dhe mbi 500 mijë shqiptarë u ndoqën në Azë e gjetkë. Po kështu, nga dhjetori i vitit 1918 e deri në përmbylljen e Paqes së Versajës - Parisit, më 1920, në viset shqiptare u zbatua kanibalizëm serbo-jugosllav. Sipas të dhënave të Shtabit të Luftës së Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare, të përmbledhura në Proklamatën e fillimtëtorit 1945, *“në vitin 1918, gjatë krijimit të Jugosllavisë mozaike, prapë sipas urdhrin të Beogradit, janë therë dhe mbytur mijëra shqiptarë. Aso kohë në Konferencën e Paqes është sjellë regjistri për tetëdhjetë mijë viktima, i përcjellë me një protestë energjike, por edhe kjo, si gjithëherë, “Vox clamantis in deserto” për veshët e Evropës.*

Për të mashtruar opinionin botëror dhe aktorët e Konferencës së Versajës, Komanda Supreme e Ushtrisë së Jugosllavisë udhëzonte çetat terroriste të spastrimit etnik shqiptar të terrenit, që vrasjet,

therjet, gjenocidin ndaj shqiptarëve, djegiet e fshatrave e të lagjeve të qyteteve t'i kryenin pa bujë, fshehurazi nga opinioni publicistik e diplomatik, me sqarimin se "*pas nënshkrimit të Traktatit të Pages do t'i kemi duart e lira kundër shqiptarëve!*". Dhe, vërtet, më 23 gusht 1919, *Komanda Supreme e Ushtrisë Jugosllave* i urdhëroi ushtrisë dhe njësisë paramilitare terroriste të rrafshonin përtokë çdo fshat nga i cili do të shtihet nga pushka e rezistencës shqiptare dhe të vritet, aty për aty, secili shqiptar i arratisur! Kjo do të thoshte: legalizim institucional serbo-sllav i vrasjeve dhe i masakrave ndaj shqiptarëve.

Nga dokumentet e prejardhjes shqiptare, dërguar *Konferencës së Versajës*, shihet se numri i shqiptarëve në viset e njësisë etnokulturore e gjeopolitike të Shqipërisë së vitit 1912, kishte rënë nën numrin e shqiptarëve të viteve të 50-ta të shekullit XIX. Tashti në arealin e *Shqipërisë Etnike* kishte vetëm 1 779 929 frymë (833 000 në arealin e *Shqipërisë londineze* dhe 946 929 në viset shqiptare të aneksuara Jugosllavisë dhe Greqisë). Del se, vetëm midis viteve 1912-1920, numri i shqiptarëve në *Shqipërinë Etnike* ishte zvogëluar për mbi 1 220 000 frymë dhe kjo pa shtimin natyror të tre milionë shqiptarëve, sa kishte më 1912.

Madje, shqiptarët, për shkak se ishin kryesisht popullsi myslimane, nga pseudoshkenca serbe, edhe më tutje, do të paraqitën, para botës së krishterë

antiislame, si masë amorfe e dekompozuar nga aspekti frymor e civilizues, pa perspektivë nacionale, e denjë për asimilim në serbë si akt civilizues. Për këtë synim propaganda antishqiptare serbe kishte mbështetje pa rezervë në qarqe të caktuara evropiane. Ja një shembull eklatant: *Herman Vendel*, më 1920 dhe 1921, *shqiptarët do t'i paraqesë "popull rudiment ballkanik gjysmë të egjër, të dëmshëm për civilizimin evropian"* dhe gjenocidin serb mbi shqiptarët do ta arsyetojë si masë të nevojshme të *"civilizimit të krishterë"*, sepse, sipas tij, *"historia nuk mund të durojë kërcënimet mijëra vjeçare (...) të një race që po vdes...!"?!*

Shfarosja mbi këtë platformë serbe për kulturocid, etnocid dhe gjenocid ndaj shqiptarëve vazhdoi gjatë tërë kohës së *Jugosllavisë Versajase*. Kjo ishte strategji serbe *"Toka e djegur"*, me pretendime të qarta: *"Të ndërronin fizionominë e viseve të banuara pastër me shqiptarë"* - do të konstatojë shtypi socialist jugosllav. *"Jamjanët e Afrikës nuk mund të bëjnë atë që serbët u bëjnë shqiptarëve të Kosovës"* - do të konstatojë *Hasan Prishtina* në qershor të vitit 1921, në *Parlamentin e Shqipërisë Londineze*.

Sipas venerimeve të *Trockit* të famshëm në vendin e ngjarjeve të përgjakshme, në Kosovën e viteve '20-ta të shek. XX: *"Ekzistonte një ndarje e punëve. Nëse ishte në pyetje ndonjë kaçak, shtëpitë e tyre së pari do t'i shkatërronte ushtria e rregullt. Më pastaj vinin në*

radhë rezervistët të cilët kryenin pjesën e tyre të punës. Pastaj vinin pjesëtarët e policisë e më në fund komitët".

Se ky qellim po realizohej me bekim të Evropës, mund të vërtetohet edhe me një të vetmin prononcim të përfaqësuesit të Jugosllavisë në *Shoqatën e Popujve* në Gjenevë, më 13 mars 1929, i cili, pa i luajtur gjaku në fytyrë, do të gënjejë: "*Në vendet tona jugore, të cilat kanë qenë pjesë përbërëse të shtetit tonë, ose i janë ndarë Mbretërisë sonë para 1 shkurtit 1913, nuk ka pakica kombëtare*" !?! Ky është morali i diplomacisë dhe i gjenit pushtues serb.

Në funksion të platformës serbe për dealbanizimin e tokave shqiptare, krahas ployave mbi shqiptarët, ishte edhe sjellja e elementit sllav në trojet e tyre. Këtë fakt e pasqyronte mirë një *Anonim* nga Peja në organin e PKJ-së, "*Proleter*", më 15 dhjetor 1929: "*Ne, shqiptarët, jemi të detyruar që t'ua ngrehim shtëpitë (kolonistëve). Me paratë tona jemi të detyruar të blejmë konopin me të cilin do të na varin neve (...). Fshatra të tëra po i kallin, që t'u bëhet vend kolonistëve. Me pushkë, mitraloza dhe bomba po ndjekin mijëra e mijëra familje shqiptare nga vatrata e tyre". Në këtë frymë konstatonte, më 15 shtator 1931, edhe organi "*Liria Kombëtare*" e Gjenevës: "*Afer një milion njerëz po shpërngulen nga pushteti serbomadh*" dhe se "*me thikë po kryhet serbizimi i emrave të njerëzve dhe të fshatrave, që kështu të shlyhej çdo dëshmi shqiptare, që të ndryshohet karakteri etnik i Kosovës*".*

Me aspirata të tilla në vijimësi u thellua spastrimi etnik shqiptar i Kosovës në vitet e 30-ta. Madje, më 1937, qarqet akademike, politike dhe ushtarake serbe kërkonin që brenda një afati shumë të shkurtër *përqindja e elementit sllav - serb e malazez në Kosovë të ngrihej në 67.5%, kurse përqindja e shqiptarëve nga 80% të zbritej në 21.5%*. Në urdhëresat për policinë dhe administratën vendëse në Kosovë kishte edhe ankesa: *"Serbisë Jugore nuk po i kushtohet kujdes i duhur. Nëse ajo bëhet serbe, do të zgjidhet çështja jugosllave"*. Për ta arritur këtë, kërkohej që të largoheshin edhe *400 mijë shqiptarë nga Kosova për në Turqi*, dhe krahas *143 mijë kolonëve serbo-malazez të sjellë deri më 1937, të silleshin edhe 470 mijë kolonë me prejardhje etnike sllave*.

Në shërbim të këtyre planeve u futën akademikët, shkrimtarët, profesorët universitarë serbë, të tubuar në *"Srpski Kulturni Klub"* të Beogradit. Megjithatë, *Elaborati* i akademikut *Vasa Çubriloviç: "Iseljavanje Arnauta"* (Shpërngulja e shqiptarëve), i datës 7 mars 1937, është *projekti* më ogurzi që njohu historia për *kulturocid, gjenocid dhe etnocid* ndaj një populli të tërë dhe që do të mbetet i pavërejtur dhe i padënuar nga bota e qytetëruar, nga Evropal?!

Në këtë projekt saktësohej: *"Të pëmbledhim: Shqiptarët është e pamundur të zhbduken vetëm me kolonizim permanent; ky është populli i vetëm i cili ka*

arritur që në një mijë vjetët e fundit jo vetëm të qëndrojnë para bërthamës së shtetit tonë, Rasës e Zetës, por që edhe në dëmin tonë t'i shtyjë kufijtë tonë në drejtim të Veriut e të Lindjes (...). Mënyra e vetme dhe mjeti i vetëm - për zhdukjen e shqiptarëve dhe të shqiptarësisë së Kosovës - është forca brutale e një pushteti të organizuar shtetëror, për çka ne jemi bindur mbi ta (...).

Mbetet vetëm shpërngulja në masë (...) E që të sigurohet shpërngulja masive, kusht i parë është krijimi i një psikoze të përshtatshme. Ajo mund të krijohet në shumë mënyra (...). Për këtë në radhë të parë, për shpërnguljen e shqiptarëve duhet të bëhen për vete klerikët dhe paria e tyre, ose me para ose me kërcënime (...). Mjeti tjetër do të ishte presioni i aparatit shtetëror (...), që sa më shumë t'u mërzhitet ekzistenca shqiptarëve te ne: gjobitje, burgosje, përdorimi i pashpirt i të gjitha rregullave policore, dënimi i kontrabandës, prerja e pyjeve, maltretime, ndërsyerja e qenve, detyrimi në angari dhe me të gjitha mjetet e tjera të cilat është në gjendje t'i gjejë një polici praktike.

Ekonomikisht, mosnjohja e tapive të vjetra, puna në kadaestre në ato vise, duhet përnjëherë të përfsihien me ngarkesa tatimore dhe me të gjitha borxhet zyrtare e private; marrja e kullosave shtetërore, kullosave bashkiake, ndërprerja e koncesioneve, lejeve për punë, ndjekja nga shërbimet shtetërore, private dhe vetëqeverisëse(...).

Në çështjet fetare, shqiptarët janë më të ndjeshëm, ndaj edhe aty duhet të preken. Ajo mund të arrihet me maltretime të klerit, kthimi i varreve në tokë pune (...).

Kolonistëve tanë, sipas nevojës, duhet t'u ndahen armë. Në këto vise duhet të plasohet aksioni i vjetër çetnik dhe në mënyrë sekrete të ndihmohen në detyrat e tyre (...).

Kallja fshehtë e fshatrave dhe e lagjeve shqiptare në qytete" - të gjitha këto sipas planeve paraprake të sfiduara nga "punëtorët shkencorë të Universitetit dhe të Akademisë", dhe i tëri ky plan për zhdukjen shqiptarëve t'i dërgohet Gjeneralshtabit Madhor të Jugosllavisë, sepse "nga arsyet pastër të mbrojtjes popullore ushtria jonë ka interes që në kufij veçanërisht të ndjeshëm të kolonizojë element të vetë".

Është e pamundur që këtu të pasqyrohet tërë kompleksiteti i politikës kulturocidale, gjenocidale dhe etnocidale kanibaliste serbosllave midis *Dy Luftërave Botërore* ndaj shqiptarëve, por as nuk mund të pasqyrohen të gjitha mënyrat e rezistencës për mbijetesë shqiptare kundër asaj dhune. Vetë Kryeministri i Jugosllavisë, me aktin sekret të datës 16 prill 1937, ua tërhoqi vërejtjen subjekteve zbatuese të shfarosjes së shqiptarëve se *në Serbinë Jugore ka ende më së paku 900 mijë shqiptarë, të cilët banojnë vise kompakte dhe i urdhëronte pushtetit të zbatonte masa ekonomike shfrytëzuese e shkatërruese të rrepta, "në mënyrë që shqiptarët të jetonin nën psikozen e skamjes permanente".* Ndërkaq, Ministri i Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, me aktin tepër rezervat të datës 29 dhjetor 1937, urdhëroi të gjitha instancat

pushtetore, "që të dhënat për pakicat kombëtare (...) në të ardhmen, të mos publikohen pa lejen e kësaj ministrie!"

Madje, duhet të vihet në spikamë se *Gjeneralshtabi i Ushtrisë së Jugosllavisë*, duke vlerësuar se pushteti civil dhe policor nuk po ia dilnin të shfarosnin popullin shqiptar në viset e aneksuara Jugosllavisë Versajase, kërkoi, më 1938, nga *Ministria e Ushtrisë* që *thyerjen e shqiptarëve t'ia lëshonte në kompetencë elementit serb e malazez dhe ushtrisë, që do të thotë: paramilitarëve çetnikë të ndihmuar nga ushtria*. Më tutje, saktësonte: "Ushtria jonë do të ketë për detyrë, si edhe deri tashti, e posaçërisht tashti, që në këto vise të kryejë detyrën e vet shtetërore dhe misionin nacional dhe kulturor".

Këtu tashti duhet të theksohet fakti se në prag të *Luftës së Dytë Botërore* një pengesë madhore për shfarosjen e shqiptarëve në *Jugosllavi* paraqiste ekzistimi i *Shqipërisë Londineze* si shtet. Për t'u liruar nga kjo pengesë, *Jugosllavia* u lidh me të gjitha shtetet që synonin një copë të *Shqipërisë Londineze*. Nga fundi i vitit 1938, *Jugosllavia* do t'i imponohet *Greqisë* dhe *Italisë* për një *aleancë* për ndarjen e *Shqipërisë së Ahmet Zogut*, me çka do të krijoheshin rrethana për zhdukjen fizike dhe asimilimin e tepricës shqiptare në serbë, në grekë dhe në italianë. "*Aneksimi i pjesës Veriore dhe të pjesës së Shqipërisë së Mesme shtetit tonë është një nga interesat jetësore të popullit tonë. Kjo do të ishte realizimi i aspiratave tona natyrore dhe kënaqja e dëshirave tona shekullore!*" - i shkruanin kryetarit të qeverisë

mbretërore të Jugosllavisë, duke i theksuar edhe këtë:

"Në popullin tonë kurrë nuk ka pasur simpati për shqiptarët as herët as sot. Janë shikuar si armiq të vendit tonë dhe të popullit tonë. Në kombinacionet tona politike e diplomatike dhe politikën tonë ballkanike gjithmonë kemi synuar që t'i hedhim poshtë të gjitha kërkesat shqiptare për formimin e shtetit të pavarur, nga shkaku i thjeshtë, se ai shtet mund të krijohet vetëm kundër nesh dhe kundër synimeve tona nacionale. Me marrjen dhe aneksimin e Shqipërisë Veriore do të vritet irredenta shqiptare, e cila është shumë e rrezikshme për viset tona jugore. Elementi luftarak shqiptar në territorin tonë do të përfshihej nga lindja dhe perëndimi dhe do të dënohej në asimilim të lehtë".

Mbi këtë platformë serbe kundërshqiptare është ngritur edhe *Elaborati* i akademikut novelist, Ivo Andriç, më 30 janar 1939: *"Me marrjen e Shqipërisë do të zhdukej qendra tërheqëse për pakicën shqiptare në Kosovë, e cila, në situatë të re, më lehtë do të asimilohet!"* Sipas Andriçit, Jugosllavia me këtë zgjerim në Shqipërinë Veriore do të merrte rreth 300 mijë shqiptarë, shumicë katolike, pa rrezik të madh për Serbinë, sepse *"shpërngulja e shqiptarëve myslimanë në Turqi gjithashtu do të zbatohet në rrethana të reja, ngase nuk do të ndodhë kurrfarë aksioni i madh që ajo të pengohet"*.

Sipas direktivave akademike serbe, diplomacia jugosllave kundër qenies shqiptare të Kosovës historike do të mbështetej me vrasje të

personaliteteve shqiptare - "*si të ishin egërsira!*" - gjykonte saktësisht *Lëvizja studentore përparimtare - komuniste* e viteve '30-ta. Këtë strategji shtetërore serbe për shfarosjen e shqiptarëve do ta pasqyrojë bukur kolonisti malazias komunist, *Radovan Zogoviç*, mik i shqiptarëve përjetësisht: "*Pushteti serbomadh bën çdo gjë që më presion ekonomik, me shkollë policore, me ndërprerjen e ndihmave medicinale kundër malaries e të tjera, t'i nxjerrë nga ligji dhe t'i shfarosë banorët shqiptarë...*".

Më herët u tha se me burimet e proveniencës së *Shoqatës së Popujve* mund të vërtetohet se në *Jugosllavinë Versajase*, më 1920, kishte 946 929 shqiptarë. Sipas shtimit natyror rreth 40 për një mijë, që kishin shqiptarët, deri më 1941 numri i shqiptarëve në Jugosllavi duhej të arrinte në *mbi dy milionë*. Së këndejmi, del se pushteti serbo-jugosllav midis *dy luftërave botërore* likuidoi dhe shpërnguli mbi një milion shqiptarë.

Okupimi nazifashist i tokave shqiptare jashtë *Shqipërisë Londineze*, nga mesprilli 1941, ndonëse erdhi si *infuzion për shqiptarësinë* e tyre në agoni, nuk do ta zgjidhë *Çështjen shqiptare*, kurse *Lufta Nacionalçlirimtare Antifashiste*, krahas popujve të *Jugosllavisë*, do të shfrytëzohet për rianeksimin serb, malazias dhe bullgaro-maqedon as të tokave shqiptare jashtë *Shqipërisë Londineze*. Vërtet, koha e vërtetoi se *Deklarimi i Titos*, më 4 dhjetor 1943, para një reporteri anglez të luftës, se "*ardhmënia e Kosovës*

ka për t'u vendosur me plebishit dhe se kufijtë, nëse tregohet nevoja, kanë për t'u ndrequr në dobi të Shqipërisë", ishte kurth tradhtie për çlirimtarët antinazifashistë shqiptarë, njësoj si edhe Rezoluta e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e 2 janarit 1944, në të cilën ngërthehej kërkesa politike jetike e shqiptarëve:

"Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit asht një krabinë e bannueme në shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë ashtu edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipninin. Rruga e vetme që populli shqiptar i Kosovës e i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipnin asht lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjaksuer dhe rrogatave të tij. Sepse kjo asht rruga e vetme të fitohet liria, kur të gjithë popujt pra edhe shqiptarët do të jenë në gjendje të deklarohen për fatin e vet me të drejtë në vetëvendosje deri në shkëputje.

Garant për këtë asht UNÇJ dhe UNÇSH me të cilën asht e lidhun ngusht. Krahës kësaj për këtë janë garantë aleatët tanë të mëdhej: Bashkimi Sovjetik, Anglia dhe Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)".

Mirëpo, porsa shkeli në tokat shqiptare këmba e partizano-çetnikëve serbë, malazez dhe maqedono-bullgarë, aleatë të Rusisë, të Anglisë, të SHBA-ve dhe të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, UNÇJ-ja e gjuajti lëkurën e qengjit dhe u rivesh me gunën tradicionale të ortodoksizmit kundër qenies së Shqipërisë Etnike. Më 3 dhjetor

1944, prapë V. Çubriloviç, tashti Ministër për Ekonomi i Serbisë kominterniste, lëshoi për përdorim sekret instruksionet për qarqet ushtarake e politike të Jugosllavisë - për *zhdukjen me të gjitha mjetet të shqiptarëve etnikë, të gjermanëve dhe të etnive të tjera josllave "në Jugosllavi"*. Dhe, pasi konstatoi se *"ne kurrë nuk kemi pasur kushte më të mira dhe rast (më të volitsbëm) për vendosjen e çështjes së minoriteteve"*, udhëzonte: *"Krahës spastrimeve ushtarake"*, gjatë operacioneve luftarake përfundimtare, duhet të përdoren edhe mjetet e tjera: *shqiptarëve "t'u merren të gjitha të drejtat, të nxirren para gjyqit ushtarak, të dërgohen në kampe përqendrimi, t'u konfiskohet pasuria dhe të detyrohen për shpërngulje!"*.

Akademiku, me moralin histerik serb, përfundonte: *"Ndoshta kurrë më nuk do të na ofrohen këso rrethanash që shtetin tonë ta kthejmë në vend të pastër etnik"*, dhe përkufizonte qartë se, *"nëse këtë problem nuk e zgjidhim tash, kurrë më nuk do të arrijmë ta zgjidhim!"*

Në përmbyllje, Çubriloviç, duke hedhur poshtë të drejtën e Kosovës për vetëvendosje, të proklamuar nga PKJ-ja para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, u shtronte për detyrë qarqeve politike, ushtarake, gjyqësore e shtetërore në përgjithësi: *"Ne nga Kosova dhe Dukagjini nuk mund të heqim dorë edhe për shkak të rolit të tyre historik dhe rëndësisë edukative nacionale: Krejt deri sa Kosova dhe Dukagjini të mos bëhen përfundimisht*

serbe, gjithmonë serbët dinarikë nuk do të kenë paqe"; "Do të ishte ideale sikur të mund të liroheshim nga të gjithë shqiptarët në vendin tonë dhe atë përnjëherë"; "Me kolonizim nuk është siguruar të thuash asgjë" dhe përfundonte: "Dy janë mënyrat të cilat do të merreshin parasysb për spastrimin radikal të shqiptarëve: që t'i shfarosim ose që t'i shpërngulim!"

Për t'i plotësuar urdhërkërkesat që dilnin nga Udhëzimet e Çubriloviqit, në tokat shqiptare, deri në fundnëntorin 1944, do të përqendrohen 20 - 25 brigada, të quajtura "*partizane*" - serbe, malazeze, bullgare e "*maqedonase*", me udhëzime tepër rezervat: *Nën masën kinse për ndjekje të bashkëpunëtorëve të okupatorit, të vriten personalitetet e shquara kombëtare shqiptare, të provokohen revoltimet e popullsisë dhe në shenjë të shtypjes së "revoltës", të vriten me plumb, thikë e zjarr, më së paku 50% të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera jashtë Shqipërisë Londineze!*

Kjo urdhëresë është zbatuar në masë të madhe. Sipas burimeve relevante nga *mesi i nëntorit 1944 deri në vitin 1947* u vranë mbi 47 mijë shqiptarë. Të vrarë për rëndësinë e shqiptarësisë së Kosovës janë edhe qindra mijëra të shpërngulur me dhunë në Anadoll.

Dhe, më herët u tha se, sipas burimeve ushtarake jugosllave sekrete, në *Jugosllavi*, më 1937, kishte mbi 900 mijë shqiptarë. Sipas regjistrimit të vitit

1948, në Jugosllavi pati 750 431 *shqiptarë*, që do të thotë mbi 149 569 *shqiptarë* më pak se më 1937.

Po të kihet parasysh fakti se shqiptarët nën *Jugosllavi* midis *regjistrimit të 1948-tës* dhe të *1981-tës*, pra për 33 vjet, u shtuan në 1 226 736 *frymë*, ose për 2.7 *herë*, del edhe më marramendës numri i shqiptarëve të likuiduar fizikisht dhe të ndjekur nga Kosova e vendet e tjera shqiptare. Ky tmerr duhej të ishte edhe më rrëqethës kur dihet se 412 000 *shqiptarë* ishin larguar nga Jugosllavia sipas *Marrëveshjes gjentemene Jugosllavi - Turqi* të vitit 1953.

Këtu duhet të saktësohet edhe fakti se *Lidhja Socialiste e Kosovës*, më 1976, kishte të dhëna për shpërnguljen e *një milion shqiptarëve* vetëm nga Kosova midis viteve 1912-1966. Të dhënat jugosllave policore, flasin edhe për mbi 280 *mijë shqiptarë të burgosur* nga viti 1945 deri në vitin 1966, por burgosje të shumta pati edhe në vitet 1967-1980. Ndërkaq, nga pranvera e vitit 1981 *Kosova* ishte në luftë të hapët me *Jugosllavinë*. Burimet e proveniencës gjyqësore dhe policore flasin për rreth 900 *mijë shqiptarë të burgosur politikë*, e të trajtuar në polici, deri në fund të vitit 1991 (750 *mijë* në Kosovë dhe 150 *mijë* në vise të tjera: Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Bosnjë, Kroaci, Slloveni).

Në vitet '90-ta të shekullit XX, Kosova dhe viset e tjera shqiptare nën Jugosllavinë Versajase ishin të nxjerra jashtë ligjit. Të gjitha mynxyrat e

dhunës kulturocidale, gjenocidale dhe etnocidale kanibaliste serbe mbi shqiptarët, prapë, do të ushtrohen me udhëzime publike e sekrete të *Akademisë së Shkencave e të Arteve të Serbisë*, tashti në krye me akad. *Dobrica Qosiç*. Bazën e këtyre udhëzimeve, për zhdukjen e shqiptarësisë së Kosovë dhe të viseve të tjera shqiptare nën *Jugosllavinë Avnojiste*, ngërthente *Memorandumi legal i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë* i vitit 1985.

Ky trakt politiko-policor, në fakt, paraqiste *Projektin për Serbinë e madhe nga Vjena deri në Stamboll*, me prejjudikim se *Serbi është deri aty ku gjendet një serb, ose një varr serbi!* Me pak fjalë, *Akademia e Beogradit* mori mbi vete detyrën që "*popullit serb t'i sigurojë programin shoqëror dhe nacional bashkëkohor, me të cilin do të frymëzohen brezat e sotme dhe të ardhshme*"(!?!)

Këtu duhet të theksohet fakti se në këtë *Memorandum* u projektua një strategji politike serbe plotësisht tjetër nga platformat serbe shekullore për shfarosjen e shqiptarëve. Të gjitha tezat dhe veprimet serbe kundër shqiptarëve këtu u kthyen me kokëtatëpjetë. Çdo veprim antishqiptar i planifikuar dhe i zbatuar nga shteti i Serbisë, së paku nga viti 1832, për shfarosjen e shqiptarëve në Kosovë dhe të shqiptarëve në Ballkan, në *Memorandumin e ASHAS-së* u paraqitën si krim i kryer, si kulturocid dhe etnocid i shqiptarëve ndaj serbëve dhe serbizmit në Kosovë, në një vijimësi

historike nga *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* dhe veçanërisht në periudhën e *Jugosllavisë Avnojiste* pas *Plenumit IV të LKJ-së*, më 1966. Me këtë Memorandum duhet të nxitej *gjakmarrja* dhe *hakmarrja* serbe e jugosllave përfundimtare ndaj shqiptarëve, me theks të veçantë ndaj shqiptarëve myslimanë, që shqiptarësia e Kosovës të zhdukej me një *strategji politike* të pranueshme nga sllavët në veçanti dhe krishterimi në përgjithësi.

Për ta vu në jetë me sukses këtë "*program nacional serb*", *Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë* kujdestaroi në ngritjen politike e shtetërore të personalitetit *Slobodan Milosheviç*, të cilin e nxori në krye të lëvizjes serbomadhe: "*Dogodio se narod*" (Ndodhja e popullit), të mbështetur në trillime, paragjykime dhe në kërkesa historike për ekspansion serb: "*Kosova është zemra e Serbisë*", kurse "*Serbia e Madhe - prej Horgoshit – Virovitiçë e Karllobag deri në Durrës e Selanik*" - do të realizohej duke u mbështetur në "*të vërtetat*", serbe për Kosovën "*serbe*", - pa serbë historikisht, por me pushtet serb dhunues gjakësor prej tetorit të vitit 1912. "*Kosova është tokë serbe për të cilën kurrë nuk mund të flitet ndryshe përveçse si për tokë serbe të shenjtë*", sepse "*Kisha në krye me mbretin dhe me aparatin propagandues e ka ndërtuar mitin e Kosovës*". Dhe, duke e marrë mitin kishtar për tapi toke, patriku serb, *German*, më 28 korrik 1988, ftonte serbët në luftë "*për hakmarrje të re të Kosovës*!" Vërtet,

të “vërtetaj” serbe për Kosovën “serbe” janë gënjeshtër të përsëritura me mijëra herë, në gjuhën serbe dhe në gjuhë të ndryshme evropiane – *frymë kjo e patriotizmit serb dhe dëshmi e inteligjencisë serbe të lindur* - siç mund të thuhet me maksimën e *Qosçit*.

Me mbështetje nga kisha dhe me bekimin e *patrikut, Slobodan Milosheviç*, më 28 qershor 1989, në *Mitingun e Gazimestanit*, e nxori përfushe planin për ripushtimin dhe për serbizimin përfundimisht të Kosovës, me strategjinë serbe “*Toka e djegur*”: “*Është treguar se Kosova dhe përcaktimi për Kosovën e mban të bashkuar tërë popullin serb*”, dhe tashti “*Miti i Kosovës nuk është vetëm çështje kishtare*”, por “*është çështje e popullit*”, ndaj, e vërteta se “*çka është historike e çka legjendë në Betejën e Kosovës (1389), ajo më nuk është me rëndësi*”, sepse “*gjatë shekuj pas asaj edhe sot, prapë, jemi në beteja dhe para betejave!*”

Vitet ’90-ta ishin paraparë për zbritjen e përqindjes së shqiptarëve në Kosovë nga 93% nën 50%. Kjo do të arrihej me të gjitha metodat dhe strategjitë e njohura në botë për spastrimin etnik të një vendi. Në funksion të këtij qëllimi në vitet ’80 dhe ’90, me dhunë ekonomike dhe policore, u ndoqën nga Kosova rreth 400 mijë shqiptarë të aftë për luftë.

Spastrimi etnik shqiptar i Kosovës, me shumicë absolute të përkatësisë fetare islame, mbi 98.2%, sipas pseudoshkencës dhe politikës pushtuese serbe, edhe më tutje paraqitej *akt civilizues*

në interes të krishterimit në përgjithësi. Dhe, vërtet, sado që Çështja e Kosovës në thelb fare nuk është çështje fetare, interesat e fesë së krishterë (ortodokse dhe katolike) dhe të asaj islame, penguan dhe do të pengojnë zgjidhjen e drejtë të Çështjes së Kosovës. Këtë fakt bukur e ka konstatuar diplomati i rryer, z. Henry Kissinger, më 12 tetor 1998: Çështja e Kosovës "është një tragjedi e shkaktuar me ndeshjen midis islamizmit dhe krishterimit në Ballkan, që vazhdon qindra vite".

Në të vërtetë, Çështja e Kosovës ishte faktikisht dhe është aktualisht çështje ekzistenciale kombëtare shqiptare, është paqe ballkanike dhe evropiane - po u zgjidh drejt. Në funksion të kësaj zgjidhje institucionet e Kosovës, UNMIK- u, SHBA-të, Evropa dhe KS i OKB-së duhet ta kenë parasysh konstatimin e Prokopit të Cezaresë, i cili në përmasa gjeniale ka konstatuar: "Siç tregon historia e vjetër, sllavët janë të gatshëm të marrin armët edhe pa pasur arsye (...), e bëjnë luftën pa shkak dhe pa e shpallur atë dhe nuk duan ta mbarojnë me një marrëveshje. Më në fund e fillojnë pa të drejtë dhe e mbarojnë me dhunë".

Vërtet, midis serbëve dhe shqiptarëve qëndron një det gjakshqiptari, i derdhur nga thika serbe. Mynxyrat ndaj qindra mijëra familjeve gjithandej Kosovës historike, realisht nga viti 1811, kur një hordhi serbe prej 300 vetash masakroi familjen tridhjetanëtarëshe të Demë Ahmetit në Mavriq të Kryellapit, deri në qershorin e vitit 1999, janë prova

dhe kujtesë trishtuese. Faktet historiografike tregojnë se nuk ka vëllazëri shqiptare në pjesën e *Shqipërisë Etnike* jashtë *Shqipërisë Londineze*, por edhe të atyre në viset kufitare të “*Shqipërisë*” me “*Jugosllavinë*”, në kufijtë ndërkombëtarë londinezoversajas nëpër tokat pastër shqiptare etnike, që nuk kanë përjetuar vrasjen dhe dhunën kanibaliste serbe.

Shkretërimi i asaj që mund të quhet *shqiptarësi* aty ku shkeli këmba e soldateskës serbe në tokat shqiptare - janë prova. Veçanërisht dhuna dhe dhunimi, plojat dhe masakrat mbi civilët e pambrojtur, burra, gra, pleq e fëmijë anekënd Kosovës, nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999, periudhë kjo e *Bombardimeve të NATO-s* mbi makinerinë ushtarake të Serbisë, janë plagë të prekshme që vazhdimisht kullojnë gjak. Nga 28 shkurti 1998 - 10 qershor 1999 nga Kosova u ndoqën me lemeri, ploja e masakra rreth një milion shqiptarë të Kosovës, eksod përtej bibliko-kuranor, por këtu nuk ka mundësi të përmendim tërë përmasën e gjenocidit ndaj shqiptarësisë së Kosovës. Soldateska serbe zbatoi mbi 30 ploja në fshatra dhe qytete, vrau mizorisht mbi 15.000 civilë - pleq, burra, gra dhe fëmijë (mbi 3400 të zhdukur), plagosi mbi 3.219 dhe burgosi mbi 1.360 veta. Me strategjinë “*Toka shqiptare e djegur*” - dogji 1.007 fshatra (nga 1392 sa ka Kosova), mbi 212.347 shtëpi, objekte përcjellëse, objekte shoqërore (prej

tyre 218 xhami), lokale afariste. Dhe, dhunë mbi dhuna është dhunimi i mbi 20.000 femrave, prej të cilave të evidencuara 2.019 nëna që kanë 3.007 fëmijë të traumatizuar përjetësisht. Kjo nuk ka çmim.

Aktualisht, edhe mbi 2.800 shqiptarë as në jetë as me varre - në duar të Beogradit zyrtar për ta mposhtur fitoren e UÇK-në - lirinë dhe pavarësinë e Kosovës si hap i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Evropën e lirë dhe demokratike – janë plumb në zemër të shqiptarëve. E, mbi të gjitha, *Masakra serbe në Burgun e Dubravës ndaj të burgosurve shqiptarë, prej datës 19-24 maj 1999, përmasat e së cilës ende nuk i dimë, është provë mbi të gjitha provat se Serbia me dorën e vetë e ka kallur pjesën serbe, pikërisht atë koloniale, në Kosovë.*

Të përfundojmë: Nëse historia është mësuesja e jetës, siç besohet nga latiniteti, *Çështja e statusit shtetëror të Kosovës*, në pritje, nuk mund të zgjidhet duke i mbyllur sytë para 188 vjet krimi e etnocidi institucional serb, malazias, grek e bullgar mbi shqiptarët në përgjithësi dhe shqiptarësinë e Kosovës në veçanti. Serbia, veçanërisht, nga janari i vitit 1878 deri në qershor të vitit 1999, pra për 121 vjet rresht, përveç dëmit material të pallogaritshëm, është përgjegjëse për copëtimin e Shqipërisë dhe për jetën e rreth *tre milionë shqiptarëve*. Në këtë krim janë bashkëfajtores Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe Rusia,

sepse me zgjidhje të dhunshme në Ballkanin jugperëndimor, duke e ndarë një vend dhe një komb vetëm pse fati ia ngarkoi të mbijetojë si mysliman, krijoi kriza që gjeneruan në gjakderdhje, gjenocid, kulturocid dhe etnocid shekullor ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë historiko-etnike.

Ky është pengu që *Kosovën* dhe *Serbinë* i detyron të mbesin njëra pranë tjetrës dhe kurrë më së bashku nën një çati shtetërore të përbashkët. Dhe, nëse faktori ndërkombëtar i vendosjes aktualisht ngul këmbë për rilidhjen me dhunë të jetës shtetërore të Kosovë me Serbinë, pa vullnetin e shumicës etnike historikisht të Kosovës, do të bëhet shkaktar i gjakderdhjeve të reja ndëretnike në Kosovë dhe gjetkë në tokat shqiptare, të copëtuara me dhunë ndërkombëtare.

Se *Serbia* dhe *serbët* nuk mund ta durojnë ekzistimin e kombit shqiptar, se *Serbia* dhe *serbët* janë degjenerikë racistë antishqiptarë përtejmesjetarë, se *Serbia* dhe *Shqipëria* duhet të kufizohen me kufijtë etnikë si ardhmëni e vetme e Ballkanit ortodokso - “islam” - dëshmi e prekshme është “*notesi*”: 29 maj 1968 - 14 shtator 2004, i akademikut monstruoz, Dobrica Qosiq - “*Kosovo. Biblioteka Istine, Knjiga broj 1*”, Beograd, 2004, ISBN 86-7446-038-0, fq. 257. Del se nuk ka rrugë të drejtë tjetër, pos dënimit ndërkombëtar të *Serbisë* dhe pranimi të së drejtës ndërkombëtare për vetëvendosjen politike dhe

shtetërore të shqiptarëve në shtrirjen natyrore etnike kompakte.

Shteti i shqiptarëve në kufijtë e *Shqipërisë Etnike* nuk është *Shqipëri e Madhe*, gogol serbo-ruso-evropian antiislam të *periudhës së imperializmit*, por është më pak se dy të tretat e *Shqipërisë* (*Albania, Arnautlluk*) të shekujve XV-XIX - *islame, ortodokse dhe katolike*. Pra, është vetëm pjesa e *Shqipërisë* e vaditur me gjakun shqiptar pa dallim feje deri në ditën e sotme, e ruajtur edhe me mëshirën e Zotit.

Literatura:

Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndej (Me vështrim të veçantë mbi burimet serbe të fakteve), Simpozium, 20-21 janar 1994, Prishtinë 1995; Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe Qëndresa shqiptare (1844-1990)*, Tiranë, 1992; Dr. Muhamet Pirraku, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës 1945*, Prishtinë, 1992; Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1941-1951, Prishtinë, 1995; *Për kauzën shqiptare 1997-1999*, Prishtinë, 2000; Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (Shtator 1944- Korrik 1945)*, Tiranë, 1994; Dr. Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995)*, Prishtinë, 1995; Dëbimi i shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995), Prishtinë, 1997; Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar*

1912-1913 (Dokumente), Prishtinë, 1996; Mr. Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, Prishtinë, 1997; Dr. Izber Hoti, *Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997; Dr. Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997; Mero Baze, *Shqipëria dhe Lufta e Kosovës*, Tiranë, 1998; *Gjenocidi serb në Kosovë. Sesion shkencor*, Tiranë, 29 qershor 1999; Arben Kondi, *Krimi i fundshekullit*, Tiranë, 1999; *100 ditet e luftës në Kosovë. Kronikë e ngjarjeve 25 mars - 4 korrik 1999*, Tiranë, 1999; Shaban Sinani, *Kosova në syrin e ciklonit*, Tiranë, 1999; Milazim Krasniqi, *Kosova pas 22 janarit 1998. Politika serbe e gjenocidit / qëndrimi i Fuqive të Mëdha / politika(t) e shqiptarëve të Kosovës*, Prishtinë, 2000; *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë (Shkurt 1998 - Qershor 1999)*, Prishtinë, 2000; Dashamir Uruçi, *Kosova dhe e drejta e vetëvendosjes*, Shkodër, 2001; *Krimet e Luftës në territorin e Komunës së Pejës mars-qershor 1999*, Pejë 2000; Sanije Aliaj, *Pasojat e Luftës në Kosovë (28 shkurt 1998 - 10 qershor 1999)*, Prishtinë, 2000; ICRC - Comité International Geneve, *Persons missing in relation to the events in Kosovo from January 1998*, 2nd edition issued in March 2001; Besim Cengu, *Përmasat e mbijetesës*, Kukës, 2003; Gafurr Elshani, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Dokumente dhe artikuj, Botim i tretë*, Prishtinë, 2003; Naser Husaj, *Dubrava - Rruga drejt vdekjes*, Pejë,

2004; *Masakra e Raçakut krim kundër njerëzimit*, Shtime, 2004; Mr. Ibrahim Çitaku, *Drenica 1991-1999*, Prishtinë, 2004; Marek Antoni Novicki, Të ndihmohen viktimat e dhunës seksuale në vitin 1999, *Zëri*, Prishtinë, 6 nëntor 2004, fq. 4; Milosheviq: “Rasti i burgut të Dubravës, një film i dobët horror i Prokurorisë së Hagës”, *Koha Ditore*, Prishtinë, 25 mars 2005, fq.7.

Enver Dugolli

PËRQENDRIMI I TË BURGOSURVE SHQIPTARË NË KAMPIN E DUBRAVËS

Fillimi i vitit 1997 në Kosovë nisi më një varg arrestimesh të shumta, por edhe me goditje të drejtpërdrejta në strukturat e UÇK-së. UDB-ja dhe *ushtria jugosllave* synonin që më këto goditje të dobësonin, apo të asgjësonin në tërësi forcën ushtarake dhe politike UÇK, e cila në programin politik dhe në doktrinën ushtarake kishte çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, me mjete të tjera nga ato që trumbetoheshin në ato vite nga partitë dhe lëvizjet pacifiste shqiptare të kohës. Burgjet hetuese në Kosovë thuajse ishin të stërmmbushura nga këto arrestime dhe në çdo qeli të këtyre burgjeve kishte „terroristë” të pathyeshëm në rrugën jetësore çlirimtare të tyre.

Realisht, pas dënimit të tri grupeve, që u bë gjatë vitit 1997, pushteti serb sikur planifikonte që burgjet hetuese t'i mbushte prapë me „terroristë” të rinj, andaj ende pa u kthyer aktgjykimi nga shkalla e dytë filloi që një pjesë të të dënuarve t'i transferonte në *Burgun e Dubravës*. Transferi bëhej pasi që ky burg ishte i njohur për kapacitetin që posedonte në planin e infrastrukturës dhe të kushteve për mbajtjen e një numri shumë të madh të të burgosurve.

Në fillim të vitit 1998 nga *Burgu Hetues i Qarkut të Prishtinës* transferohet në *Burgun e Dubravës* një grup i të dënuarve: *Avni Klinaku, Liburn Aliu, Dylber Beka, Enver Dugolli, Eqrem Kastrati* dhe *Jahja Luka*, që u soll nga *Burgu i Pejës*. Në shikim të parë dukej se nuk po ndodhte asgjë e jashtëzakonshme, mirëpo më vonë u kuptua se aty synohej një grumbullim i madh i të gjithë të burgosurve politikë me autoritet dhe me ndikim në radhët e masave shqiptare.

Nga kjo kohë në *Burgun e Dubravës*, përveç grupit të përmendur më sipër, ndodheshin në vuajtje të dënimit edhe shumë të burgosur të tjerë politikë, të grupeve të ndryshme, mirëpo ishin të ndarë nëpër pavijone. Në vuajtje të dënimit, aso kohe, ndodheshin shumë figura të shquara - veprimtarë të devotshëm të çështjes kombëtare të

cilët për veprimtari politike patriotike ishin dënuar disa herë me dënime drakonike.

Lista e të burgosurve politikë që ndodhëshin asaj kohe në *Burgun e Dubravës* është kjo: *Bajrush Xhemaili, Hajredin Hyseni, Xhelal Canziba, Ismet Mahmuti, Raif Çela, Avdi Mehmeti, Rexhep Oruqi, Sheremet Ahmeti, Blerim Olloni, Hajzer Hajzeraj, Reshat Maliqi, Fadil Hyseni, Sejfullah Sabatqiu, Shefqet Beqaj, Gani Mullabazji, Salih Sokoli, Esat Haxhijaba, Xhemajli Haxhimustafa, Remzi Tetrica, Naser Husaj dhe Naser Ndrecaj.*

Përcjelljet e shumta që u bëheshin, jo vetëm atyre, por, po thuajse të gjithëve që ishin arrestuar ose dënuar për veprimtari patriotike, por, duke përfshirë këtu edhe një numër të burgosurish ordinerë, të cilët do të bëhen krah i të burgosurve politikë, tregonin qartë se aty përgatitej terreni për „banorë” të rinj.

Zgjerimi i luftës së UÇK-së, e sidomos *ndeshja ballore në Likashan*, më 28 shkurt, dhe *Epopeja e UÇK-së në Prkaz*, më 5-7 mars 1998, ndryshoi shumëçka, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar. Tashti u pa se edhe pushteti serb po ndërronte planet dhe po përgatitej të ballafaqohej me një situatë tjetër nga ajo që kishte menduar.

Se, vërtet po ndërronte diç në këtë drejtim, tregon fakti se të burgosurit e tjerë, siç janë *Grupi i Nait Hasanit* dhe *Grupi i Besim Ramës*, e që pritej se

do t'i transferonin në këtë burg, nuk erdhën, nuk i sollën, pasi që lufta e UÇK-së po përhapej çdo ditë e më shumë, e me këtë edhe masat e pushtetit për gjoja „sigurinë” e të burgosurve po “rriteshin”!?! Kuptohet, në raste të tilla, në kushte e rrethana të burgut serbo-jugosllav, të burgosurit, dhe veçanërisht ata shqiptarë, ishin të pafuqishëm të ndikonin në vendimet e qarqeve politike, policore e gjyqësore të okupatorit, ndonëse kishin të bënë me jetën dhe fatin e tyre. Me një vendim të *Ministrit të Drejtësisë së Serbisë*, më 29 dhe 30 prill 1998, u bë ritransferimi nga *Burgu i Dubravës* në burgjet serbe i të gjithë të burgosurve politikë, me arsyetimin, sa qesharak aq edhe ironik - kinse „për shkak të sigurie...”!?! Ky transferim fillimisht u bë në dy burgje, pikërisht në *Kazamatin e Nishit* dhe në *Kazamatin e Mitrovicës së Sremit*.

Në burgun e Mitrovicës së Sremit transferohen: *Bajrush Xhemaili, Avni Klinaku, Liburn Aliu, Dylber Beka, Enver Dugolli, Eqrem Kastrati, Raif Çela, Avdi Mehmeti, Hajzer Hajzeraj* dhe *Naser Husaj*. Ndërsa në burgun e Nishit transferohen: *Hajredin Hyseni, Ismet Mahmuti, Xhelal Canziba, Sheremet Ahmeti, Gani Mullabazi, Salih Sokoli, Remzi Tetrica* dhe *Naser Ndrecaj*. Kuptohet, të burgosurve nuk u lëshuan vendime për transferim. Këta, ato vendime do t'i shohin vetëm nëpër zyra të kazamateve serbe, në momentet kur kërkonin që t'i kthenin në

Kosovë. Drejtoritë e burgjeve, për mospërbushjen e kërkesave të të burgosurve politikë, arsyetoheshin se vepronin sipas vendimit të *Ministrisë së Drejtësisë* dhe se mbajtja jashtë zonës ndërluftuese “është për të mirën” e tyre.

Realisht, pas transferimit të të burgosurve shqiptarë politikë nëpër burgjet serbe, nuk vonoi shumë dhe i larguan edhe të gjithë të burgosurit e tjerë që ishin të dënuar për vepra ordinere. Të gjithë u dërguan nëpër burgje të ndryshme të Serbisë, si në *Kazamatin e Nishit*, të *Pozharevcit*, të *Mitrovicës së Sremit* etj.

Burgu i Dubravës tani ishte i liruar nga të burgosurit, mirëpo aty tashti po ndodhte diçka e pashembullt. Zhvillimi i *Luftës së UÇK-së* po kalonte në një fazë të re. Përhapja dhe shtrirja e saj ishte më se e evidente, andaj edhe serbët po merrnin masa të reja shtesë për të goditur jo vetëm UÇK-në dhe bartësit e organizimit të kësaj lufte, por edhe masa ndaj popullatës civile, si ndëshkim, duke zbatuar strategjinë e *Tokës shqiptare të djegur*.

Në rrethana të tilla, objektet e *Burgut të Dubravës* në këtë drejtim po shndërroheshin në një bazë ushtarake e paramilitare institucionale serbe shumë të rëndësishme për operacionet ndëshkuese që po ndërmernte komanda supreme ushtarake dhe policore serbe për *Rrafshin e Dukagjinit* dhe më gjerë. Në objektet e burgut dhe përreth pushtuesi serb

përqendroi një arsenal të madh luftarak, me të cilin operonte kundër UÇK-së dhe *popullatës civile*.

Të burgosurit shqiptarë politikë dhe ordinerë, edhe pse ishin dërguar nëpër burgjet serbe jashtë zonës së luftës, për gjoja “*çështje sigurie*”, nuk ishin kurrë të sigurt, sepse serbët e shumtë, që merrnin pjesë në luftën që po zhvillohej në Kosovë, shpesh u vinin dhe i “*vizitonin*”, e sidomos kur pësonin humbje në frontin e luftës. Thjesht shqiptarët në burgjet serbe nuk ishin të burgosur, ishin pengje të luftës, dhe mbi ta ushtrohej dhuna serbe tradicionale sa herë që serbët donin ta demonstronin „*fuqinë*” e shtetit policor e ushtarak milosheviçian.

Vizitat e shumta që ua bënin të burgosurve shqiptarë “*personalitetet*” serbe në kampin e Mitrovicës së Sremit e gjetkë, siç ishte edhe vizita e kriminelit *Arkan*, tregonte qartë se ndaj tyre po përgatitej diçka edhe më e keqe, diçka më shumë sesa po u ndodhte për çdo ditë. Sa herë që vinin “*vizitorë*” të tillë, të burgosurit shqiptarë ishin të detyruar të prezantoheshin se kush ishin, prej nga ishin, përse ishin burgosur. Shënimet që ua merrnin, e shpesh edhe i fotografonin, ishin të pakuptimshme për të burgosurit, pasi që të gjitha këto informata i kishte personeli i kampit në dosjet e të burgosurve.

Themi “*i kampit*” për arsye se, vërtet, për të burgosurit shqiptarë burgu ishte kamp i shfarosjes dhe asgjë tjetër, pasi që të drejtat që mund t’i gëzonte një i burgosur për ta kishin pushuar së ekzistuari që me fillimin e luftës.

Fillimi i bombardimeve të *NATO*-së, siç dihet, pengjet shqiptare i gjeti gati në të gjitha kazamatet serbe dhe në kushte mjaft të vështira. Autoritetet e këtyre kazamateve kishin humbur pothuajse në tërësi logjikën e të menduarit dhe të vepruarit si organe shtetërore, sepse ato tashti silleshin me një egërsi të paparë. Të burgosurit shqiptarë, duke mos pasur kontakte me familjet, as me përfaqësuesit e organizatave për liri dhe të drejta të njeriut, në fillim mendonin se organet drejtuese të burgjeve i kishin këputur lidhjet me organet më të larta, gjyqësore e juridike, mirëpo puna qëndronte krejtësisht ndryshe.

Drejtoritë dhe personeli i kazamateve më përpikëri u përmbahej udhëzimeve nga lart. Ato vetëm zbatonin planet në nivele të shtetit që ishin bërë qysh më herët. Për çudi, të burgosurit shqiptarë, nuk mund të mendonin fare për përgatitjen e mynxyrës së *Burgut të Dubravës*. Çdo gjë do të vije si e papritur dhe si ndodhi e pabesueshme. Kur është fjala për *Kazamatën e Mitrovicës së Sremit*, pikërisht më 26 prill 1999, u urdhërohet të burgosurve politikë (më herët i kishin

grumbulluar në një dhomë, ku e kishin sjellë edhe profesor *Mr. Ukshin Hotin*), që me nguti t'i bënin gati gjërat që kishin, sepse do t'i transferonin “*diku tjetër...*”?!

Ishin gjithsej 45 veta të dënuar politikë, pasi që të burgosurit e tjerë, të dënuarit ordinerë, i kishin transferuar kohë më parë diku tjetër. Më vonë do të mësohet se ata i kishin kthyer në *Burgun e Dubravës*. Vërtet, kishte rastisur që gjatë kohës sa të burgosurit politikë po bëheshin gati për rrugë, përgjuan një bisedë midis dy gardianëve se edhe këta “*po i dërgonin në Burgun e Dubravës...*”?! Ky sihariq shkoi vesh më vesh të të burgosurve shqiptarë, si lajm i pritur, me vetë faktin se njeriut ç'do e keqe që mund t'i ngjajë më lehtë e përballon kur është në tokën e vet. Mirëpo, fillimisht nuk ndodhi e pritura. Prej *Mitrovicës së Sremit* i sollën në *Kazamatën e Nishit*, kamp i cili për shqiptarët i tejkalonte edhe kampet më të këqija naziste.

Në *Burgun e Nishit* i mbajtën vetëm tri ditë, prej 26 - 29 prill 1999. Ndaj të burgosurve shqiptarë këtu tashti do të zbatohet një dhunë shumë e shfrenuar, dhunë që nuk kursehet askush. Plak apo i ri, i sëmurë apo invalid, i zoti apo i pazoti, të gjithë iu shtruan asaj katrahure të papërshkrueshme.

Thyerja e këmbës së plakut shumë të shtyrë në moshë *Nezir Zogajt* nga *Bushati* i *Drenicës* ishte

vetëm një shembull, se deri ku mund të shkonte ajo çmenduri e bishave me fytyrë njeriu. Kjo “*thyerje eshtrash*” për të burgosurit politikë shqiptarë të *Burgut të Sremit* zgjati, siç u tha, vetëm tri ditë, mirëpo aty pati edhe shumë shqiptarë, të cilët me muaj të tërë kishin provuar ato mynxyra.

Nga *Kazamati i Nishit*, të mbërthyer më hekura dhe varganë, më një përcjellje të veçantë, të burgosurit shqiptarë i trusën në tre autobusë, por ata as mund të besonin se do të përfundonin në Kosovë. Nuk kishin si të besonin një gjë të tillë, edhe nga fakti se në Kosovë po bëhej një luftë shumë e madhe, ndërkaq ata, siç u kishin thënë, i kishin larguar nga Kosova me vendim të *Ministritë së „drejtësisë” serbe* - “*për shkaqe sigurie*” !?

Vërtet, ata që kohë më parë u thoshin të burgosurve shqiptarë se në Kosovë nuk jeni të sigurt, në një kohë kur lufta nuk ishte e përmasave të prillit të vitit 1999, tashti edhe vetë po i ekspozoheshin një rreziku mjaft të madh, vetëm e vetëm që të zbatonin një plan të përgatitur dhe të dizajnuar në hollësi nga organet më të larta shtetërore serbe.

Dhe, në një moment, kur një autobлиндë e ushtrisë serbe hyri në mes të dy autobusëve të fundit në kolonën që transferonte të burgosurit shqiptarë - pengje të luftës, pikërisht në mes të fshatit *Llapushnik* dhe *Arllat* të *Drenicës*, goditet nga

një aeroplan i NATO-s. Ndodhi diçka shumë e çuditshme dhe e pabesueshme! U shkatërrua autoblanda dhe u vranë ushtarët serbë që gjendeshin brenda. Sapo ndodhi ngjarja, ushtarë dhe paramilitarë serbë që kishin qenë në pozicione përreth rrugës, të tmerruar dhe të mllëfosur për humbjet që pësoi makineria ushtarake serbe, tentuan që më çdo kusht të hakmerreshin më vrasjen e disa pengjeve shqiptarë që gjendeshin në autobusë të lidhur këmbë e duar.

Ndodhi, këtu, para syve të të burgosurve shqiptarë, diçka e papritur, diçka humane për t'u shënuar. U zhvillua një dramë e vërtetë në mes të gardianëve shoqërues të të burgosurve dhe paramilitarëve që donin të hakmerreshin më çdo kusht ndaj të burgosurve shqiptarë të rraskapitur. Dhe gati sa nuk filloi një luftë në mes të dy palëve serbe të armatosur. Kërkesës për hakmarrje gardianët iu përgjigjën: *“E kemi një urdhër nga Milosheviqi që këta të burgosur duhet më çdo kusht t'i dërgojmë në numër të caktuar në një vend”*. Së fundi, paramilitarët e frustruar iu bindën logjikës ushtarake, e kuptuan se kishte një urdhër nga lart dhe se atë urdhër duhej respektuar, edhe pse e dëshironin hakmarrjen këmbadoras edhe ndaj të pamundurëve. Shqiptari dhe ushtari i NATO-s për ata tashti ishin një dhe barabar të urreyer.

Më në fund, më 29 prill 1999, të burgosurit shqiptarë nga *Kazamati i Mitrovicës së Sremit* dhe *Kazamati i Nishit* u gjetën në *Burgun e Dubravës*, një vit pasi që shumë prej tyre ishin larguar “për çështje sigurie...!?!”, por ata ende nuk mund ta merrnin me mend se çka po përgatitej, në të vërtetë, për jetën dhe për fatin e tyre. Dy autobusët e fundit që u nisën nga *Nishi* në *Burgun e Dubravës* arritën një ditë më vonë, më 30 prill 1999, për faktin se me rastin e sulmit të avionit të NATO-s mbi autobлиндën serb, siç u sqarua, dëme të vogla materiale pësuan edhe dy autobusët. Po atë ditë, pra më 30 prill 2004, Në *Burgun e Dubravës* i sollën të burgosurit nga *Prizreni*, *Lybjani* dhe *Gjilani*, kurse pas dy ditësh, më 2 maj 1999, i sollën të burgosurit nga *Prokupla* e *Vraja*.

Tashti *Burgu i Dubravës* më nuk ishte në rendin e mëparshëm, edhe pse kishte po atë infrastrukturë dhe kishte po ata gardianë. Personeli i *Burgut të Dubravës*, i cili do të bartë barrën e krimit në *Masakrën e Dubravës*, ishte: drejtori, *Aleksandër Kovaçević*, komandanti, *Miki Vidiq*, mbikëqyrësi, *Branko Komatina*, milici *Gërga Igor* e të tjerë dhe gardianët e quajtur: *Aca*, *Mitri*, *Mance*, *Pegja* e të tjerë. Tashti *pushteti për krim ndaj pengjeve shqiptare*, u ishte besuar të burgosurve ordinerë: *Svetlan Martinović* nga *Vrraka e Shkodrës*, vrasës i *Familjes Cacaj* nga *Deçani*, *Boban Bashçević* nga *Nikshiqi* dhe *Ilia Mishković* nga *Çaçaku* e të tjerëve.

Në këtë burg, kohë më parë, ishte sjellë një pjesë e të të burgosurve ordinerë shqiptarë nga *burgjet e ndryshme* dhe aty ishte një pjesë e të të burgosurve që ishin gjatë kohë në një pavijon, i cili ishte për nga mbikëqyrja më i veçantë. Vazhdimi i grumbullimit të të burgosurve dhe të pengjeve në këtë kamp tashti do të vazhdojë për çdo ditë, duke i sjellë herë nga burgjet hetuese, herë të arrestuar në qytetet dhe në fshatrat nën shtetrrëthim ushtarak dhe policor. Më 18 maj 1999 i sollën edhe *155 civilë* nga Gjakova, që ishin arrestuar apo ishin marrë me dhunë nga shtëpitë e tyre. Këto pengje i shoqëruan, deri në Burgun e Dubravës: *Dragan e Vladan Veličko Miloviq, Slobodan Slavko Kovaç e Ibrahim Batusha*, të gjithë nga Gjakova, dhe *Dushan Vekiq* nga Hoça e Rahovecit. Në vijim, me pengjet gjakovare do të mirën milicët nga Gjakova: *Slobodan Kovaç, Milan Jakiq, Gjokica Stanojeviq* dhe *Rade Nikiq*.

Vërtet, sipas informatave të tërthorta, numri i të burgosurve shqiptarë - pengje të luftës, tashti arriti mbi 950 veta, ndaj të të cilëve zbatohej keqtrajtimi dhe dhuna e paparë. Në këso rrethana kishte ndodhur një përjashtim i papritur. Të burgosurit pritnin me padurim ditën e *17 majit 1999*, kur do t'i skadonte afati i burgut profesor *Mr. Ukshin Hotit*, ndërsa *Ai* do të merret nga burgu, pa pritur, një ditë më parë, më 16 maj 1999, "*lirim*" i pazakonshëm në praktikën e burgjeve serbo-sllave

dhe veçanërisht për rrethanat e *Luftës çlirimtare në Kosovë*. Megjithatë, shpresohet se *Bacin Ukë*, siç e thirrnin *Ukshinin* bashkëvuajtësit në burgje, mund ta priste ndonjë përfaqësues i organizatave humanitare, siç mund të ishte *Kryqi i Kuq Ndërkombëtar*, që do të kujdesej për sigurinë e jetës së tij.

Pas marrjes dhe zhdukjes së *Profesor Ukshin Hotit*, zhvillimet e përgjakshme vazhduan rrugëtimin. Po atë ditë që u “*lirua*” *Hoti*, nga burgu u “*lirua*” edhe *Rasim Plava* nga Cërmjani i Gjakovës, i cili më vonë u gjet i vrarë në Vranoc të Pejës, të nesërmen u “*lirua*” *Haki Z. Dinaj* nga Raushi i Pejës dhe konsiderohet i zhdukur, kurse më 18 maj 1999, në mjediset e *Burgut të Dubravës* është ekzekutuar Shkëlzen Pepshi nga Juniku i Deçanit. Krimi i pashembullt, gjakderdhja e llahtarshme, do të ndodhë më 19 - 24 të majit të vitit 1999.

Bajrush Xhemaili

PROJEKTIMI, QËLLIMI DHE REALIZIMI I MASAKRËS

Të burgosurit shqiptarë në kazamatet serbe janë shembull tipik i një trajtimi të egër përtejmesjetar në prag të mijëvjeçarit të tretë. Atyre u ndodhi edhe ajo më e keqja - përjetuan ploja dhe ekzekutime kolektive, pra, u ndodhi *Gjakderdhja e*

Dubravës, e pashembullt në kthesën vendimtare të rendit të ri demokratik perëndimor.

Për të kuptuar makiavelizmin e pushtuesit serb rreth *Masakrës së Dubravës* të 19-24 majit të vitit 1999, ndaj të burgosurve shqiptarë, kërkohet t'u kthehemi rrethanave më shumë se një vit më parë, pikërisht nga koha e luftimeve ballore të UÇK-së me makinerinë luftarake të okupatorit serb. Koha kur të burgosurit shqiptarë bënë një jetë rutinore burgu realisht u përfundua me *Ndeshjen e Likashanit*, më 28 shkurt, dhe *Epopenë e Prekazit*, më 5-7 mars 1989. Tashti lajmet në TV dëgjoheshin me një frymë, dhe komentet për ato që thuheshin në vizitat që kishin të burgosurit me familjarët u bënë ushqim shpirtëror, veçanërisht për të burgosurit politikë.

Armata serbe sa vinte dhe arsenalin ushtarak po e tërhiqte nga *Serbia* dhe po e sistemonte në Kosovë, në gatishmëri për luftën përfundimtare kundër shqiptarësisë shekullore të saj. Në mënyrë që sa më pak t'i binte në sy faktorit ndërkombëtar të vendosjes, duheshin vende të përshtatshme për të vendosur *teknikën* dhe *ushtarët*. Për ato kërkesa, pa dyshim, vend më të përshtatshëm sesa *Burgu i Dubravës* nuk kishte.

Kështu, në *Kopshtin e burgut* tashti filluan të zbrisnin helikopterët ushtarakë dhe shihej qartë se *burgu* po kthehej në një bazë të fortë ushtarake, ku nuk mund të kishte më vend për të burgosur. Era e

luftës tashti po frynte edhe në burg dhe pritej vetëm dita e transferimit të të burgosurve në ndonjë burg gjatë. Ajo ndodhi më 29 dhe 30 prill 1989, kur do të transferohet grupi i parë nga *Dubrava* në burgjet e *Serbisë*. Të gjithë këta të transferuar ishin të burgosur politikë. Në vijimësi u transferuan edhe të burgosurit ordinerë.

Në pavijonet e *Burgut të Dubravës* fillimisht i sistemuan forcat e armatosura paramilitare serbe, për t'i fshehur nga opinioni ndërkombëtar, ndërsa jashtë mureve të burgut u llogoruan ushtarët serbë, me teknikën më moderne. Kështu, *Dubrava* tashti po bëhej baza më e fuqishme e makinerisë ushtarake serbe në *Dukagjin*.

Të burgosurit shqiptarë në burgje të *Serbisë* do të mbahen plot një vit, në kushte të ndera jetësore, nën regjimin e dhunës fizike e psikike të paparë. Ndonëse i kishin larguar me “*me motivimin*”: “*Largohen për shkaqe të sigurisë nga rajoni i përfshirë në luftë...!*”, tashti do t'i kthejnë në *Burgun e Dubravës*, shumicën e tyre, ditë më ditë pas një viti, më 29 dhe 30 prill 1999, në kohën e intensifikimit më të madh të bombardimeve ajrore të NATO-s mbi arsenalin ushtarak të *Serbisë* në *Kosovë* dhe të *luftës vendimtare të UÇK-së për çlirimin e Kosovës*. Koha dhe mynxyrat e vërtetuan faktin se kthimi i të burgosurve dhe i pengjeve të luftës ishte bërë sipas një skenari

paraprak për ekzekutimin e tyre me pjesëmarrje të NATO-s si aleate e UÇK-së.

Deri në prag të filleve të *Masakrës serbe* numri i të burgosurve në *Burgun e Dubravës*, sipas një përlllogaritjeje nga të burgosurit, arriti numrin rreth 950 veta, të vendosur në katër pavijone: *C1, C2, B2* dhe në *Pavijonin Pranues*, në kushte jetësore të paimagjinueshme të rënda.

Vërtet, qëllimi i kthimit të të burgosurve nga burgjet serbe në Kosovë dhe nga burgjet e Serbisë në *Burgun e Dubravës* do të bëhet e kuptueshme shumë shpejt për akëcilin të burgosur. Por, përmasa e tragjedisë nuk mund të merrej me mend. Kjo e panjohur i mundonte të gjithë të burgosurit dhe pengjet shqiptare dhe sigurisht që askush nuk ka mundur të rrinte indiferent ndaj saj. Përkundrazi, të gjithë ishin të shqetësuar nga pesha e së panjohurës.

Pushteti serb i kishte bërë me përpikëri llogaritë, duke qenë i sigurt se ka ardhur koha që NATO-ja t'i bombardojë edhe objektet e burgut, meqë kishte informata paraprake se ai ishte kthyer në bazë ushtarake. Ndërkohë ishin tërhequr “*paramilitarët*” dhe në vend të tyre ishin kthyer të burgosurit shqiptarë. *Logjistika e NATO-s*, siç duket, nuk u besoi *informatave nga logjistika e UÇK-së* - për kthimin e të burgosurve shqiptarë në ambientet e *Burgut të Dubravës*. Dhe, krimi i llahtarshëm ndodhi.

Më 19 maj 1999, e mërkurë, diku nga gjysma e ditës, flota ajrore e NATO-s bombardoi objektet e burgut – *dy pavijone brenda mureve dhe disa jashtë tyre*, si dhe *drejtorinë e burgut* etj. *Pavijoni C1*, që ishte përplot me të burgosur, *goditet me 4 projektile*. Pas pak çastesh qëllohet edhe *pavijoni B3*, por këtu nuk kishte të burgosur, ngase tashti ai përdorej si depo.

Gardianët kishin ikur sapo kishte filluar bombardimi, kurse të burgosurit në pavijonet *C1 dhe B2* ishin të mbyllur. Vetëm të burgosurit në *pavijonin C2* kishin një tretman më të veçantë, ishin kryesisht të burgosur ordinerë. Ky pavijon gati tërë ditën i kishte dyert e hapura. Të burgosurit që përjetuan krimin në *pavijonin C1* do të përpiqen t'i thyejnë grilat, por pa sukses. Ballafaqimi me mundësinë e vdekjes solli një panik, i cili vështirë përballohej. Brenda në gërmadhë kishte të plagosur të ngjuar, të cilëve askush nuk mund t'u ndihmonte.

Në këto momente të rënda, kur s'dihej se ç'po ndodhte, të burgosurit ordinerë nga *C2-shi* u organizuan t'i hapnin dyert e dhomave me forcë, me kazma e me mjete të tjera, duke nxjerrë, kështu, nga gërmadhat të plagosurit dhe të vdekurit, fillimisht në *pavijonin C1* e pastaj në *B2*. Pasi të gjithë dolën në oborrin e burgut, u konstatua se në *pavijonin C1* kishin mbetur të vrarë 3 të burgosur dhe 19 ishin plagosur, prej të cilëve 4 shumë rëndë. Njëri prej tyre do të vdes në Spitalin e Pejës.

Vërtet, pas dy orësh nga bombardimet e NATO-s, nga dera e hyrjes së burgut hynë disa gardianë të armatosur. Me ta ishte edhe një i burgosur ordiner serb nga burgu i Nishit me rroba të burgut dhe me armë në duar. Gardianët fillimisht i ndanë dhe i veçuan të burgosurit serbë e malazez, për t'i përdorur më vonë si mashë në masakrën ndaj të burgosurve shqiptarë. Tani personeli i burgut urdhëroi pengjet shqiptare të bëheshin rresht dhe të hynin brenda në pavijone dhe ambiente të tjera. Nuk shtien me armë. Nga sjellja e tyre dhe zhvillimet e reja u pa se udhëheqja e burgut mezi kishte pritur aktin e bombardimeve të pritura, për të trumbetuar para opinionit ndërkombëtar, se: “...ja ç’ *krime bën NATO-ja, duke bombarduar edhe burgjet dhe të burgosurit e mbrojtur me ligjet ndërkombëtare të Luftës...!?!*”

Që pompoziteti i propagandës serbe milosheviçiane *antinato*, njëkohësisht dhe *antiuçekë*, të jetë sa më i besueshëm, pa vonuar, bashkë me gjithë stafin e burgut, hynë edhe *mantelbardhë* (me gjasë oficerë ushtarakë) dhe *gazetarë* të mediave të shkruara dhe elektronike. Vërtet, Serbia nuk pati rast më të mirë të tërheqet si humane para botës?! Askush nga blic “*vizitorët*” nuk u mor me fatin e të plagosurve. Bënë incizime dhe fotografime të pamjeve të kurdisura dhe shkuan. *Logjistika e UÇK-së* pa vonuar reagoi dhe ia tërhoqi vërejtjen

komandës së fluturimeve të *flotës ajrore të NATO-s*, se makineria ushtarake serbe e kishte hedhur në kurth. Mirëpo, do të ndodhë diçka që duhej të përgjigjej dikush nga radhët *logjistike të NATO-s*.

Vërtet, të nesërmen, më 20 maj 1999, e enjte, mbizotëroi heshtja, shqetësimi dhe ankthi para të panjohurës. Personeli i burgut i kërkoi dokumentet e identifikimit dhe fletarrestimet nga pengjet e sjellë nga Gjakova dhe nga një pjesë e të burgosurve të tjerë, kinse për t'i evidentuar si “*banorë*” të burgut. Kjo kishte prapavijë - humbjen e gjurmëve të pengjeve pas masakrës që po përgatitej.

Të nesërmen, ditë e premte, më 21 maj, rreth orës 9.30, prapë, projektilë të fuqishëm fillimisht do të godasin ndërtesat jashtë mureve të burgut. Në vazhdim, për çudi, cak i sulmeve do të bëhen edhe objektet vitale brenda mureve të burgut. Së pari do të qëllohet *mensa*. Për fat në këtë mëngjes ishte shtyrë ngrënia e kafjallit për të burgosurit dhe në *mensë* ishin kryesisht kuzhinierët. Midis të parëve që ranë ishin tre kuzhinierë shqiptarë. Bombardimi vazhdoi mbi objektet e tjera, me ndërprerje të herëpashershme, deri në mbrëmje. Të burgosurit, pa shtegdalje tjetër, do të tubohen në një hapësirë të ngushtë katërkëndëshe, mes këtyre objekteve: *mensës, ambulancës, pavijonit të pranimit, shkollës, sallës së sporteve, shtëpisë së kulturës, pavijonit B3 dhe B2*. Gjatë kësaj kohe, një projektil bie afër *shtëpisë së kulturës*,

nga e cila goditje prapë e gjejnë vdekjen dhe u plagosën shumë të burgosur.

Duke parë rrezikun brenda hapësirës së këtij katërkëndëshi, të burgosurit do të largohen nga ndërtesat. Vendi më i përshtatshëm dukej *fusha e sportit* nën qiell të hapur. Disa të burgosur do të futen në puseta, apo edhe diku tjetër, ku mendonin se do të ishin më të sigurt. Në këtë ditë tragjike të 21 majit 1999, ku goditet, pothuaj, çdo objekt i burgut, vdiqën 19 të burgosur dhe u plagosën 32 të tjerë.

Pjesa më e madhe e të burgosurve, natën e 21/22 majit 1999, do ta kalojë nën qiell të hapur. Të nesërmen, më 22 maj 1999, e shtunë, diku rreth orës 5.45 të mëngjesit, një i uniformuar nga karakolli veriperëndimor nr. 5, afër fushës së sportit, urdhëron të burgosurit të rreshtoheshin për dy. Kriminelët e tjerë i kishin zënë pusitë në pjesë të tjera të murit. Ishte ky pikërisht kriminel i varrakasë *Svetlan Martinoviç*, i cili thërret se pavijonet janë të dëmtuara, andaj të burgosurit duhet transferuar në *Burgun e Nishit*. Sipas urdhrit të tij, duhej bërë rresht 30 metra afër murit, në anën veriperëndimore. Kur u arrit rreshtimi për dy, ai urdhëroi të burgosurit të formonin rreshtin për katër. Ishte llogaritur se me rreshtimin për katër efekti i ekzekutimit do të jetë më i madh. Kjo edhe ndodhi.

Ende pa u rreshtuar mirë, *Svetlan Martinoviq*, i pari shtiu me “*Zola*” nga karakolli në mesin e kolonës. Kjo ishte shenjë për fillimin e plojës me breshëri gjuajtjesh me automatikë, snajperë, minahedhës, bomba dore dhe mitraloza. Ploja zgjati pak minuta të llahtarshëm që u përjetuan sa një shekull i jetës. Në këtë plojë ranë martirë mbi 60-80 veta dhe rreth 200 të tjerë u plagosën rëndë e lehtë. Ata që mundën, ikën në anën e kundërt të sulmuesve, shkuan në drejtim të *pavijonit B2*. Por, kundër tyre nuk u ndërpre shtënia nga snajperët prej një karakolli në pjesën tjetër të burgut. Në këtë rast vriten disa të i burgosur dhe disa plagosen.

Meqë të burgosurit, pengje shqiptare për kusuritjen me *NATO*-n dhe me *UÇK*-në, nuk kishin kah t’ia mbanin, u grumbulluan brenda dhe jashtë ndërtesës së *mensës* dhe të *ambulancës*, ku mendonim se ishin më pak të ekspozuar. Në ambulancë e sollën edhe ndonjë të plagosur, por ky numër ishte i vogël, pasi pjesa dërmuese e të plagosurve rëndë mbetën të shtrirë në fushën e sportit, midis të të vdekurve.

Pasi pushojnë të shtënat, një grup nga të burgosurit politikë planifikuan të kalonin në *pavijonin C1*, në mënyrë që prej aty, nëse do t’u jepej mundësia, të bartnin të plagosurit nga *vendi i plojës*. Ky pavijon ishte më afër për t’i bartur, por dukej edhe më i sigurt nga bombardimi i *NATO*-s, pasi

tashmë ishte bombarduar e bërë shoshë më shumë se çdo pavijon tjetër. Bartja ishte tejet e rrezikshme, duhej lëvizur rrëshqanas, pasi që nga karakollët shtënin, herë pas here, me snajperë dhe armë të tjera.

Në këto rrethana të jashtëzakonshme dolën mjaft sakrifikues dhe i tërhoqën të gjithë ata të cilët nuk mund të largoheshin vetë. Të plagosurit u vendosën në katin përdhes të anës së djathtë të *pavijonit C1*, në dyshekë, përgjatë tërë korridorit. Pastaj u mbushën edhe të gjitha krevatet e atij krahu dhe *salla e TV-së*.

Atë ditë, më 22 maj 1999, para së të errësohej, nga dera e hyrjes së burgut depërtoi brenda në oborr të objekteve një grup mbi 10 veta të maskuar, të uniformuar dhe të armatosur me automatikë, bomba dore dhe minahedhës. Ata shtinë gjithandej frontalisht me armët që kishin, kurse në puseta, ku kishte edhe të burgosur të fshehur, hedhën nga dy bomba dore dhe ekzekutuan disa të plagosur rëndë. Me predha minahedhësi shtinë në drejtim të pavijoneve e sidomos të *mensës*. Dhe, pasi vranë e plagosën edhe disa të burgosur, do të largohen prapë jashtë mureve të burgut.

Duke paraparë rrezikun se ata prapë mund të ktheheshin dhe të masakronin edhe të plagosurit, u vendos nga të burgosurit të organizohet vetëmbrojtje në *pavijonin C1*, që së paku t'u jepej

guxim të plagosurve. U bë një plan dhe një organizim i fuqishëm në rrethana të krijuara. Për fat nata kaloi vetëm me telashet për të plagosurit dhe për ushqim. Me të zbardhur dita e 23 majit 1999, njerëzit me maska hynë prapë brenda mureve, madje kësaj radhe ishin edhe më të organizuar. Grupit që kishte hyrë një natë më parë iu kishte bashkëngjitur edhe një grup tjetër, pak më i vogël, që të futej nga dera në anën veriore. Sulmuesit ishin me maska dhe me uniforma të ndryshme: të *ushtrisë*, të *policisë*, të “*paramilitarëve*” dhe të të *burgosurve*. Duket se kishin njohuri për fortifikimin në *pavijonin C1*, ndaj aty nuk mësyn. Bilanci i këtij krimi ishte rreth 30 të ekzekutuar nga afërsia.

Pas pak minutash, ekzekutorët e maskuar urdhëruan të burgosurit t’i linin pavijonet dhe të hynin të gjithë në *Sallën e sportit*, me “*arsyetimin*” se do të transferohen në një burg tjetër. Askush më nuk u besonte. Në pritje të vdekjes dëgjonin gumëzhimin e aeroplanëve të NATO-s mbi *Dubravë*. Meqë NATO-ja nuk po godiste, të maskuarit pas një konsultimi të gjatë që bënë jashtë sallës, sollën “*sihariqin*”: “...kemi menduar t’ju dërgojmë në burgje të tjera, por autobusët që duhej të vinin për t’ju marrë kanë hasur në një urë të prishur nga bombardimi i sotëm, ndaj deri të nesërmen do të jeni këtu...!”

Nuk u besohej, por duhej pritur, pasi edhe ashtu s’kishte rrugë tjetër. Ata shkuan, kurse të

burgosurit i tubuan të plagosurit e asaj dite, i bënë bashkë me të tjerët, në *Sallën e sporteve* dhe vazhduan kujdesin për ta.

Të nesërmen, më 24 maj 1999, ndodhi befasia: të gjithë të burgosurit do të transferohen në *Burgun e Lypjanit*. Pas 17 ditësh, pikërisht në ditën që u nënshkrua *Marrëveshja Tekniko-Ushtarake në Kumanovë*, midis Komandës së NATO-s dhe Komandës Supreme të Ushtrisë Jugosllave (Serbisë), ndodhi transferimi i të burgosurve shqiptarë - pengje të luftës në burgjet e Serbisë.

Një pjesë të kufomave, të të masakruarve, makineria ushtarake vrastare e Serbisë i varrosi, më 25 maj 1999, në një *varrezë masive në Rakosh*, kurse një pjesë i zhduku, me qëllim të zvogëlonte përmasën e krimit dhe të fshihte mënyrën e ekzekutimit, në rast të ekzaminimit kriminalistik për një gjyq ndërkombëtar.

Të përmbylim: Sipas të dhënave të sistematizuara nga përjetuesit e masakrës, të cilët ushtruan ndihmën e parë për të plagosurit, gjatë gjashtë ditëve sa zgjati *krimi alternativ NATO - Serbi* ndaj të burgosurve shqiptarë në *Burgun e Dubravës*, më 19-24 maj 1999, nga bombardimet e NATO-s humbën jetën 23 veta, kurse në plogat serbe janë vrarë 150-165 të burgosur, kurse janë plagosur mbi 200 vetë, prej të cilëve mbi 120 rëndë. Ky është numër aproksimativ sipas përlogaritjeve të të

përjetuarve të masakrës. Numrin e saktë të të vrarëve dhe të të plagosurve në këtë krim, në një institucion të mbrojtur me ligje ndërkombëtare, ka mundësi ta vërtetojë një gjyq ndërkombëtar i domosdoshëm, i cili do ta zbardhte krimin monstruoz ende tabu e të mbrojtur ndërkombëtarisht me heshtje institucionale vendore dhe ndërkombëtare.

Bislim Zogaj

ORGANIZIMI I NDIHMËS SË PARË NË BURGUN E DUBRAVËS

Nga granatimi i flotës ajrore të NATO-s në pavijonin “C”, më 19 maj 1999, *tre të burgosur mbetën të vrarë* dhe nëntëmbëdhjetë të plagosur, prej të cilëve tre rëndë (dy prej tyre ishin në gjendje kome), kurse *Abdylgafurr Luma* kishte një plagë të lehtë në kokë. Të burgosurit *Bislim Zogaj*, *Reshat Nurboja* dhe një tjetër me batanije i bartën dy të plagosur në gjendje kome deri në dalje të burgut, ku i vendosën në një makinë të ndihmës së shpejtë. U dërguan në *Spitalin e Pejës* dhe për fat shpëtuan.

Nga ky moment tre veteranët politikë, në themele të UÇK-së: *Nait Hasani*, *Bislim Zogaj* dhe *Bajrush Xhemaili*, një njëfarë dore, morën komandën të themi morale mbi të burgosurit - pengje të luftës. Këta, të ndihmuar nga tekniku i medicinës *Afrim Rifaj* dhe veprimtarët *Haqif* dhe *Sherif Ilazi*, *Njazi*

Kryeziu dhe Dëfrim Rifaj, si dhe nga Frashër Shabani etj., kanë filluar t'u japin ndihmën e parë të plagosurve dhe kështu i vunë themelet e Shërbimit të Ndihmës së Parë në krye me teknikun e medicinës me përvojë të gjatë, Bislim Zogajn - Hero i Dubravës, siç preferohet të quhet nga të mbijetuarit e masakrës.

Më 20 maj 1999 në *Burgun e Dubravës* mbretëronte pasiguria. Ndonëse shpresohej se “*ishte një gabim teknik i logistikës së NATO-s*”, më nuk dihej se prej nga mund të vinte vdekja. Më 21 maj 1999 aeroplanët e NATO-s e përsëritën granatimin e lokaleve përcjellëse më vitale të burgut: ngrohtoren, kuzhinën, sallën e sportit etj. *Në këto granatime u vranë 19 dhe u plagosën 32 të burgosur shqiptarë.*

Ekipi i shpëtimtarëve me *Bislim Zogajn* në krye, të përcaktuar për sakrificë sublime, kishte numër të vogël teknikësh të medicinës e shpëtimtarësh krahasuar me numrin e të vrarëve dhe të të plagosurve, ndaj ndihma, edhe në rrethana të një plobe mizore (kur jeta e çdo shpëtimtari ishte baras me vlerën e një plumbi të snajperistëve në pritje për krim), ishte vështirë t'u vihej në ndihmë të gjithëve me kohë dhe në të njëjtën kohë. Pas bombardimit të dytë, ishte krijuar një atmosferë e tmerrshme dhe trishtuese, kur dëgjoje të plagosurin me organe të brendshme të dala jashtë nga shpina dhe me këmbë të këputur në komblik (*Shani* dhe

Hasan Shala) duke thërritur: “... o Baci Nait, ..., o Baci Bislim, mos na leni vetëm, na ndihmoni...!”

E si t’u ndihmohej, kur bombat e NATO-s dhe snajperistët villnin vdekje mizore?! Kjo skëterrë zgjati rreth 3 - 5 minuta, por u përjetua e gjatë sa një shekull jete. Duke i dhënë ndihmën e parë të plagosurit *Zenullah Elshani*, do të plagoset, në shpatull, edhe *Nait Hasani*. Mirëpo, nuk u ndal duke ju dhënë ndihmë shokëve derisa edhe atij nisi t’i errësohej, të humbë vetëdijen.

Në mungesë të mjeteve sanitare, të peceve dhe të lidhëseve, plagët të plagosurve do t’u lidhen me pjesë të nënkëmishëve. Fillimisht, ndihma e parë të plagosurve u është dhënë në oborrin e burgut, para kuzhinës, e më pas te fushat e sportit, ku edhe e kanë kaluar natën të gjithë përjetuesit e bombardimeve të NATO-s.

Të nesërmen, në mëngjes, më 22 maj 1999, gardianët serbë ftuan të grumbullohen të gjithë të burgosurit, i rreshtuan kinse për transferim në ndonjë burg tjetër. Në momentin e volitshëm, sapo ishin grumbulluar të gjithë të burgosurit, ekzekutorët serbë filluan me të shtëna rafale nga të gjitha anët dhe me të gjitha llojet e armatimit të këmbësorisë. Në këtë ployë mbetën të vrarë rreth 80 të burgosur e pengje shqiptare. U plagosën shumë më tepër. Të plagosurit më lehtë, të cilët mund të ecnin, u drejtuan kah ambulanca e burgut, ku i

burgosuri më i guximshëm, *Bislim Zogaj*, ishte vu me dinjitet në detyrë edhe të operatorit kujdestar dhe sa kishte forcë ua jepte ndihmën e pare të plagosurve. Pas afër një ore te *pavijoni C1*, në katin përdhes, përgatitet vendi për t'i vendosur të plagosurit. Në të njëjtën kohë, të prirë nga *Muhamet Avdia*, filloi bartja e të plagosurve nga fushat e sportit. Bartjen e tyre do ta realizojnë, me shumë rreziqe për jetën: *Bajrush Xhemajli, Defrim Rifaj, Haqif Ilazi, Niazi Kryeziu, Bislim Zogaj* etj.

Atmosfera e krijuar nga ploja e papritur dhe tepër mizore, ishte e tmerrshme! Nuk qaheshin martirët, por vajtohej pa lot e pa gjëmë për të martirizuarit e gjallë. Të plagosur kishte shumë, plagët ishin të shumta dhe nga më të rëndat, ndërsa mjete adekuate për dhënien e ndihmës së parë nuk kishte të mjaftueshme as cilësore. Por, me një mobilizim të jashtëzakonshëm nga *Bislim Zogaj, Nait Hasani* (edhe pse i plagosur), *Haqif e Sherif Ilazi, Niazi Kryeziu, Defrim Rifaj, Abaz Beqiri, Frashër Shabani* etj., të cilët kishin arritur të siguronin pak material sanitar nga ambulanca e burgut, dhe me nënkëmishët e trupit, me përpjekje mbinjerëzore, arritën që sado pak ta zbusnin mungesën e mjeteve për ndihmë të parë.

Në ndërkohë, dikush nga të burgosurit arriti që në ambulancën e burgut të gjejë pak jod dhe disa çarçafë të rinj, prej të cilëve do të sigurohen fashe

për lidhje. Dhënia e ndihmës së parë vazhdoi deri natën vonë. Kujdesin për të plagosurit gjatë tërë natës, roje kujdestare kundër vdekjes së shokëve, pa ngrën as bukë gati tre njëzetekatër orë, e kreu drenicasi *Bislim Zogaj*, i ndihmuar nga *Nait Hasani*, *Avdi Mehmeti*, *Bajrush Xhemaili*, *Defrim Rifaj* e të tjerë, si vlera morale për të plagosurit durimtarë dhe urtues për të pagajretët.

Këta veprimtarë politikë, duke pasur pranë këmbëve tridhjetë deri në dyzet djelmosha të gatshëm të falnin jetën në mbrojtje të të plagosurve, u përcaktuan për rezistencë fizike kundër atyre që do të mësynin masakër të ri ndaj të plagosurve në *pavijonin C1*. Në hyrjet e pavijonit vendosën katapulte, caktuan personat që do t'i tërhiqnin litarët pas komandës dhe të tjerët, në vijën e parë, që do të mbytnin sulmuesit me shufra hekuri e me “*armë*” të tjera të ftohta. Pra, këta burra ishin përcaktuar paraprakisht për një vdekje heroike para shokëve të plagosur.

Të nesërmen, më 23 maj 1999, nisi tmerri të thellohet që nga mëngjesi. Serbët paramilitarë e paramilitarë kriminelë, gardianët dhe administratorët e burgut, të uniformuar dhe civilë, organizuan një sulm të tmerrshëm, tepër kriminal, në objektet ku ishin strehuar të burgosurit shqiptarë, me përjashtim të *pavijonit C1*, të fortifikuar. Sulmuesit ishin të informuar për gatishmërinë për rezistencë për të

plagosurit në *pavijonin C1*, andaj u frikësuan të rrezikonin jetën e ndonjërit sulmues.

Sulmi i parë me bombe dore u bë në ambientet e ngrohtores. Tani hynë me armë automatike e revole me plumbin në tytë dhe qëlluan të burgosurit me sadizëm të paparë, me plumb në ballë. Aty i ekzekutuan 11 veta. Ekzekutorët e tjerë depërtuan rrufeshëm në objektet e tjera dhe ekzekutuan, pike-çok, edhe 19 të tjerë. Nga ky rund i krimit nuk pati shumë të plagosur, sepse të gjithë u qëlluan me plumb në ballë, në gojë, në kokë, në zemër - nga afërsia e dorës. Të plagosurit kishin plagë nga armët ofensive, bombat e hedhura në puseta, në kthina të errëta etj. Midis të ekzekutuarve pati edhe disa të burgosur ordinerë, të cilët gjatë u kishin shërbyer gardianëve si spiunë. Të tillë ka në çdo burg. Kështu, ekzekutimi i *mëngjesit të 23 majit 1999* e thelloi tmerrin dhe pasigurinë e përgjithshme.

Pak minuta pas ekzekutimit të 30 të burgosurve, personeli i burgut i ftoi të përjetuarit e *ekzekutimit të 23 majit 1999* të tuboheshin në *Sallën e sportit*. Të burgosurit, përpos atyre në *pavijonin C1*, të cilët ndihmonin dhe kuronin të plagosurit, iu përgjigjen urdhrit, pa vonesë. Këta, të themi kushtimisht, në *mbrojtje të spitalit*, e ndjenin vështirë heqjen dorë nga planifikimi i rezistencës për mbrojtjen e të plagosurve. Përgjegjës moral për

hapa të mëtutjeshëm, për fatin e të plagosurve dhe të të gjithë të burgosurve - pengje lufte, tashti ishin katër veta: *Bajrush Xhemaili, Avdi Mehmeti, Nait Hasani dhe Bislim Zogaj*, të mbështetur fuqimisht në rreth 25 veta, të barrikaduar në *pavijonin C1*. Pas ultimatumit të tretë, që u vinte përmes të dërguarve nga *Salla e sporteve*, falë urtisë së *Bajrush Xhemailit*, hoqi dorë nga rezistenca e planifikuar, së fundi, edhe *Avdi Mehmeti*. Njësitë e shpëtimtarëve mori me vete, mbi supe, të plagosurit e palëvizshëm dhe iu bashkua grumbullit në *Sallën e sporteve*.

Pas pak minutash, sapo pjesa militante e ekzekutorëve u tërhoq nga salla dhe rrethina e saj, ekipi i shpëtimtarëve - i ndihmës së parë në krye me *Bislim Zogajn* u aktivizua. Të plagosurit u sollën në *Sallën e sporteve* ku do t'u ofrohet ndihma e parë. Plagët ishin të tmerrshme, kishte të plagosur me shumë plagë në trup. P.sh., *Valdet Rama* kishte tetë plagë të rënda e disa të tjera më të lehta dhe ishte vështirë t'i jepej ndihma e parë. Cilën plagë t'ia lidhje më parë? Si ta vendosje? Në çfarë pozite, kur në tërë trupin kishte plagë? Po kështu ishte me *Fatmir Tafallarin*, i cili kishte shumë plagë dhe gjakderdhje të madhe. Shumë plagë kishte edhe *Abdylgjemil Alimani*, i cili vetë i nënti ishte gjetur në një pusetë kur paramilitarët ua kishin hedhur dy granata dore. Të gjithë ishin plagosur, por *Abdylgjemili* kishte më së shumti plagë me

gjakderdhje shumë të mëdha. I burgosuri *Bedri Kukalaj* njëzet e katër orë qëndroi, i plagosur, në mesin e të vrrarëve. Atë e vërejti një i burgosur dhe e solli në *Sallën e sportit* në gjendje të pavetëdijshme. Plumbi e kishte marrë në nofull.

Numri i të plagosurve me shumë plagë dhe me plagë të rënda ishte shumë i madh, ndërkaq dhënia e ndihmës së parë do të vazhdojë gjatë tërë ditës. Njëkohësisht, të plagosurve para një e dy dite do t'u pastrohen plagët me jod. Kështu, në natën e 23/24 majit 1999, përveç rreth 150 vetave që kishin plagë më të lehta dhe kishin shkuar me shokë nëpër pavijone, në *Sallën e sportit* ishin 106 të plagosur rëndë, të palëvizshëm, për të cilët gjatë natës u përkujdesën *Bislim Zogaj, Nait Hasani, Abaz Beqiri, Asllan Selimi, Dylber Beka* dhe *Shefqet Kabashi*.

Të nesërmen, më 24 maj 1999, pa asnjë paralajmërim, të gjithë të burgosurit, të shëndoshë dhe të plagosur, do t'i transferojnë me autobusë nga *Burgu i Dubravës* në *Burgun e Lypjanit*. Me një fjali: Nisi odesiada e re e të burgosurve dhe e pengjeve, për të pritur *çlirimin e Kosovës* nëpër burgjet e Serbisë.

Krejt në fund, duke përfunduar, është me rëndësi të konstatojmë dy fenomene: E para, fati i kolektivitetit shqiptar në *Burgun e Dubravës* e deshi që veprimtarët politikë më të shquar, *themelues dhe luftëtarë të UÇK-së* përreth *Nait Hasanit* dhe *Bislim Zogajt*, të cilët e organizuan dhe e ushtruan

madhërisht dhënien e ndihmës së parë të plagosurve nga *bombardimet e NATO-s* dhe në *plojat e soldateskës serbe*, nuk u dëmtuan rendë, i ruajti *Zoti* për të ndihmuar të tjerët dhe veçanërisht *e ruajti Zoti Heroin e vërtetë* të organizimit dhe të dhënies së ndihmës së pare, veprimtarin dhe luftëtarin e orëve të para të UÇK-së, mbitrimin *Bislim Zogaj*. Dhe, e dyta, edhe përkundër gjithë atij tmerrri që përjetuan të burgosurit shqiptarë në këtë golgotë, gjendja psikike dhe shpirtërore e shumicës së tyre ishte e mirë dhe stabile, madje heroike. Gjatë gjithë kësaj periudhe të kalvarizimit vetëm dy të burgosur ordinerë bënë vetëvrasje dhe një i burgosur ordiner pësoi infarkt.

Xhevat Haziri

DËSHMI PËR MASAKRËN E DUBRAVËS NGA BISEDAT MIDIS GARDIANËVE

Në kujtesën e shqiptarëve janë të njohura format e veprimit dhe krijimi i preteksteve për vrasje, ekzekutime dhe shfarosje në masë të shqiptarëve nga pushtuesi serb në periudhën nëntëdhjetëvjeçare të okupimit të Kosovës.

Masakra serbe në *Burgu i Dubravës* është krim që nuk harrohet. Numri i saktë i të burgosurve dhe i pengjeve shqiptarë, që përjetuan atë golgotë, ende nuk dihet, por, duke u bazuar në disa të dhëna nga

bisedat midis gardianëve, ky numër, në periudhën kritike prill–maj 1999, ishte mbi 950 veta. Vërtet, *Masakra e Dubravës* u zhvillua nëpër tri shkallë. Periudhën deri më 18 maj e karakterizoi shkalla e lartë e torturave, e përcjellë edhe me likuidime individuale (Mr. *Ukshin Hotin*, më 16 maj 1999); periudha treditore, 19-21 maj, i përket krimit ndërkombëtar përmes bombardimeve të NATO-s nga ajri - si uverturë për plojën serbe të planifikuar, dhe periudha triditore tjetër, 22-24 maj, shënoi realizimin e projektit me ekzekutimin kolektiv të të burgosurve dhe të pengjeve shqiptare.

Në mungesë të burimeve të shkruara për zhvillimet, për numrin e të vrarëve dhe të të plagosurve, jam përpjekur të evidencoj thënie nga bisedat e personelit të burgut, të përgjuara dhe të dëgjuara nga të burgosurit gjatë dhe pas ngjarjeve tragjike.

Nisemi nga 30 prilli 1999, kur të burgosurit nga *Burgu i Gjilanit* u transferuan në *Burg të Dubravës*, pikërisht në *pavijonin C*. Aty, në një kënd të korridorit të pavijonit, pas një kohe, u bë evidencimi i pazakontë. U kërkuan të dhëna që ishin më të plota në dosjen e akëcilit të burgosur dhe evidencimi i gjësendeve që mbanin të burgosurit.

Pas vendosjes në pavijone ndaj të burgosurve nisi të zbatohet një trajtim i egër, çnjerëzor dhe barbar. Kushtet e fjetjes dhe të higjienës ishin të

shkallës së kushteve në llogore të përqendrimit nazist për shfarosje të një race tjetër. Preteksti për *Masakrën e planifikuar* u paraqit pikërisht më 19 maj, sapo ndodhi bombardimi i parë i NATO-s në *pavijonin C*. Midis të vdekurve nga ky bombardim ishin edhe veprimtarët politikë emblematikë të çështjes kombëtare: *Abdullah Tahiri e Enver Topalli* dhe *Gjokë Ndrecaj*, ndërsa midis të plagosurve rëndë: *Agim Thaçi, Gjergj Karaçi dhe Kamer Hima*.

Këtu duhet theksuar faktin se të burgosurit jashtë *pavijonit C* i thyen dyert e dhomave dhe i nxorën jashtë të burgosurit e ngujuar. Fakti se nuk pësoi asnjë gardianë dhe serbë të tjerë nga personeli i burgut tregon se ata ishin të informuar për bombardimet dhe ishin strehuar me kohë në vende të sigurta. Në ndërkohë u kthyen gardianët, i rreshtuan të burgosurit e *pavijonit C* në oborr dhe ua bënë me dije se do t'i kthejnë, prapë, në objekt të mbyllur. Me gardianët tashti komandonte një person i panjohur për të burgosurit. Ai i urdhëroi gardianët që të burgosurit “t’i vendosnin në korridorin e shkollës...!” Një gardian do t’i ndërhyjë: “Si, janë mbi 250 veta, qysh do të rrinë në korridor...!?”. Eprori ia ktheu prerazi: “Unë thashë se duhet të vendosen në korridorin e shkollës dhe kështu dubet të bëhet, a u kuptuam...?!”

Ditën e 20 majit 1999, të burgosurit *Burgun e Dubravës* e kaluan në ankth, ndërkaq bombardimet e

NATO-s të 21 majit e rritën pasigurinë edhe më shumë. Numri i të vdekurve dhe i të plagosurve tashti ishte i madh. Natën e 21/22 majit 1999 shumica e të burgosurve natën e kaluan nën qiellin e hapur në fushën e sporteve dhe pranë pavijoneve. Në mëngjesin e hershëm të 22 majit 1999 një gardian, nga dritarja e karakollit verior të burgut, u urdhëroi të burgosurve: *“Ngrihuni dhe rreshtobuni se së shpejti do të arrijnë autobusët dhe ne, për të mirën tuaj, do t’u transferojmë për në Nish, por duhet të shpejtoni...!”*

Urdhrit nuk mund t’i bishtërohej. Pa vonuar, u krijuan katër rreshta të gjatë në drejtimin perëndim-lindje. Nga tri anë të rreshtit të të burgosurve mbi rrafsh të murit ishte vërë paraprakisht pusia e ekzekutorëve me armatim automatik e shpërthyes. Në një moment, me shpejtësi marramendëse, filluan bataretë nga dy anët e mureve dhe nga karakolli në kënd të mureve, nga kishte ardhur komanda për rreshtim. Predhat dhe bombat korrën mbi tetëdhjetë dhe mbi njëqind të tjerë plagosën rëndë dhe lehtë.

Dita dhe nata e 22 majit u përballuan me përpjekje maksimale të *djalërisë ademiashariane* përreth *Bislim Zogajt* dhe *Nait Hasanit*, për të ndihmuar dhe kuruar të plagosurit. Ankthi me vdekje të përgjakshme para syve të secilit të burgosur do të thellohet në orët e hershme të mëngjesit të datës 23 maj 1999. Tashti paramilitarë e personel me

uniforma ushtarake hynë brenda në objekte dhe ekzekutuan, duke i zgjedhur disa dhjetëra të burgosur.

Tmerri sa vinte dhe po thellohej. Ekzekutori priste pretekstin për t'i ekzekutuar të gjithë. Ky pretekst duhej të ishte fillimi i ribombardimit nga aeroplanët e *NATO-s* në objektet e burgu. Për ta lehtësuar realizimin e këtij plani, të burgosurit nga të gjitha objektet i mbyllën në sallën e sporteve. Jashtë, nga dritaret, shiheshin ekzekutorë të armatosur me minahedhës dhe në gjendje gatishmërie për granatim brenda në sallë. Tashti ishte e qartë për akëcilin të burgosur se vuajtjeve të tyre po u vinte fundi. Vetëm një shpresë i mbante të fortë: "*Liria e Kosovës është në prag. Ne jemi në themele të saj...!*" - ishte pëshpëritja që pushtoi sallën ku pritej vdekja pa lemerisje, kurban për lirinë e *Kosovës* dhe ribashkimin e *Shqipërisë Etnike*.

Një ushtar, i cili, me gjasë, duhej të ishte brenda derës në sallë deri në sinjalin e dhënë, të burgosurve ua përcolli porosinë e eprorëve: "*Nëse gjuajnë aeroplanët e NATO-s ju ulni kokat...!*". Kjo, me fjalë të tjera, do të thoshte: "*Mbyllni sytë të mos i shikoni ekzekutorët e vërtetë!*" Për fat, më nuk ndodhën bombardimet, nuk u krijua preteksti për ekzekutime të tjera.

Kohë pas kohe në *Sallën e Sporteve* vinin gardianë e ushtarë dhe dilnin. Më në fund hyri një

ushtar dhe një gardian me fytyrë të mbuluar. Ushtari i ndau të burgosurit në pesë grupe, përafërsisht nga njëqind veta. Midis ushtarit dhe gardianit në sallë, para të burgosurve, do të zhvillohet një dialog që meriton të dihet: Ushtari, sapo e përfundoi numërimin, i tha: *“Këtu, përafërsisht janë pesëqind...!”* Ndërsa, gardiani, pa hezitim, ia ktheu: *“Mirë, atëherë gjysmën i paskemi...!?!”* Ushtari pyeti: *“Sa kanë qenë...?”*, kurse gardiani iu përgjigj: *“Kane qenë 954...”*

Dinte gardiani për numrin e saktë të të përqendruarve në *Burgun e Dubravës*, në këtë kohë, kjo duhet të vërtetohet me burime të shkruara, me statistika. *Faktori Ndërkombëtar i Vendosjes* duhet ta detyrojë *Serbinë* të ofrojë dosjet dhe dokumentet e tjera për të burgosurit në këtë kasaphane serbe ndaj shqiptarëve dhe të masakruarve. Më në fund, në agimin e datës më 24 maj 1999, një gardianë të burgosurve u solli sihariqin me plot ankth: *“Tash do t’ju dërgojmë për Mitrovicë (të Kosovës), ndërsa gjatë rrugës, pranë ndonjë mali, mund të zbritni vetëm një herë, për nevoja tuaja...!”*

Zhvillimet në burg për pesë ditë me radhë, ekzekutimet pa asnjë pretekst nga të burgosurit dhe informata paraprake se të burgosurit *“mund të zbritni vetëm një herë”, për nevoja fiziologjike “pranë ndonjë mali”,* nuk kishte se si të mos kuptohej si kurth i ri

për ekzekutime të tjera. Sidoqoftë, urdhri nuk mund të kundërshtohet, duhet pritur fundin me stoicizëm.

Vërtet, transferimi ndodhi, por në *Burgun e Lypjanit*, e prej andej, nga fundi i bombardimeve të NATO-s mbi makinerinë ushtarake serbe në Kosovë e gjetkë, u bë transferimi në *burgjet e Serbisë*. Kjo, e tëra, është temë për ndriçim të veçantë.

Isak Shabani

DEGDISJA E TË PËRJETUARVE TË MASAKRËS NË KAZAMATET SERBE

Për të burgosurit shqiptarë në *Burgun e Dubravës*, pasiguria nuk përfundoi me llahtarinë e ditëve 19-24 majit 1999. Ajo do t'i përcjellë gjatë degdisjeve të tyre nëpër kazamatet serbe në *Serbi e Vojvodinë* edhe gjatë tri vjetëve në vazhdim. Pas asaj masakre të tmerrshme, që kishte ndodhur gjatë atyre pesë ditëve në *Burgun e Dubravës*, më 24 maj 1999, rreth orës 7⁰⁰, në *Dubravë* arritën *tetë* autobusë dhe *tre* kamionë për t'i transferuar të burgosurit në *Burgun e Lypjanit*. Në autobusë u ngarkuan të burgosurit që kishin shpëtuar pa u dëmtuar fizikisht dhe ata me plagë më të lehta, kurse me kamionët do të transferohen të burgosurit e plagosur rëndë, të palëvizshmit.

Veprimtarët e shquar *Nait Hasani* (i plagosur lehtë), *Bislim Zogaj*, *Asllan Selimi* dhe *Dylber Beka*, i

bartën të plagosurit nga salla e sportit, i vendosën në kamionë dhe vetë u vendosën në kamionin e fundit. Ishte përvojë e tmerrshme vendosja e 106 të plagosurve të palëvizshëm në një hapësirë aq të vogël (vetëm në tre kamionë). Rrugëtimi ishte mjaft i gjatë, rreth 4 orë, dhe shumë i mundimshëm, veçanërisht për të plagosurit. Ky ishte një krim serb në vijimësi ndaj të burgosurve shqiptarë.

Në oborrin e *Burgut të Lypjanit* kordoni i gardianëve dhe i paramilitarëve të uniformuar ishte përgatitur paraprakisht për të ushtruar dhunë fizike ndaj pengjeve shqiptare. Këta gardianë i udhëhoqi drejtori i burgut të Prishtinës - Lypjanit, oficeri *Luba Qimburoviq*, në uniformë ushtarake. Të burgosurit fillimisht i rreshtuan në oborr. I nisën për në dhomat e pavijoneve 2, 3 dhe 4, duke i rrahur me shufra gome, shqelma dhe grushte. Njësoj do të veprohet edhe me trimat që bartnin të plagosurit një nga një, me batanije, për në pavijonin nr.1, duke mos i kursyer as të plagosurit e shtrirë mbi batanije. Kjo dhunë fizike çnjerëzore u bë shkak për vdekjen e tre të plagosurve, po atë ditë, më 24 maj 1999, në *Burgun e Lypjanit*. Vdekjen e këtyre tre të plagosurve të burgosurve shqiptarë ua dëshmoi i burgosuri *Momçilo Stojkoviq*, i cili ua shpërndante bukën të burgosurve. Këtë emër e përmendi për nevoja të hetuesisë së krimit.

Këtu duhet të përmendet fakti se të plagosurit në *pavijonin 1* i vendosën nga 15 deri në 30 veta në një dhomë, kurse të tjerët në *pavijonin 2, 3* dhe 4, nga 30-32 veta në një dhomë me sipërfaqe përafërsisht 5x5 metra. Kushtet jetësore në këtë burg tashti ishin shumë të rënda. Të plagosurit, më 24 maj 1999, nuk i vizitoi asnjë ekip mjekësor. Të nesërmen, më 25 maj, një ekip mjekësh u bëri “vizitë” të plagosurve. Disave ua kuruan plagët në dhomë, kurse disa me plagë shumë rënda i dërguan në spitalin e Prishtinës. Këta edhe tashti, me rastin e transportimit në *Spitalin e Prishtinës*, përjetuan tortura mizore nga gardianët dhe personeli mjekësor.

Të konstatojmë edhe këto fakte: Kurimi mjekësor në *Spitalin e Prishtinës* nuk ishte në shkallën profesionale mbi *Betimin e Hipokratit*. Dëshmi për këtë është përvoja e një të plagosuri, të cilit “*dubej*” t’ia amputonin krahun e plagosur. Duke e futur në operacion, kirurgu vërejti se i plagosuri në parallërë i kishte të tetovuara inicialet *JNA* (Jugoslavenska Narodna Armija) dhe kjo u bë fat që të mos ia amputonin krahun. Rasti tjetër ishte edhe më fatal. Një i plagosur në *Masakerën e Dubravës* i kishte të dëmtuar *shputën e këmbës* dhe *penisin*. Atë do ta pyesin: “*Dëshiron ta amputojmë shputën apo penisin...*”!? Kirurgët serbë, me këtë rast, u treguan “*zemërgjerë*” dhe ia amputuan vetëm shputën e këmbës.

Pas intervenimit kirurgjik, të plagosurit ende të pashëruar mirë, i kthenin në *Burgun e Lypjanit*. Jeta e të burgosurve në këtë burg ishte shumë e vështirë. Në dhomat e burgut nuk kishte WC as ujë për pije. Për këto nevoja, të mbyllurit duhej të thirrnin gardianët, e kjo sillte pasoja, pasi ata zakonisht ushtronin dhunë. Të theksohet edhe ky fakt: gjatë *shtatëmbëdhjetë ditëve*, nga 24 maji deri më 10 qershor 1999, sa të burgosurit i mbajtën në *Burgun e Lypjanit*, asnjëherë nuk u krijuan rrethana për pastrim dhe ndërrim të rrobave. Dhe, presioni më i rendë ishte mungesa e ushqimit. “*Buka*” shtrohej dy herë në ditë, por në sasi simbolike: *nga një të katërtën e bukës dhe një gjysmë gote gjellë të ligë për katër vetë*.

Pas marrëveshjes së Kumanovës, pikërisht më 9 qershor 1999, rreth orës 22, sa kishin rënë në gjumë, në pavijone shkoi gardiani *Avda Shutaković* dhe i urdhëroi të burgosurit të ngriheshin, se do t’i transferonin gjetkë dhe u sugjeroi: “*Të mos provonin diçka të keqe...!*” Të burgosurve ua lidhën duart me litar dhe ashtu, me duar të lidhura, i mbajtën deri të nesërmen, më 10 qershor 1999, kur i nisën me autobusë për në burgjet e Serbisë, kryesisht në *Nish, Pozharevc, Mitrovicë të Sremit* dhe në *Burgun Qendror të Beogradit*. Në nisje e sipër nga *Lypjani*, gardiani *Avda* i urdhëroi gardianët përcjellës: “*Nëse vetëm kokën e ngrit dikush, qëllojeni në ballë, pa asnjë paralajmërim...!*”

Rrugëtimi ishte i gjatë dhe i tmerrshëm, veçanërisht për të plagosurit me varrë të infektuara. Në burgje e Serbisë, të burgosurit shqiptarë do të priten me tortura nga gardianët, kurse në spitalin e *Burgut Qendror të Beogradit* të plagosurit shqiptarë, përpos nga gardianët, do të torturohen edhe nga personeli mjekësor dhe nga të burgosurit serbë. Për këtu të mjaftohemi vetëm me këtë konstatim: Më së keqi e pësoi i burgosuri *Bedri Kukalaj*, të cilit ia verbuan syrin, përjetësisht.

Në *Burgun e Nishit* u dërguan mbi 400 të burgosur në kushtet mizore për ekzistencë. Në një dhomë sistemuan deri në 30 vetë, kurse ushqimi ishte shumë i pakët dhe i dobët. Racioni tri herë në ditë nga një të gjashtën pjesë të bukës, dhe nga një gjysmë pjate gjellë (vetëm lëng) për dy vetë dhe një lugë për t'u shërbyer të dytë. Shpeshhere, shumë të burgosur humbnin vetëdijen në mungesë të ushqimit.

Kjo mynxyrë e ushqimit zgjati afro pesë muaj, derisa nisi lejimi i vizitave familjare. Kontaktet e para me familjarët ishin tmerr. Të burgosurit ishin asht dhe lëkurë. Ndihmë mjekësore adekuate nuk ekzistonte. Në raste shumë të veçanta të sëmurit i dërgonin në ambulancën e burgut, por gjatë rrugës i torturonin të burgosurit serbë.

Të burgosurit shqiptarë në *Mitrovicën e Sremit*, përveç që kishin kaluar nëpër të gjitha mynxyrat e

përmendura më sipër, ishin të detyruar të punonin edhe punë të rënda fizike, ndonëse ishin të uritur. E njëjta gjendje mbretëroi edhe në *Burgun e Pozharevcit*. Këtu, për të burgosurit shqiptarë “*përkujdeseshin*” ish-gardianët e *Burgut të Dubravës*.

Të burgosurit shqiptarë degdiseshin nga një burg në një burg tjetër, sepse edhe vetë ndërrimi i burgut për të burgosurit ishte një torture *sui generis*. Në nëntorin e vitit 2000 të burgosurit ordinerë serbë i dogjën burgjet në *Nish*, në *Pozharevc* dhe në *Mitrovicë të Sremit*, kryesisht pavijonet ku ishin të vendosur të burgosurit shqiptarë. Pas këtyre djegieve të burgjeve, të burgosurit shqiptarë, përsëri, do të degdisen nëpër burgje më të vogla anë e mbanë *Serbisë*. Jeta në ato burgje ishte e rëndë. Në ambient shumë të ngushtë vendosej numër enorm i të burgosurve shqiptarë.

Gjatë gjithë periudhës rreth trevjeçare pas Masakrës së Dubravës, të burgosurit shqiptarë përjetuan edhe shumë e shumë vuajtje e tortura të tjera fizike e psikike që nuk mund të merren me mendje të shëndoshë.

Pushtuesi serb nuk ngopej me kaq. Edhe pas trysnisë së faktorit ndërkombëtar për lirimin e të burgosurve shqiptarë, lirimi do të realizohet në mënyrë selektive dhe një periudhë kohore të gjatë, në mënyrë që pushtuesi serb të përfitonte sa më shumë nga faktori ndërkombëtar. Kjo ishte edhe një

nga torturat dhe padrejtësitë e mëdha që iu bënë të burgosurve shqiptarë - pengje të luftës.

Duke përfunduar, duhet të konstatojmë një fakt, fenomen njerëzor. Të masakruarit, të vrarët ose të plagosurit, dhe të martirizuarit në *Burgun e Dubravës* dhe gjetkë në burgjet serbe, në përgjithësi, patën qëndrim të dinjitetshëm. Veçanërisht të burgosurit politikë. Asnjëri nga këta nuk u thye, asnjëri nuk iu shit pushtuesit serb për interesa personale. Më në fund, ata të burgosur politikë që mbijetuan tmerrin, para gjatë dhe pas *Dubravës*, do të lirohen të papërkulur dhe krenarë, vlerë e madhe morale e kombit.

Ismet Mahmuti

MENDIMI POLITIK I UKSHIN HOTIT NË BURGUN E DUBRAVËS

Kish kohë që në burgjet serbe kishte depërtuar informata se mr. *Ukshin Hoti* është ridënuar në *Gjykatën e Qarkut të Prizrenit* dhe të burgosurit politikë në Burgun e Dubravës e prisnin transferimin e tij në mesin e tyre. Në pritje të tij akëcili i burgosur politik në imagjinatën e vet kishte konceptuar një model njeriu që do t'i ngjante *Ukshin Hotit*. Ishte viti 1995, kur nga *Burgu i Prizrenit* e sollën në atë të *Dubravës*, i dënuar me 5 vjet burg. Ishte dënuar me *Akuzën* se *kishte cenuar tërësinë*

territoriale të shtetit jugosllav, duke dashur ta bënte “*Shqipërinë e Madhe*”!?! Gjithashtu, i vihej në barrë edhe akuza se kishte ndihmuar dhe kishte bashkëpunuar me *Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK)*. Akuzohej edhe për „*faje*” të tjera politike, por siç thoshte edhe vetë *Ukshini*, këto dyja ishin „*fajet*” më të rënda.

Viti 1995 ishte njëri ndër vitet e deklarimeve të shumta verbale për zgjidhjen e çështjes së lirisë së Kosovës me dialog me Serbinë. Këto deklarime në fund të fundit s’ishin gjë tjetër veç një dëshirë, e cila kishte marrë kah krejtësisht tjetër ndaj qëllimit. Shërbimi sekret i Serbisë dhe policia e okupatorit, në këto rrethana, ishin fokusuar në ndjekjen e atyre që tregonin gatishmëri për veprim politik e ushtarak kundër Serbisë.

Pushtuesi serb në veçanti donte të eliminonte ndikimin e atyre, të cilët në një moment të caktuar do të mund të bëheshin udhëheqës politikë për të gjitha shtresat. Serbia nuhaste kohë dhe rrethana të tjera, andaj nuk dëshironte që asgjë t’ia linte rastit.

Arrestimet e mëhershme, e në veçanti arrestimi i *Ukshin Hotit*, ishin në funksion të asaj që, edhe po të ndodhnin rrethana, të mbetej rast i humbur për shqiptarët. Sido që të jetë, koha tregoi se llogaritë e Serbisë për rastet e humbura ishin dështim për të, por edhe me pasoja shumë të mëdha për shqiptarët.

Shkakun e arrestimeve serbe të veprimtarëve politikë shqiptarë e dinte profesor *Ukshin Hoti* më mirë se askush tjetër. Madje, ai i dinte dhe i sqaronte faktet historike se okupatorët me së lehti arrijnë të ushtrojnë okupimin mbi popuj në rastet kur atyre u vihen në ballë udhëheqës të pakontrollueshëm si produkt i rrethanave të caktuara politike. Profesor *Ukshin Hoti* në qelitë e burgut, ose në kolektiv, ishte një mësues politik me ndikim të madh. Nuk hezitonte të saktësonte: „*Okupatorët provojnë që përmes individit të kontrollojnë masat e gjera...*”

Thellësia e mendimit politik që kishte *Ukshin Hoti* vihet në spikamë edhe në një rast tjetër në *Burgun e Dubravës*. Ndodhi që për shkak të deklarimit të tij në *Gjykatë* se *arrestimi i tij ishte mirëpritur apo stimuluar nga disa qarqe të alternativës politike shqiptare në Kosovës*, bëri që disa nga të burgosurit ta shikonin pak si ijas. Mirëpo, pas kontakteve dhe bisedave me *Ukshinin*, në qeli ose në ambiente të hapura ata do të kuptojnë se janë viktimë e karakterit të tyre që ua keqpërdorte dikush tjetër.

Në ato kontakte e biseda me të burgosur *Ukshin Hoti* përpiquej që bashkëbisedave t’ua sqarojë faktin se për ta nuk duhet të ekzistojë motivi i rrejshëm për t’u përballur me sfidat në burg, por motivi real duhej të ishte fakti se tek ata të ekzistojë dëshira reale për bërjen e shtetit dhe gatishmëria e të vepruarit konkret.

Bindja politike e shumë të burgosurve se për bërjen e shtetit mjafton të vuajnë atë që vuanin dhe besimi në atë se, sa më e madhe të jetë akuza, aq më e madhe do të jetë fama, ishte një vetëmashttrim për akëcilin të burgosur. Në këtë drejtim profesor *Ukshin Hoti* mbronte tezën se ushtria dhe shteti lindin në luftë, se ushtria dhe shteti nuk janë pjellë e pacifizmit.

Mësimet politike të *Ukshin Hotit* gradualisht, për rrugët që mund të sillnin në liri, do të përvetësohen edhe nga ithtarët e alternativës pacifiste. Sipas Ukshinit, vrapimi pas famës mund të shpjerë në *donkishotizëm*, kurse veprimet politike kanë kuptim në vete, vetëm atëherë kur një njeri apo shumë sish me veprimet e tyre bëjnë që fama t'u vijë pas.

Mendimi politik i *Ukshin Hotit* në përgjithësi është i njohur për opinionin shkencor dhe politik. Në burg ato ishin vlerë me vete. Mund të themi se shumë nga mendimet e tij edhe sot funksionojnë si mesazh i qartë për zgjidhjen e problemeve më madhore që kemi si popull dhe si komb. Të vë këtu në spikamë mendimin e *Profesor Ukshinit* përreth idesë së bashkimit kombëtar shqiptar: „*Bashkimi kombëtar dubet bërë, ky bashkim imponohet si domosdoshmëri për zhvillimin normal, stabilizues dhe të sigurisë që i takon kombit. Mirëpo, për ta bërë këtë, shqiptarët dubet kuptuar se Piemont i idesë së bashkimit*

*duhet të jetë Tirana. Çdo përpjekje që bëhet pa u kuptuar
kejo, është vetëm në funksion të asaj që ideja të ekzistojë...!”*

S’do mend se mendimi politik i *Ukshin Hotit* në *Burgun e Dubravës* nuk ishte në harmoni me mendimet e atyre që kishin botëkuptim poetik e letrar për bërjen e shtetit e të bashkimit kombëtar. Dhe, për faktin se *Ukshini* aktualisht konsiderohet i zhdukur, nuk është aspak e dobishme, e mbi të gjitha nuk është e njerëzishme, që mendimi i tij politik të përshtatet me mendimet devijante të akëcilit sot. Shembull tipik për këtë tendencë është, *Naser Hysaj*, me “*Dubrava - Rruga drejt vdekjes*” (!?!).

Duke e analizuar në rrethana të lirisë mendimin e *Ukshin Hotin*, të cilin arrinte t’ua shfaqte bashkëvuajtësve shqiptarë në rrethana burgimi të një okupatori më çnjerëzor, mund të përfundosh esëll: Ai ishte kolos i mendimit politik i pashfrytëzuar nga shoqëria shqiptare në periudhën përgatitore për *Luftën Çlirimtare të Kosovës*. Ishte fat, edhe në burg, të ishte pranë *Ukshin Hotit*. Fjala e fundit për bashkëvuajtësit për liri, më 16 maj 1999, kur po e nxirrnin nga pavijoni për ta humbur pa nishan: „*Djema, mbahuni të fortë, shumë shpejt do të shihemi...!*” - ishte mesazh që dilte nga mendimi politik i tij, i kultivuar në *Burgun e Dubravës*, në pjesën e dytë të viteve të 90-ta

Ukë Thaçi

REGJIMI NË KAZAMATET E SERBISË - THELLIM I KRIMIT NË DUBRAVË

Sipas njohurive tona, *Masakrën serbe në Burgun e Dubravës*, *realisht më 16-24 maj 1999*, e ka disejnuar dhe udhëhequr *Miki Vidiq, komandant i Burgut të Dubravës*, dhe *Aleksandër Rakoçeviq, drejtor i Burgut të Dubravës*, të ndihmuar nga: *mbikëqyrësi i quajtur*

Branko Komatina (personi i cili e mori nga pavijoni *Mr. Ukshin Hotin*, më 16 maj 1999, kur nisi fillin tragjedia shqiptare e Dubravës); *Zhivković Zharko* (zëvendës drejtor) dhe *Zhivković Dragan* (i quajtur “*Kasap*”), pjesëmarrës i njohur në krimet serbe në Bosnjë, e të tjerë. Këta zyrtarë, për realizimin e skenarit të masakrës, në *Burgun e Dubravës* paraprakisht sollën kriminelë serbë, të dënuar për krime të llahtarshme, të gatshëm për të pirë gjak shqiptari, me çka do të shlyenin dënimet dhe do të rehabilitoheshin në shoqërinë serbe.

Pas mynxyrave të përgjakshme, përjetuesit e *Masakrës serbe në Burgun e Dubravës*, më 24 maj 1999, i sollën në *Burgun e Lypjanit*. Fillimisht i zbritën jashtë rrethojës, me qëllim që t’u “*linin mundësi*” të iknin, pretekst për të vazhduar me skenarin e ekzekutimit. Të burgosurit shqiptarë - pengje lufte, e parandienin këtë kurth, ndaj për një kohë qëndruan në vend,

jashtë rrethojës. Do të hynë brenda pas komandës, duke iu shtruar rrahjeve mizore.

Ndërkaq, *shtatëmbëdhjetë ditët e qëndrimit në këtë burg*, nga 24 maji deri më 10 qershor 1999, janë përvojë jetësore në *Purgatorin e Dantës*. As mund të përshkruhet dhuna fizike e psikike e gardianëve dhe e paramilitarëve serbë ndaj pengjeve shqiptare të luftës.

Më 10 qershor 1999, siç është pasqyruar në kumtesat para kësaj, të burgosurit shqiptarë i transferuan, si pengje të luftës, në burgje të Serbisë. Regjimi në këto burgje për të burgosurit shqiptarë ishin mizor, skajshmërisht shtypës dhe johuman. Papastërti, mungesë e ushqimit, tortura psikike e fizike, pasiguri absolute për jetë. Dhe, pa vonuar, do të fillojnë pazarllëqet me të burgosur, kurse *dilertë* ishin avokatët serbë dhe ndonjë shqiptar. Dëshmitë janë të prekshme, sepse dihen emrat e avokatëve dhe e atyre që e blenë lirinë me 15-30 mijë marka gjermane.

Këtij *tuxharllëku* me lirinë e të burgosurve shqiptarë, tashti, në njëfarë dore, me miratim të opinionit botëror dhe të *Fuqive të Vendosjes* (heshtja para krimit është pjesëmarrje në krim), do t'i ndihmojnë skenarët me zjarre e rebelime të të burgosurve serbë antishqiptarë mizorë në tri burgjet më të mëdha, ku kishte numër më të madh të

burgosurish shqiptarë: në *Mitrovicë të Sremit*, në *Zabella të Pozharevcit* dhe në *Nish*.

Zhvillimet treguan se konceptues i regjimit në burgjet e Serbisë për të burgosurit shqiptarë, gjithnjë pengje të luftës, ishte *Miki Vidiq*, ish-komandant i *Burgut të Dubravës*, i cili edhe më tutje udhëhiqte gjoja si komandant i *Burgut të Dubravës* në *Pozharevc*. Ai i vizitoi të gjitha *burgjet e Serbisë* ku ishin dërguar pengjet shqiptare dhe la urdhra dhe udhëzime se si të veprohej me ta.

Kjo ishte dëshmi se mynxyrat e regjimit për të burgosurit shqiptarë në *kazamatet e Serbisë*, pas 10 qershorit 1999, ishin specie e skenarit serb gjenocidal shekullor antishqiptar të Kosovës, njëkohësisht thellim i krimit të zbatuar në *Burgun e Dubravës*, më 16-24 maj 1999.

Besim Zymeri

**MASAKRA E DUBRAVËS NDËRMJET HESHTJES POLITIKE
DHE DEGJENERIMIT MORAL NJERËZOR**

Masakra e Dubravës, për nga përmasat dhe veçanërisht për nga përmbajtja e dhembshme, është pa dyshim njëra ndër tragjeditë më të tmerrshme që njih historia e njerëzimit. Shumë njerëz gabojnë kur thonë se numri i të vrarëve në këtë masakër nuk mund të jetë argument i mjaftueshëm që ajo të radhitet në mesin e tragjedive më të tmerrshme. Pikërisht ana përmbajtësore, është ajo që këtë tragjedi e veçon nga shumë tragjedi të tjera, më të mëdha në përmasën sasiore. *Masakra e Dubravës* shënon jo vetëm kulmin e shfryrjes raciale shtazarake të një grupi të njerëzve ndaj një grupi tjetër, por veçanërisht në natyrën juridike është argumenti më i fortë që dëshmon projektin shtetëror serb për gjenocid dhe etnocid ndaj shqiptarëve si dhe teknologjinë faktike të ekzekutimit të atij gjenocidi.

Kjo masakër është dëshmia më e fortë e implikimit të vetë shtetit serb në ekzekutimin e gjenocidit ndaj shqiptarëve, ndërkaq nga qarqet ndërkombëtare, qofshin ato edhe Veriatlantike,

është mbajtur dhe po mbahet edhe më tutje në heshtje, duke përfshirë këtu edhe heshtjen e pakuptueshme të institucioneve vendore të Kosovës.

Vërtet, koha po e vërteton se institucionet ndërkombëtare kanë bërë dhe po bëjnë të pamundurën që zbardhja e kësaj masakre të mos marrë përmasa të fushatës politike e juridike, ose mediale së paku. Arsyeja qëndron në vetë implikimin e institucionit ushtarak Veriatlantik, *NATO*-s, në ekzekutimin e pjesshëm të *Masakrës së Dubravës*. Në të vërtetë, objektiv i bombardimit të *Burgut të Dubravës* nga forcat ajrore të *NATO*-s duket të kenë qenë objektet e burgut e jo të burgosurit. Por, *NATO*, me gjasë, kishte rënë në grackën e dinakërisë së makinerisë luftarake të *Serbisë* dhe, me ose pa dashje, kishte filluar të bëjë ekzekutimin e pengjeve shqiptare në atë burg.

Shteti serb ka ditur ta shfrytëzojë shumë mirë mediasht dhe politikisht sulmin e *NATO*-s ndaj burgut, duke e akuzuar *NATO*-n për gjoja sulme të qëllimshme kundër civilëve. Por, njëkohësisht, me bombardimet shteti serb kreu pjesën më të madhe të vrasjeve barbare ndaj pengjeve shqiptare në *Burgun e Dubravës*, pikërisht duke qenë i bindur se masakra do të heshte më pas nga vetë shtetet evropatlantike, për shkak të përfshirjes së tyre paraprake në vrasjen e të burgosurve pengje të

pafajshme të luftës. Shteti serb ka pasur rezultate shumë pozitive në këtë aspekt, sepse, pas vendosjes së trupave të *NATO*-s dhe të pushtetit të *UNMIK*-ut në Kosovë, *Masakra e Dubravës* u hesht në pjesën më të madhe të mundshme, veçanërisht në planin juridik.

Këtu duhet të theksohet fakti se burgu i shkatërruar i *Dubravës* është *njëri prej objekteve të para publike të Kosovës i rindërtuar përnjëherë pas luftës me mjete ndërkombëtare*. Kjo nuk është bërë për shkak të domosdoshmërisë së nevojave juridiko-shtetërore kosovare për ringritjen e tij pikërisht në vendin e gërmadhës, dëshmi e prekshme kjo e masakrës, por u bë pikërisht për të fshehur atë dëshmi materiale të masakrës së projektuar dhe të kryer nga shteti serb, i cili kishte futur në grackë edhe vetë *NATO*-n.

Ky është fakt i pamohueshëm. Mirëpo, derisa kjo heshtje politike ndërkombëtare për *Masakrën e Dubravës*, siç u tha, e projektuar dhe e ekzekutuar me sukses nga *Serbia me një si uverturë nga qarqet ndërkombëtare*, mund të kuptohet, ndërkaq, heshtja politike rreth kësaj masakre nga institucionet e Kosovës nuk mund të kuptohet assesi. Vërtet, asnjë institucion i Kosovës, i dal nga vota e popullit, nuk ka bërë, deri tashti, as edhe përpjekjen më të vogël, që kjo masakër të ndriçohet nëpërmjet ndonjë projekti juridik hulumtues dhe shkencor historiografik, apo qoftë edhe nëpërmjet ndonjë

fushate publike mediale. Përkundër, është hetuar një solidarizim i pakuptueshëm i institucioneve vendore dhe të atyre ndërkombëtare për heshtjen dhe për fshehjen sa më të madhe të mundshme të kësaj tragjedie.

Shpesh dëgjojmë se institucionet shtetërore të Kosovës, si *Presidenca, Kryeministria* apo organizata të ndryshme, të marrin përsipër patronazhin në organizimin e shënimit të përvjetorëve të masakrave të ndryshme *ndaj civilëve në Kosovë*, apo për nder të *dëshmorëve e të figurave të ndryshme*. Por, këto institucione, madje edhe të lutura nga *Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës* për ndërhyrje te *mekanizmat e UNMIK-ut*, qoftë edhe për të siguruar lejen që të mbijetuarit e masakrës të hynë në *Burgun e Dubravës* për të shënuar përvjetorët e masakrës, kanë refuzuar, madje ndonjëherë duke përdorur edhe gjuhën e cinizmit, në stilin: “*Mjafton që të mbijetuarit e masakrës janë gjallë dhe të mos kërkojnë më tepër...!*”

Duhet të thuhet qartë se për sa kohë që *Masakra e Dubravës* nuk do ta thyejë heshtjen politike dhe për sa kohë që kjo *masakër* nuk do të institucionalizohet juridikisht në përmasat dhe përmbajtjen reale të saj, bota nuk do ta marrë vesh kurrë se çfarë loje përbindëshi ka luajtur shteti serb në *Ballkan*, veçanërisht në tokat shqiptare në pesëmbëdhjetë vjetët e fundit të “*Jugosllavisë*”.

Masakra e Dubravës shënon një veçanti juridike nga masakrat e tjera ndaj civilëve në Kosovë. *Burgu*, gjithkund, në botë është *pronë e drejtpërdrejtë e shtetit* dhe administrohet nga *ministra e drejtësisë*. Në rastin konkret, *Burgu i Dubravës* ka qenë pronë e *ministrive serbe* dhe *jugosllave të drejtësisë*, të cilat kanë qenë përgjegjëse për jetën e pengjeve. Nëse masakra ka ndodhur nga po i njëjti shtet dhe po nga e njëjta ministri e tij e drejtësisë, nuk është aspak e vështirë të dihen me emër dhe mbiemër të gjithë ata serbë, duke filluar nga krerët e shtetit e deri te gardianët e burgut dhe vetë të burgosurit serbë. Fajtorët të sillen para drejtësisë, me akuzën e qëndrueshme juridikisht, për masakër të paramenduar ndaj pjesëtarëve civilë të një populli tjetër. Nëse qëllimi i fundit ka qenë vrasja totale e të gjitha pengjeve në *Burgun e Dubravës*, duke ditur paraprakisht *emrin e shtetit* që e ka administruar atë burg dhe emrat e ekzekutorëve të masakrës, juridikisht krijohet bazë e mjaftueshme që vetë shteti serb të akuzohet për gjenocid ose tentim gjenocidi ndaj popullit shqiptar.

Kjo masakër, e projektuar dhe e ekzekutuar nga vetë institucionet legale të shtetit serb, është dëshmia më burimore se kur është në pyetje tentimlikuidimi i fizikimit të qytetërimit shqiptar, përkatësisht gjenocidi dhe etnocidi ndaj tij, nuk kanë qenë regjime të caktuara serbe, por ka qenë vetë

shteti serb me mekanizmat e tij legalë, të cilët e kanë ekzekutuar masakrën.

Së këndejmi, institucionet e Kosovës, në radhë të parë *Qeveria* dhe *Kuvendi i Kosovës*, paraprakisht duhet që nëpërmjet procedurave të rregullta, ligjshmërisht ta shpallin *Burgun e Dubravës - Kamp i instaluar i përqendrimit të periudhës së Luftës Çlirimtare të UÇK-së*. Këtë kërkesë e arsyeton tretmani çnjerëzor serb i ushtruar ndaj pengjeve shqiptare aty, në vitet 1998-1999. Po ashtu, duhet të shpallen për kampe përqendrimi, të instaluara ose provizore, edhe burgjet dhe hapësirat e tjera publike në Kosovë, në të cilat, në formë të organizuar, janë vrarë, torturuar dhe dhunuar pengjet shqiptare, nga vetë shteti serb.

Vërtet, derisa institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare do të vazhdojnë ta mbështjellin me heshtje politike këtë tragjedi, bota nuk do ta kuptojë drejt mesazhin e shenjtë të lirisë, të paqes dhe të drejtësisë, kurse *Masakra e Dubravës* do të vazhdojë të mbetet ndërgjegje e vrarë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Të përfundojmë: Në asnjë mënyrë nuk guxon që heshtja politike e *Masakrës serbe në Burgun e Dubravës* të mbetet, edhe më tutje, kompromisi më antinjerëzor i ndërtimit dogmatik të multietnicitetit në Kosovë, në favor të relativizimit të krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve. Ndaj, veprimet që

sugjerohen në të ardhmen, drejt ndriçimit të plotë të përmasave, të përmbajtjes dhe të pasojave të tmerrshme të *Masakrës së Dubravës* dhe të masakrave të tjera ndaj civilëve shqiptarë, të kryera nga shteti serb gjatë *Luftës Çlirimtare të UÇK-së* në vitet 1998-1999, do të duhej të ishin:

a) Kuvendi i Kosovës, me një akt të veçantë ligjor, *Burgun e Dubravës* ta shpallë *Kamp të Instaluar të Përqendrimit*, për periudhën e *Luftës Çlirimtare të Kosovës*, në të cilin janë torturuar, çnjerëzuar dhe ekzekutuar kolektivisht, të burgosur politikë e ordinerë dhe pengje të pafajshme civile shqiptare nga mekanizmat institucionale policore-ushtarake të shtetit serb.

b) Po ashtu, institucionet shtetërore të Kosovës duhet të shpallin *kampe të përqendrimit* të gjitha hapësirat e tjera publike në Kosovë, në të cilat janë torturuar, përdhunuar e vrarë pa gjyq, pengjet e pafajshme civile shqiptare.

c) Të mbijetuarit e *Masakrës në Burgun e Dubravës* të japin dëshmi dhe deklarata të plota për përjetimet gjatë masakrës, duke shënuar format e torturave të përjetuara dhe emrat e të vrarëve të njohur prej akëcilit syresh. Njëkohësisht, edhe për të plagosurit. Dëshmitë duhet të përdoren për të konfirmuar fajësinë e shtetit serb në projektimin dhe ekzekutimin e masakrës, si dhe për të bërë ndjekjen penale ndaj fajtorëve individualë.

ç) *Burgu i Dubravës* në një të ardhme të shpejtë, të lirohet nga funksioni i tanishëm dhe të shpallet *muze i një tragjedie* të rëndë dhe shumë ëmblematike.

d) *Qeveria e Kosovës* dhe institucionet e tjera kompetente të Kosovës, në bashkëpunim me mekanizmat relevantë ndërkombëtarë, të formojnë një qendër institucionale për hulumtimin e krimeve të bëra nga shteti serb ndaj popullatës shqiptare, me theks të veçantë nga fillimi i vitit 1989 e deri në përfundimin e *Luftës Çlirimtare UÇK - NATO në Kosovë*, më 21 qershor 1999.

e) Institucionet e Kosovës të autorizojnë dhe të financojnë institucionet përkatëse shkencore për hulumtime të krimit serb në Kosovë, si: *Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Institutin Albanologjik, Institutin e Historisë, Arkivin e Kosovës*, organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut etj.

f) Institucionet e Kosovës, pas mbledhjes së fakteve të mjaftueshme për përmasat e krimeve dhe për natyrën e ekzekutimit të tyre, të bëjnë ngritjen e padive penale kundër shtetit serb për gjenocid ndaj shqiptarëve dhe të bëjnë ndjekjen penale të të gjithë individëve, pjesëtarë të makinerisë ushtarake e policore, shtetërore, serbe, që kanë kryer krime ndaj civilëve shqiptarë gjatë luftës.

Sugjerimet e lartshënuara mbështeten në faktin se *gjenocidi i kryer nga Serbia në Kosovë*, gjatë *Luftës Çlirimtare të UÇK-së*, aktualisht trajtohet vetëm

nga aspekti i pasojave statistikore e jo nga aspekti përmbajtjesor, i cili duhet ta definojë fajtorin e vërtetë, qoftë atë kolektiv apo individual, për të dëshmuar ekzistimin e një projekti shtetëror serb *për zhdukjen fizike të qytetërimit shqiptar në Kosovë*, në mënyrë që të mos lejohet, edhe më tutje, relativizimi i krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve vetëm në nivele të përgjegjësisë individuale, qoftë ai edhe *Milosheviq*.

Milaim Çekaj

DËSHMI PËR MASAKRËN E DUBRAVËS NË GJYQIN NDËRKOMBËTAR TË HAGËS

Në aktakuzën e *Tribunalit të Hagës* kundër *Milloseviq, Millutinoviq, Shainoviq, Ojdaniq dhe Stoilkoviq*, të datës 29.10.2001, krahas masakrave të tjera në Kosovë, zë vend edhe *Masakra serbe në Burgun e Dubravës*.

Sipas e hetuesve ndërkombëtarë, për masakrën e *Dubravës* janë intervistuar 150 të mbijetuar. Nga ky numër vetëm tre vetë janë ftuar në *Hagë* për dëshmi të drejtpërdrejtë. Nga të gjitha dëshmitë rezulton se prej 19- 24 maj 1999, në Burgun e Dubravës janë masakruar mbi 150 shqiptarë.

Në pjesën e aktakuzës për plojat në Kosovë, e cila kishte 51 faqe, *Masakra e Dubravës* përmendet

në faqen 23, në pikën *k* dhe *i*, ndërsa emrat e disa nga të viktimizuarit përmenden në faqen 48, në pikën *j*, versioni në gjuhën shqipe. I akuzuari i parë, *Milosheviq*, të vrarit i quan viktima të bombardimeve të *NATO*-së, të cilëve, sipas tij, të rënë nga ciflat e bombave dhe shpërthimet e fuqishme (faqe 9180 e stenogramit të gjykimit, rreshti 15 dhe 16). Mirëpo, për ta dëshmuar këtë, i akuzuari nuk posedon raportet nga obduksioni mjeko-ligjor (faqet 9181 dhe 9182 të stenogramit të gjykimit, versioni në gjuhën angleze).

Dëshmitë e tre të përjetuarve të Masakrës serbe në Burgun e Dubravës u dëgjuan në *Tribunalin e Hagës* më datën 27- 30 gusht 2002.

NOTACIONI I REDAKTORIT

Duke u nisur nga njohuritë kryesisht në nivel të kujtesës historike, më 24 shkurt 2004, i hartuam tezat për sesionin shkencor: *Masakra serbe në Burgun e Dubravës 19 -24 maj 1999* (të mbajtur më 23 maj 2004). Kihej parasysh fakti që një tezë, e kthyer në kumtesë, të ofronte mundësi për zbardhjen e një problemi të veçantë në hallkën kronologjike të ngjarjes si tërësi.

Për ta dëshmuar *Masakrën e Dubravës* në rrjedhën e historisë së krimeve serbe ndaj kombit shqiptar, dhe jo si një episod në historinë e

marrëdhënieve serbo-shqiptare, *Këshilli Organizativ* e ngarkoi redaktorin shkencor të shkruante një paraqitje sa më të plotë për platformat serbe për plojat dhe masakrat mbi shqiptarët në funksion të strategjisë shfaruese -“*Toka shqiptare e djegur*”. Dhe, në mungesë të mjeteve për botimin e sesionit edhe në gjuhën angleze, të formulojë një rezymë sa më të gjerë, e cila do të ofronte një pasqyrë sa më të plotë për dhunën dhe krimet gjenocidale dhe etnocidale serbe ndaj shqiptarësisë së Kosovës me Masakrën në Burgun e Dubravës, si krim i paprecedent në botë, dëshmi e prekshme se Serbia me dorën e vet e ka vrarë dhe e ka kallur pjesën serbe, pikërisht atë koloniale, në Kosovë.

Vërtet, *Këshilli Organizativ* i sesionit ishte i vetëdijshëm për faktin se, në mungesë të burimeve parësore, arkivale, të cilat i posedon dorasi, Serbia, në kurorëzimin e punës kërkimore dhe zbardhjen e krimit me sukses, do të dalin vështirësi dhe pengesa të mëdha. Dhe, ato do të paraqiten nga fillimi, në hapat për angazhimin e autorëve, përjetues dhe mbijetues të ngjarjes, të cilët, pas kthimit nga burgjet e Serbisë, kishin qenë të pranishëm në media për *Masakrën në Burgun e Dubravës* të 19-24 maj 1999. Midis këtyre kishte edhe të tillë, të cilët kishin qenë shpëtimtarë dhe forcë morale për kolektivin e të burgosurve shqiptarë në çastet më dramatike për fatin e akëcilit individ dhe të kolektivit si tërësi.

U kërkua nga autorët, përjetues të krimit, që kumtesat t'i shkruanin mbi bazë të hulumtimeve dhe të revalorizimit kritik të kujtesës, që autori, pa marrë parasysh se ishte mbijetues, në shkrimin e segmenteve të ngjarjes të mos paraqitej si rrëfimtari, si ofrues i kujtesës dhe i opinionit personal, por të merrte pozitën e hulumtuesit dhe të historishkruesit.

Autorët e kumtesave bënë atë që patën mundësi dhe dije për ta arritur, të vetëdijshëm se, në këtë fazë të njohurive të burimeve, nuk mund të bëhej më shumë. Ndërkaq, redaktori shkencor me një përkushtim të veçantë, duke qenë në kontakt të kohëpaskohshëm, për akëcilin problem, me autorët e kumtesave, për sqarime e plotësime të reja, cilësinë shkencore të kumtesave veç e veç dhe të sesionit si tërësi, e solli në nivelin shkencor të kënaqshëm të këtij studimi, të themi, kushtimisht, monografik sintetik për *Masakrën e Dubravës* të 19-24 majit 1999.

Për redaktimin shkencor të materialeve (kumtesave), redaktori shkencor, përpos rikonfirmimeve të shumta nga autorët, u mbështet në të dhënat arkivore të *Shoqatës së të Burgosurve Politikë të Kosovës (SHBPK)*, të *Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNJ)* në Prishtinë, të *KMDLNJ Rajonale të Pejës* dhe të *KMDLNJ Rajonale të Gjakovës*.

Problem të veçantë, për kurorëzimin konceptual dhe redaktorial të dëshiruar të sesionit, ka paraqitur evidencimi i emrave të martirëve të kombit shqiptar nga *Masakra e Dubravës*, për faktin se pushtuesi serb, përgjegjësi për krim, e ka tërhequr, në Serbi, dokumentacionin e të burgosurve në *Burgun e Dubravës* në prag të masakrës, si dhe listat e të masakruarve dhe të të plagosurve.

Për ta vështirësuar dhe për ta pamundësuar evidencimin e të gjithë të masakruarve, okupatori serb një pjesë të kufomave të martirëve, të ekzekutuar me një ose me më shumë plumba, nga afërsia, i ka fshehur ose i ka zhdukur. Në *Varrezën Kolektive*, në Rakoshë, më 25 maj 1999, janë varrosur vetëm rreth 100 veta, kryesisht kufoma me thyerje e dëmtime nga granatat shpërthyesë - projektilët e NATO-s, predhat e murtajave, bombave të dorës etj. Vetëm kufomat e martirëve të sakatosu nga këto armë do të ekspozohen për mjetet mediale serbe e botërore pas bombardimeve të NATO-s në Burgun e Dubravës.

Kjo përzgjedhje është bërë me qëllim që, në një të ardhme të paevitueshme, masakruet në *Burgun e Dubravës* të paraqitej NATO-ja. Kjo u përvijua edhe nga dëshmia në *Gjyqin e Hagës*, më 24 mars 2005, e *Slobodan Milosheviqit* dhe e dëshmitares së mbrojtjes së tij, *Danica Marinkoviq*, ish-prokurorja

milosheviqiane vrastare e Kosovës. I pari, *Milosheviq*, duke kundërshtuar të dhënë në aktakuzë se “*në orët e hershme të mëngjesit të datës 22 maj, personeli i Burgut të Dubravës ka urdhëruar të burgosurit shqiptarë të mbledhnin plaçkat dhe të grumbulloheshin në vendin e caktuar që të përgatiteshin për transferim dhe pa paralajmërim u hap zjarr mbi ta nga gardianët serbë ku u vranë shumë të burgosur dhe u plagosën shumë të tjerë*”, e quajti “*një film i dobët horror (lemeri - M. P.) i Prokurorisë së Hagës*”!?! E dyta, *Marinković*, duke u përgjigjur në pyetjen e të akuzuarit: “*A ka diçka të vërtetë*” në konstatimin e cituar nga aktakuza, u përgjigj: “*Nuk është ashtu, atë kohë (më 22, 23, 24, 25 maj) burgun e ka bombarduar NATO dhe janë vrarë e plagosur shumë të burgosur*”. Më tutje, *Marinković*, konstatoi se obduksionin e kufomave e kishte “*bërë kolegu i saj, Vladan Bojić, nga Peja*”, porse ajo “*nuk ka hollësi të obduksionit të kufomave të cilat janë vrarë në Burgun e Dubravës, më 22 maj 1999*”.

Ta përmbledhim shkurtimisht: Bombardimet e NATO-s ishin më 19 dhe më 21 maj. Më 22 dhe 23 maj, *Burgu i Dubravës* nuk është bombarduar nga NATO-ja, kurse, më 24 maj, të burgosurit nga *Burgu i Dubravës* janë bartur në *Burgun e Lypjanit*. Më 25 maj 1999, është bërë përzgjedhja e kufomave - një pjesë për varrosje publike me ndihmë të romëve dhe të serbëve dhe tjetra pjesë për fshehjen - zhdukjen e tyre, pa prani publike. Njëkohësisht, janë mbledhur

dokumentacioni i drejtorisë së burgut dhe dokumentet që kishin të masakruarit në xhepa dhe në plaçkat e tyre, me qëllim të fshehje së realitetit të hidhur.

Kështu, pas largimit të makinerisë pushtuese serbe nga Kosova, në mungesë të të dhënave dokumentare, të shkruara, listat me emrat e martirëve dhe të të plagosurve të *Masakrës së Dubravës*, të hartuara nga KMDLNJ të *Pejës*, të KMDLNJ të *Gjakovës* dhe SHBPK-ja mbi bazë të kujtesës së të mbijetuarve, dolën me të dhëna të mangëta, me shumë gabime materiale dhe disa syresh të diskutueshme. Shumë emra nuk kishin emër të t'et, disa kishin mbiemra të ndryshëm, disa ishin të evidencuar me forma të shkurtuara të emrit, ashtu siç ishin të njohur në kolektiv, në shoqëri, madje për disa edhe vendlindjet ishin gabimisht, e kishte raste kur, në librat që do të përmenden më poshtë, ndonjëri nga të masakruarit në *Masakrën e Dubravës*, përmendet si i vrarë gjetkë, dhe me datë tjetër.

Vërtet, për ta bërë një evidencim sa më të saktë për nevoja të këtij botimi, veçanërisht të martirëve, ndoqëm një rrugë të gjatë, të mundimshme. I hulumtuam dhe i krahasuam të dhënat për dëshmorët nga listat e mekanizmave të përmendur më sipër, me të dhënat për martirët dhe për të zhdukurit në botimet: LDK-Sanije

Alijaj, *Pasojat e luftës në Kosovë (28 shkurt 1998 - 10 qershor 1999)*, Prishtinë, 2002; KMDLNJ - *Qendra Rajonale në Pejë, Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës Mars-Qershor 1999*, Pejë, 2002; SHVLUÇK, *Feniksët e Lirisë. Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Libri i parë i plotësuar*, Prishtinë, 2002; Hasan Hasani, *Të pavdekshmit e Dukagjinit. Dëshmorët e UÇK-së të ZOD*, Pejë, 2002; Naser Husaj, *Dubrava. Rruga drejt vdekjes*, Gjakovë, 2004 dhe materialin: *Kronologjia e arrestimeve dhe masakrat makabre në Burgun e Dubravës dhe të Lypjanit - DËSHMI*, SHIBPGJ, Gjakovë, 18 maj 2004.

Meqë as me këto burime nuk pati mundësi të plotësohej kërkesa jonë redaktuese shkencore, sepse edhe të dhënat në këto botime janë shumë kundërtënëse, me shumë pasaktësi, ekskluzive e njëres ndaj tjetres, listën më 121 emra e dërguam, me e-mail, më 5 prill 2005, në katër radio dhe në nëntë agjenci informative e gazeta ditore e javore të Kosovës, të shoqëruar me këtë apel:

“Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës dhe Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri” janë duke përgatitur për botim materialet nga sesioni shkencor: Masakra serbe në Burgun e Dubravës (19-24 maj 1999), të mbajtur më 23 maj 2004.

Duke u mbështetur në burime të ndryshme, kemi arritur t'i evidencojmë martirët e shënuar më poshtë, por për disa nuk e kemi emrin e babës dhe kemi frikë se nuk i kemi

të sakta as të dhënat e tjera. Dhe, mendojmë se nuk kemi arritur t'i evidencojmë të gjithë, pasi të dhënat janë nga kujtesa e individëve, shumë kundërthënëse dhe fragmentare.

Emri, emri i babës, datëlindja, vendlindja dhe komuna na duhen për të gjithë martirët nga Masakra e Dubravës për këto tri kërkesa: E para, në librin, i cili do të hyjë në shtyp më 25 prill 2005, duhet të shënohen të gjithë emrat e martirëve; e dyta, këta emra duhet të gdhenden pa gabime në memorialin në vendin e krimit, të cilin e synojmë, dhe e treta: planifikojmë botimin e një libri me biografitë e të rënëve në Masakrën e Dubravës.

Do të na vinte tepër keq nëse shënojmë ndonjë emër me gabime dhe jo të plotë, e veçanërisht nëse nuk arrijmë t'i përjetësojmë të gjithë martirët, ashtu siç na kemi borxh. Nisemi nga lista në vijim (...).

Në fund të apelit saktësuam: “Thelksojmë edhe një herë: Këtë listë e kemi dërguar me email në të gjitha gazetatat e Kosovës (e në katër radio) dhe presim botimin (emetimin) e saj. Jemi të sigurt se mund të na ndihmoni.

*Ndaj, i lusim individët dhe familjarët e martirëve, veçanërisht miqtë e tyre, të na ndihmojnë: të bëjnë korigjimin dhe plotësimin e të dhënave për martirët e evidentuar më sipër dhe të na ofrojnë të dhëna të plota për ata që nuk i kemi evidencuar. Informatat të dërgohen me telefon: **044-149-244** dhe me email: pirraku@yahoo.com, më së largu deri më 24 prill 2005.”*

Në apelin tonë janë paraqitur, me telefonata dhe me email: një person nga viset e Gjilanit, tre

nga viset e Kaçanikut, një nga Prizreni, një nga viset e Gjakovës, një nga viset e Rahavecit, tre nga viset e Drenasit, një nga viset e Skenderajt, një nga viset e Fushë Kosovës, dy nga viset e Deçanit dhe një person nga viset e Pejës, kryesisht lexues të gazetave “*Epoka e re*”, “*Fokus*” dhe “*Java*”, dhe dëgjues të radios “*Kosova e Lirë*” dhe “*Radio Dukagjini*”. Disa dhjetëra, të tjerë, i kemi kontaktuar me telefonata.

Ky hap yni dha rezultate të mira, për faktin se i korrigjuam disa emra, e evidencuam emrin e prindit për disa të tjerë, për ndonjërin u korrigjua mbiemri dhe vendlindja, së paku dy martirë ishin të evidentuar nga dy herë, njëri me dy emra, e tjetri me dy mbiemra, një i mbijetuar i masakrës ishte i evidentuar si martir, evidencuam një martir, i cili (në *Burgun e Dubravës* ishte, së paku, deri më 3 mars 1999, kur i qe familja në vizitën e fundit) tashti konsiderohet i zhdukur, dhe dy të tjerë, të cilët vdiqën (nga plagët e mara në Masakrën e Dubravës), njëri në *Burgun e Lypjanit* e tjetri në *Kaçamat* e *Pozharevcit*.

Si fryt i punës kërkimore këmbëngulëse rezultoi lista e martirëve që do të sillet më poshtë, të vetëdijshëm se as kjo nuk është e plotë, as plotësisht me të dhëna të sigurta.

Prapë nuk është e plotë kjo listë për faktin se shumë familjarë, të cilët meshkujt e tyre i kanë pasur në *Burgun e Dubravës* në prag të masakrës, e të cilët

ende nuk kanë njohuri të verifikueshme për fatin e tyre, preferojnë t'i quajnë *të fshehur* në Serbi, as të vrarë, as të zhdukur. Kështu, me kohë, në rrethana të tjera dhe mbi bazë të fakteve të cilat duhet t'i sigurojë *KS i OKB* dhe *Haga* nga bartësi i krimit në *Burgun e Dubravës* - Serbia e djeshme, e sotme dhe e ardhshme, mbetet të bëhet evidencimi i plotë i të gjithë të masakruarve dhe të të plagosurve në *Masakrën e Dubravës* të 19-24 maj 1999, barrë për shtetin e Kosovës.

MARTIRË NGA MASAKRA E DUBRAVËS

1. Abdullah Ramadan Tahiri nga Malishta, Gjilan;
2. Adem Idriz Jasiqi nga Deçani, Deçan;
3. Afrim B. Krasniqi nga Arbana, Prizren;
4. Afrim Jusuf Sahiti nga Drenori, Drenas;
5. Agim Ajet Duraku nga Buroja, Klinë;
6. Ahmet Hysen Hoxha nga Pleshina, Ferizaj;
7. Ali Avdyl Kelmendi nga Frashnjeti, Pejë;
8. Anton Pashk Maksuti nga Vogona, Gjakovë;
9. Arsim Murat Rrahimi nga Besiana, Besianë;
10. Arsim Ahmet Zogiani nga Harilaçi, F. Kosovë;
11. Arsim Krasniqi nga Prishtina, Prishtinë;
12. Artan Tafë Gjekaj nga Dardana, Pejë;
13. Avdylgafurr Merxhan Luma nga Qafëshqipja, Kaçanik;

14. Avni Bajram Gashi nga Buçani, Pejë;
15. Avni Behxhet Thaçi nga Retia, Rahavec;
16. Bahri Muhedin Kryeziu nga Gjakova,
Gjakovë;
17. Bajram Jonuz Berisha nga Valijaku, Klinë;
18. Bajram Miftar Kiçina nga Rezistenca, Drenas;
19. Bashkim Emin Maloku nga Dardhishta,
Besianë;
20. Bedri Sejdë Hasani nga Peja, Pejë¹;
21. Bekim Vahdet Rama nga Rahavec, Rahavec;
22. Besim Aziz Kabashi nga Apterrushi,
Rahavec;
23. Besim Hazir Paçarizi nga Dragubili, Malas;
24. Besnik Shani Kastrati nga Gjakova, Gjakovë;
25. Blerim Adem Hoda nga Gjakova, Gjakovë;
26. Bujar Adem Himaj nga Skivjani, Gjakovë²;
27. Çaus Haxhi Ahmeti nga Sheremetaj,
Gjakovës;
28. Dan Brahim Leku nga Rezistenca, Drenas;
29. Danush Miftar Kurtaj nga Gabrriza, Kaçanik;
30. Dervish Sylë Sylaj nga Ratisha e Poshtme,
Deçan;
31. Enver Avdyl Zogaj nga Rrezana, Malas;
32. Enver Bajram Topalli nga Gremja, Ferizaj;
33. Fadil Hysen Beqiraj nga Rracaj, Gjakovë;

¹ I plagosur rendë, vdiq në Burgun e Lypjanit dhe u varros në Lypjan.

² Vdiq në Burgun e Pozharevcit, nga plagët e marra në Masakrën e Dubravës.

34. Fadil Smajl Bezaraj nga Rrafshi, Pejë;
35. Fazli Sahit Kabashi nga Malasi, Therandë;
36. Fejzë Rexhë Spahiu nga Ilirioni, Skenderaj;
37. Gani Elez Morina nga Deja, Rahavec³;
38. Gani Ibish Lekaj nga Lumbardhi, Deçan;
39. Gani Isufi nga Suka e Gashit, Klinë;
40. Gazmend Fazli Imeri nga Ponosheci,
Gjakovë;
41. Gazmend Idriz Gashi nga Prishtina,
Prishtinë;
42. Gazmend Jahir Kolgeci nga Arrisha,
Therandë;
43. Gjokë Matej Ndrecaj nga Biteshi, Gjakovë;
44. Gjon Mark Gjini nga Prizreni, Prizren;
45. Habib Azem Mehani nga Shkaba, Drenas;
46. Habib Azem Mehmeti nga Qëndresani,
Klinë;
47. Hajdar Pepaj nga Kodralia, Deçan;
48. Haki Z. Dinaj nga Raushi, Pejë⁴;
49. Halit Sadri Ademaj nga Rracaj, Gjakovë;
50. Hamdi Adem Ademaj nga Rracaj, Gjakovë;
51. Hasan Beçir Shala nga Nënkalaja, Drenas;
52. Hasan Myftar Hoda nga Gjakova, Gjakovë;
53. Hysen Avdyl Ademi nga Mollasi, Gjakovës;
54. Ibër Dinë Gërkoci nga Frashnjeti, Pejë;

³ Vdiq në Burgun e Lypjanit nga plagët e marra në Masakrën e Dubravës.

⁴ U “lirua” nga Burgu i Dubravës, më 17 maj 1999. Më nuk dihet gjë për fatin e tij.

55. Ibër Sherif Metaj nga Hereçi, Gjakovë;
56. Idriz Niman Zhutaj nga Rausha, Pejë;
57. Ilir Damon Damonaga nga Gjakova,
Gjakovë;
58. Ilir Halil Luzha nga Arrisha, Therandë;
59. Isuf Qerim Hoxha nga Myzeqina, Shtime;
60. Isuf R. Berisha nga Drenaj, Rahavec;
61. Jonuz Mehmet Krasniqi nga Arbana, Prizren;
62. Kadri Rrahman Morina nga Rreshtani,
Therandë;
63. Krist Preng Nokaj nga Mokliku, Gjakovë;
64. Kristë Mark Përvorfi nga Dujaka, Gjakovë;
65. Latif Hasanmetaj nga Stralli, Deçan;
66. Lulzim Hashim Hajda nga Rahavec,
Rahavec;
67. Lush Ndue Përlazi nga Velezha, Prizren;
68. Man Karavidaj nga Mazreku, Prizren;
69. Mehmet Qunaj nga Kajusha, Prizren;
70. Mejdi Hajrush Dalloshi nga Sopot, Kaçanik;
71. Met Ibish Osmanaj nga Isniqi, Deçan;
72. Muhamet Ymer Shala nga Blinishti, Gjakovë;
73. Mujë Jashar Tafili nga Shtarza, Klinë;
74. Musah Idriz Morina nga Hodonoci, Dardanë;
75. Myhedin Xhelal Guta nga Gjakova, Gjakovë;
76. Naim Rexhë Kurmehaj nga Stralli, Deçan;
77. Naim Zenel Zahiti nga Suma, Vushtrri;
78. Napolon Qemajl Guta nga Gjakova,
Gjakovë;

79. Nasuf Mehmet Bylykbashi nga Qendresa,
Drenas;
80. Nazmi Hysen Shala nga Peja, Pejë;
81. Nexhat Sh. Kokollari nga Ujmiri, Therandë;
82. Nexhat Tahir Pllana nga Martirat i Poshtëm,
Vushtrri;
83. Nikë Ndue Kola nga Gjakova, Gjakovë;
84. Osman Husein Rastoder nga Arbneshi, Pejë;
85. Petrit Halim Këçina nga Rezistenca, Drenas;
86. Qamil Abaz Thaçi nga Llapushnik, Drenas,
87. Qemajl Hajdar Bytyçi nga Deja, Rahavec;
88. Ramë Rexhep Ibrahimimi nga Stubëlla,
Gjakovë;
89. Ramiz Ramë Memia nga Myhejani, Tropojë -
Shqipëri;
90. Ramiz Himë Bajrami nga Osek Hyla,
Gjakovë;
91. Ramiz Rexhepi nga Prishtina, Prishtinë;
92. Rasim Demë Plava nga Cërmjani, Gjakovë⁵;
93. Remzi Smajl Shala nga Babaj, Pejë;
94. Rrahim Smajl Murseli nga Gremja, Ferizaj;
95. Sabit Halit Thaçi nga Gryka, Drenas;
96. Sahit F. Krasniqi nga Ujmiri, Therandë;
97. Sahit Sali Brahimaj nga Kodrina, Pejë;
98. Sefedin Rrahman Hoti nga Shpati, Kastriot;
99. Shaban Bajram Qosa nga Mitrovica,
Mitrovicë;

⁵ U “lirua” më 16 maj 1999 dhe pas luftës u gjet i ekzekutuar.

100. Shani Avdyl Shala nga Nënkalaja, Drenas;
101. Shkëlzen Miftar Pepshi nga Juniku,
Deçan⁶);
102. Suad Isen Brava nga Pusat e Nikës, Hani i
Elezit;
103. Sylejman Shaip Badallaj nga Zhuri, Prizren;
104. Tefik Bafti Raka nga Kaçaniku, Kaçanik;
105. Tefik Salih Spahiu nga Varoshi, Ferizaj;
106. Ukshin Nazif Hoti nga Krusha e Madhe,
Rahovec⁷;
107. Valdet Qerkin Sopi nga Llapushniku,
Drenas;
108. Valentin Mark Nikollbibaj nga Brekoci,
Gjakovë;
109. Xhafer Hysen Gllareva nga Fortesa,
Drenas;
110. Xhemajl H. Eminhajzeri nga Rahaveci,
Rahavec;
111. Xhevat Azemi nga Besiana, Besianë;
112. Xhevdet Gani Bistrice nga Gjakova,
Gjakovë;
113. Zahir Sadik Agushi nga Thanishta, Klinë;
114. Zef Isuf Kqiraj nga Zhubi, Gjakovë;

⁶ U ekzekutua në ambiente të Burgut të Dubravës më 18 maj 1999.

⁷ U “lirua” më 16 maj dhe ia humbën gjurmët.

115. Zejnullah Mujë Elshani nga Rezistenca,
Drenas;
116. Zekë Haxhi Hasanmetaj nga Stralli i E.,
Deçan.

TË PLAGOSUR NË MASAKRËN E DUBRAVËS⁸

1. Adnan I. Topalli nga Rahaveci;
2. Adnon M. Brovina nga Gjakova;
3. Afrim Sh. Caka nga Gjakova;
4. Agim Gashi nga Rausha;
5. Agim S. Leku nga Rezistenca;
6. Agim Sh. Reçica nga Ferizaj;
7. Ahmet Demiri nga Gjilani;
8. Alban A. Koshi nga Gjakova;
9. Aliriza Pruthi nga Gjakova;
10. Arben K. Shala nga Prizreni;
11. Arbër H. Kolgeci nga Arrisha;
12. Ardian Q. Tetrica nga Gjakova;
13. Armond A. Koshi nga Gjakovëa;
14. Astrit H. Elshani nga Rezistenca;
15. Avdurrahman Koshi nga Gjakova;
16. Bajram A. Merxha nga Rahaveci;

⁸ Lista për të plagosurit nuk është e plotë. Këtu bëhet fjalë vetëm për ata, të cilët i kanë dërguar të dhënat në Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës. Një pjesë e madhe e të plagosurve në Masakrën e Dubravës, pas lirimit nga burgjet e Serbisë, doli në botën e jashtme dhe ata nuk i kanë dërguar në SHBPK të dhënat personale.

17. Beçir O. Kollari nga Rahavec i;
18. Bedri Kukala nga Arrnjeti;
19. Bekim M. Mullahasani nga Gjakova;
20. Besim A. Kastrati nga Malësi e Vogël;
21. Bilbil S. Shehu nga Rahavec;
22. Bislim N. Bislimi nga Drobeshi, Viti;
23. Brahim Gashi nga Barani;
24. Burim A. Ejupi nga Rahaveci;
25. Burim A. Brovina nga Gjakova;
26. Burim Jetishi nga Brekoci;
27. Çausht Selca nga Barani;
28. Defrim M. Këçina nga Rezistenca;
29. Driton H. Aliaga nga Gjakova;
30. Edmond M. Dushi nga Gjakova;
31. Esad H. Haxhijaha nga Rahaveci;
32. Esat I. Zherka nga Gjakova
33. Fadil Dabiqi nga Arrnjeti;
34. Fadil N. Xhylani nga Rezistenca;
35. Fahredin H. Dina nga Rahaveci;
36. Fatos M. Dautaga nga Gjakova;
37. Fatos M. Deva nga Gjakova;
38. Florent M. Rudi nga Gjakova;
39. Frashër H. Shabani nga Ferizaj;
40. Gazmend Krasniqi nga Zogaj;
41. Haki O. Neziraj nga Nënkalaja;
42. Haki Xh. Haxhimustafa nga Rahaveci;
43. Halil Q. Guta nga Gjakova;
44. Hasan Mulaj nga Lozhani;

45. Hasan Zeçir Zariçi nga Rezistenca;
46. Hetem Mehmet Elshani nga Rezistenca;
47. Hysen Fehmi Juniku nga Gjakova;
48. Hysen Latifi nga Arrnjeti;
49. Isa Sylejman Topalli nga Rezistenca;
50. Ismet R. Isufi nga Drenasi;
51. Jahir Z. Shala nga Negrosi;
52. Jemin R. Kryeziu nga Retia;
53. Jeton M. Xharra nga Gjakova;
54. Jusuf M. Brovina nga Gjakova;
55. Mehdi S. Kollari nga Rahaveci;
56. Metë Ademaj nga Rausha;
57. Milazim D. Shehu nga Dritani;
58. Musli S. Avdyli nga Pleshina;
59. Naser Husaj nga Peja;
60. Nasuf R. Dvorani nga Qëndresa;
61. Nazim H. Halili nga Gjlani;
62. Nazmi M. Haliti nga Dramjaku;
63. Nusret E. Hoti nga Drinasi;
64. Qahil H. Bekteshi nga Lugishtëa;
65. Ramadan Berisha nga Dardani;
66. Ramadan H. Demati nga Tërstena;
67. Reshat Nurboja nga Peja;
68. Rexhep I. Xhemajli nga Arbëria;
69. Rizah H. Krasniqi nga Fatosi;
70. Sabit N. Shehu nga Rahaveci;
71. Shefqet D. Vokshi nga Gjakova;
72. Shemsi H. Golloopeni nga Theranda;

73. Sheremet Ahmeti nga Gjakova;
74. Sinan A. Bytyçi nga Semetishti;
75. Sinan Tafilaj nga Sukasi;
76. Skender I. Hajdari nga Drenori;
77. Sylejman Bytyqi nga Ferizaj;
78. Valdet B. Rama nga Likovci;
79. Vebi H. Kurtalani nga Tërstena;
80. Visar M. Dushi nga Gjakova;
81. Visar M. Demiri nga Pozharani;
82. Xhafer Shala nga Rogami;
83. Xhavit Musëshabanaj nga Peja;
84. Xhelil F. Bejtullahu nga Çallapeku;
85. Xhemajl S. Sallaukaj nga Budiana;
86. Xhemë S. Morina nga Drinasi;
87. Xhevat H. Haziri nga Temali;
88. Ylber I. Topalli nga Gremja;
89. Zaim R. Qatani nga Duhëla;
90. Zijadin Xh. Miftari nga Rahaveci.

**Masakra
në Burgun e Dubravës
19 – 24 maj 1999
Sesion shkencor, më 23 maj 2004**

Rezyme

Platformat serbe për plojat dhe masakrat mbi
shqiptarët datojnë nga periudha e ngritjes së shtetit të

Serbisë. Ato i përuroi vojvoda *Milosh Obrenoviç*, me urdhëresën e vitit 1832: *T'i jepen "25 të rëna me shkop"* akëcilit shqiptar a boshnjak që do të kapet në *Principatën e Serbisë*, kurse më 1834 përdori ushtrinë *"për t'ua djegur fshatrat"* dhe *"kuartet në qytete"*, ngase shqiptarët dhe boshnjakët ishin vu në lëvizjen kombëtare për çlirimin nga *Perandoria Osmane* dhe çlirimi i *Shqipërisë* dhe i *Bosnjës* do të bëhej pengesë për zgjerimet e reja të *Serbisë*.

Këtu e tutje të gjitha zgjerimet e *Serbisë* me toka të *Shqipërisë* u kryen me përdorim të plojave dhe të masakrave mbi popullsinë shqiptare. Kjo strategji ishte institucionalizuar me platformën politike dhe juridike të shtetit serb nacional - *"Naçertania"* të vitit 1844, ku thuhej: *"Serbia duhet të orvatet që nga godina e shtetit turk të heqë vetëm gur pas guri e t'i marrë ato që mundet nga ky material i mirë dhe mbi themelin e vjetër e të mirë të perandorisë së lashtë serbe të ndërtojë sërish e të mund të ngritë shtetin e ri serb"*.

Vërtet, në periudhën e *Krizëz Lindore* nga fillimvitet e '50-ta të shekullit XIX dhe të *Luftës ruso-turke të viteve 1877-1878*, një botë e tërë e krishterë (evropiane e ruse), do të përlyhet me gjakun shqiptar. Madje, historiografia serbe kurrë nuk e ka fshehur urdhëresën e *Princ Milan Obrenoviqit* për ushtarakët e paramilitarët serbë: *"Sa më tepër shqiptarë të shpërngulni, aq më të mëdha do të jenë meritat tuaja para atdheut...!"*. Urdhëresa kishte forcën e ligjit serb për etnocit ndaj shqiptarëve. Me strategjinë *"Toka e*

djegur” u bë spastrimi shqiptar etnik i mbi 640 fshatrave dhe qyteteve shqiptare të *Sanxhakut të Nishit*.

Aeropagu evropian - *Kongresi i Berlinit* (13 qershor – 13 korrik 1878) e shpërbleu gjenocidin e krishterë ortodoks të shteteve fshqinje të Shqipërisë, duke ua njohur të drejtën në rreth 24 458 km² të tokës shqiptare. Viset e aneksuara u dealbanizuan sipas strategjisë “*Toka e djegur*”, duke shpërngulë me dhunë etnocidale të llahtarshme rreth 250 – 300 mijë shqiptarë etnikë. Pas copëtimit ndërkombëtar të përgjakshëm, më 1878, *Njësia etnokulturore dhe gjeopolitike e Shqipërisë*, e ndarë në katër njësi administrative dhe ushtarake osmane, pati 90,100 – 90,270 km² me 3,804,000 banorë, prej të cilëve mbi tre milion shqiptarë. Këso kohe *Vilajeti i Kosovës* kishte 32,900 km² me mbi 1,270,000 banorë. Territori i Kosovës aktuale, prej 10 887 km², më 1912, kishte vetëm rreth 3.7 për qind serbë, ndonëse *Jovan Cvijiq* flet për 5 për qind.

Viti 1912, me *Kryengritjen e Përgjithshme të Shqipërisë* nën udhëheqjen e *Hasan Prishtinës*, shënoi kthesën vendimtare për *autonominë e Shqipërisë*. Për ta penguar këtë fitore shqiptare, *Rusia* e hodhi në luftë *Aleancën ballkanike*, nën parullën: “*Luftë për t'i çliruar popullsitë e krishtera nga pushtuesi shekullor turk dhe nga tirania islame...!*”. Së këndejmi, meqë kombi shqiptar ishte rreth 88% i përkatësisë fetare myslimane, lufta e *Aleancës ballkanike* në fakt ishte ndërmarrje kulturocidale, etnocidale dhe gjenocidale

sllave e greke ortodokse antishqiptare me përkrahjen e *Rusisë* dhe të *Evropës*.

Çdo rezistencë shqiptare do të shuhej me gjak, ploja e masakra të shpërblyera nga *Rusia* dhe *Evropa*, ngjashëm me ato në vitet 1877-1881, të rezistencës së *Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*. Për këtë fakt fliste qartë proklamata shqip me cirilik: "*Te tana fiseve ne Shqipni, Or vllazni!*", e gjeneralit *Bozhidar Janko*, drejtuar shqiptarëve porsa soldateska serbe shkeli në *Mërdar e Përpallac*, më 18 tetor 1912: "*Pushkë kemi me shti në atë që do të shtie ndaj nesh, edhe na lasht zoti, shkrum kemi me e ba at shtëpi, e katundin, qi na kthen pushkën...!*"

Këtë platformë serbe për plojat mbi qenien shqiptare të Kosovës historike e legalizonte ndërkombëtarisht kërkesa publike e *princit* të Serbisë, *Aleksie Karagjorgjeviç*, porsa shkeli në tokën shqiptare në vise të Kumanovës: "*Unë dëshirojë vetëm që këtu të vijnë disa mijëra njerëz evropianë me përgjegjësi e të shohin shqiptarët, të cilët ne i kemi zënë robër, dhe ata të binden se këta njerëz mezi mund të quhen njerëz dhe të përfitojnë bindjen se Ballkani patjetër duhet të spastrohet nga këto egërsira...!*"

Fitorja e Aleancës ballkanike u kurorëzua në *Konferencën e Ambasadorëve në Londër*, e cila nga *Shqipëria* e vitit 1912, shkëputi 61,510 km² dhe mbi tre milion banorë me shumicë absolute shqiptare. *Konferenca e Londrës*, më 29 korrik 1913, e aprovoi projektin e "*Principatës së Shqipërisë*", një shtet

monstrum, pa trup të plotë, tepër të sakatosur, pa asnjë gjymtyrë për jetë. Ky shtet do të kishte rreth 28 760 km² me rreth 800 mijë banorë.

Okupatorët serbë, malazez, bullgarë e grekë, më 1912/13, ushtruan kulturocid, etnocid dhe gjenocid në tokat shqiptare njësoj si në vitet 1877-1881. Mbi platformën e këtij shkretërimi hodhën dritë tre bashkëkohës. Ushtaraku serb *Dimitrie Tucoviç*, socialist, duke informuar opinionin për krimet serbe në një fshat shqiptar në *Lumë*, sot n[Shqipëri, më 1913, shkroi: “*Fshati ka qenë i zhdukur për dy orë, me skena që është vështirë të pasqyrohen. Plutonet kanë rrëzuar gratë që mbanin foshnjat në gji (...), për dy orë janë likuiduar rreth 500 shpirtra (...), kufomat janë hedhur në shtëpia, e shtëpitë janë djegur – ashtu që krimin t’i mbulohet gjurma. Kjo është e vërteta për këtë egërsi të tmerrshme*”.

Ky pasqyrim është më i plotë po t’i shtohet konstatimi i socialistit, *M. Kacleroviç* - “*Armata serbe ka djegur 35 fshatra shqiptare, pa u lejuar banorëve të tyre që të largohen (...). Armata serbe me urdhrin e qeverisë së vet ka masakruar 120 mijë shqiptarë*”. Sipas të dhënave të sistematizuara nga studiuesi italian *A. Baldacci*, - “*janë nja 150 mijë shqiptarë të vrarë nga serbët në vitin 1912-13*”.

Vërtet, të dhënat burimore flasin qartë se gjatë *Luftërave Ballkanike* dhe *Luftës së Parë botërore* në viset e *Shqipërisë Etnike*, përpos numrit të të vrarëve të përmendur më lartë, me strategjinë “*Toka e djegur*” u rrafshuan përtokë mbi 800 lokalitete shqiptare dhe

mbi 500 mijë shqiptarë u njekën në Azi e gjetkë. Po kështu, nga dhjetori i vitit 1918 e deri në përmbylljen e Paqjës së Versajës - Parisit, më 1920, në viset shqiptare u zbatua kanibalizëm serbo-jugosllav. Sipas të dhënave të Shtabit të Luftës së Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare, të sublimuara në Proklamatën e fillimtetorit 1945, “në vitin 1918, gjatë krijimit të Jugosllavisë mozaike, prapë sipas urdhrit të Beogradit, janë therë dhe mbytur mijëra shqiptarë. Aso kohe në Konferencën e Pages është sjellë regjistri për tetëdhjetë mijë viktima, i përcjellë me një protestë energjike, por edhe kjo, si gjithherë, ‘Vox clamantis in deserto’ për veshët e Evropës.

Nga dokumentet e prejardhjes shqiptare, dërguar Konferencës së Versajës, shihet se numri i shqiptarëve në viset e njësisë etnokulturore e gjeopolitike të Shqipërisë së vitit 1912, kishte rënë nën numrin e shqiptarëve të viteve '50-ta të shekullit XIX. Tashti në arealin e Shqipërisë Etnike kishte vetëm 1,779,929 frymë (833,000 në arealin e Shqipërisë londineze dhe 946,929 në viset shqiptare të aneksuara Jugosllavisë dhe Greqisë). Del se vetëm midis viteve 1912-1920, numri i shqiptarëve në Shqipërinë Etnike ishte zvogëluar për mbi 1,220,000 frymë dhe kjo pa shtimin natyror të tre milionë shqiptarëve, sa kishte më 1912.

Madje, shqiptarët, për shkak se ishin kryesisht popullsi myslimane, nga pseudoshkenca serbe, edhe më tutje, do të paraqitën, para botës së krishterë antiislame, si masë amorfe e dekompozuar nga

aspekti frymor e civilizues, pa perspektivë nacionale, e denjë për asimilim në serbë si akt civilizues. Për këtë synim propaganda antishqiptare serbe kishte mbështetje të pa rezervë në qarqe të caktuara evropiane. Ja një shembull eklatant: *Herman Vendel*, më 1920 dhe 1921, *shqiptarët do t'i tregojë si "popull rudiment ballkanik gjysmë të egjër, të dëmshëm për civilizimin evropian"* dhe gjenocidin serb mbi shqiptarët do ta arsyetojë si masë të nevojshme të *"civilizimit të krishterë"*, sepse, sipas tij, *"historia nuk mund të durojë kërcënimet mijëravjeçare (...) të një race që po vdesë..."!?!"*

Shfarosja mbi këtë platformë serbe për kulturocid, etnocid dhe gjenocid ndaj shqiptarëve vazhdoi gjatë tërë kohës së *Jugosllavisë versajase*. Kjo ishte strategji serbe *"Toka e djegur"*, me pretendime të qarta: *"Të ndërronin fizionominë e viseve të banuara pastër me shqiptarë"* - do të konstatojë shtypi socialist jugosllav. Sipas venerimeve të *L. Trockit* në vendin e ngjarjeve të përgjakshme, në Kosovën e viteve '20-ta të shek. XX: *"Ekzistonte një ndarje e punëve. Nëse ishte në pyetje ndonjë i arratisur, shtëpitë e tyre së pari do t'i shkatërronte ushtria e rregullt. Më pastaj vinin në radhë rezervistët të cilët kryenin pjesën e tyre të punës. Pastaj vinin pjesëtarët e policisë e më në fund komitet"*. Strategji e zbatuar, njësoj, më 1999.

Se ky qellim po realizohej me bekim të Evropës, mund të vërtetohet edhe me një të vetmin prononcim të përfaqësuesit të *Jugosllavisë* në

Shoqatën e Popujve në Gjenevë, më 13 mars 1929, i cili, pa i luajtur gjaku në fytyrë, do të gënjejë: "Në vendet tona jugore, të cilat kanë qenë pjesë përbërëse të shtetit tonë, ose i janë ndarë Mbretërisë sonë para 1 shkurtit 1913, nuk ka pakica kombëtare" !?! Ky është morali i diplomacisë dhe i gjenit pushtues serb.

Në funksion të platformës serbe për dealbanizimin e tokave shqiptare krahas plojeve mbi shqiptarët ishte edhe sjellja e elementit sllav në trojet e tyre. Këtë fakt pasqyronte një Anonim nga Peja në organin e PKJ-së, "Proleter", më 15 dhjetor 1929: *"Ne, shqiptarët, jemi të detyruar që t'ua ngritim shtëpitë (kolonistëve). Me parat tona jemi të detyruar të blejmë konopin me të cilin do të na varin neve (...). Fshatra të tëra po i kallin, që t'u bëhet vend kolonistëve. Me pushkë, mitraloza dhe bomba po ndjekin mijëra e mijëra familje shqiptare nga vatrat e tyre". Në këtë frymë konstatonte, më 15 shtator 1931, edhe organi "Liria Kombëtare" e Gjenevës: "Afër një milion njerëz po shpërngulen nga pushteti serbomadhi" dhe se "me thikë po kryhet serbizimi i emrave të njerëzve dhe të fshatrave, që kështu të shlyhej çdo dëshmi shqiptare, që të ndryshohet karakteri etnik i Kosovës".*

Me aspirata të tilla në vijimësi u thellua spastrimi etnik shqiptar i Kosovës në vitet '30-ta. Madje, më 1937, qarqet akademike, politike dhe ushtarake serbe kërkonin që brenda një afati shumë të shkurtër përqindja e elementit sllav - serb e malazez në Kosovë të ngrihej në 67.5%, kurse përqindja e

shqiptarëve nga 80% të zbritëj në 21.5%. Në urdhëresat për policinë dhe administratën vendëse në Kosovë kishte edhe ankesa: "Serbisë Jugore nuk po i kushtohet kujdes i duhur. Nëse ajo bëhet serbe do të zgjidhet çështja jugosllave". Për ta arritur këtë, kërkohej që të largoheshin edhe 400 mijë shqiptarë nga Kosova për në Turqi dhe krahas 143 mijë kolonëve serbo-malazez të sjellë deri më 1937, të silleshin edhe 470 mijë kolonë me prejardhje etnike sllave.

Në shërbim të këtyre planeve u futën akademikët, shkrimtarët, profesorët universitarë serbë, të tubuar në "Srpski Kulturni Klub" të Beogradit. Megjithatë, *Elaborati* i akademikut Vasa Çubriloviç: "Iseljavanje Arnauta" (Shpërngulja e shqiptarëve), i datës 7 mars 1937, është *projekti* më makabër që njohu historia për *kulturocid, gjenocid dhe etnocid* mbi një popull të tërë dhe që do të mbetet i pavërejtur dhe i padënuar nga bota e qytetëruar, nga Evropa?! Në këtë projekt saktësohej: "*Të rekapitulojmë: Shqiptarët është e pamundur të zhduken vetëm me kolonizim permanent (...). Mënyra e vetme dhe mjeti i vetëm - për zhdukjen e shqiptarëve dhe të shqiptarësisë së Kosovës - është forca brutale e një pushteti të organizuar shtetëror, për çka ne jemi bindur mbi ta*", më 1878/79.

Vërtet, është e pamundur që këtu të pasqyrohet tërë kompleksiteti i politikës kulturocidale, gjenocidale dhe etnocidale kanibaliste serbosllave midis *Dy Luftërave Botërore* ndaj shqiptarëve, por as

nuk mund të pasqyrohen të gjitha mënyrat e rezistencës për mbijetesë shqiptare kundër asaj dhune. *Gjeneralshtabi i Ushtrisë së Jugosllavisë* duke vlerësuar se pushteti civil dhe policor nuk po ia dilnin të shfarosnin popullin shqiptar në viset e aneksuara Jugosllavisë versajase, kërkoi, më 1938, nga *Ministria e Ushtrisë* që *thyerjen e shqiptarëve t'ia lëshonte në kompetencë elementit serb e malazez dhe ushtrisë, që do të thotë: paramilitarëve çetnikë të ndihmuar nga ushtria dhe saktësonte: "Ushtria jonë do të ketë për detyrë, si edhe deri tashti, e posaçërisht tashti, që në këto vise të kryejë detyrën e vet shtetërore dhe misionin nacional dhe kulturor".*

Në prag të *Luftës së Dytë Botërore* një pengesë madhore për shfarosjen e shqiptarëve në *Jugosllavi* paraqiste ekzistimi i *Shqipërisë* londineze si shtet, ndaj nga fundi i vitit 1938, *Jugosllavia* do t'i imponohet *Greqisë* dhe *Italisë* për një *aleancë* për ndarjen e *Shqipërisë së Ahmet Zogut*, me çka do të krijoheshin rrethana për zhdukjen fizike dhe asimilimin e tepricës shqiptare në serbë, në grekë dhe në italianë: *"Në popullin tonë kurrë nuk ka pasur simpati për shqiptarët as herët as sot. Janë shikuar si armiq të vendit tonë dhe të popullit tonë. Në kombinacionet tona politike e diplomatike dhe politikën tonë ballkanike gjithmonë kemi synuar që t'i hedhim poshtë të gjitha kërkesat shqiptare për formimin e shtetit të pavarur, nga shkaku i thjeshtë, se ai shtet mund të krijohej vetëm kundër nesh dhe kundër synimeve tona nacionale."*

Mbi këtë platformë serbe *kundërshqiptare* është ngritur edhe *Elaborati* i akademikut nobelist Ivo Andriç, më 30 janar 1939: "*Me marrjen e Shqipërisë do të zhdukej qendra tërheqëse për pakicën shqiptare në Kosovë, e cila, në situatë të re, më lehtë do të asimilohet.*" Sipas direktivave akademike serbe, diplomacia jugosllave kundër qenies shqiptare të Kosovës historike do të mbështetej me vrasje të personaliteteve shqiptare - "*si të ishin egërsira!*" Këtë strategji shtetërore serbe për shfarosjen e shqiptarëve do ta pasqyrojë bukur kolonisti malazias komunist, Radovan Zogoviç, mik i shqiptarëve përjetësisht: "*Pushteti serbomadh bën çdo gjë që më presion ekonomik, me shkollë policore, me ndërprerjen e ndihmave medicinale kundër malaries e të tjera, t'i nxjerrë nga Ligji dhe t'i shfarosë banorët shqiptarë...*".

Më herët u tha se me burimet e proveniencës së Shokatës së Popujve mund të vërtetohet se në Jugosllavinë versajase më 1920 kishte 946,929 shqiptarë. Sipas shtimit natyror rreth 40 për një mijë, që kishin shqiptarët, deri më 1941 numri i shqiptarëve në Jugosllavi duhej të arrinte në mbi dy milionë. Së këndejmi del se pushteti serbo-jugosllav midis *Dy Luftërave Botërore* likuidoi dhe shpërnguli mbi një milion shqiptarë.

Okupimi nazifashist i tokave shqiptare jashtë *Shqipërisë londineze*, nga mesprilli 1941, ndonëse erdhi si *infuzion për shqiptarësinë* e tyre në agoni, nuk do ta zgjidhte *Çështjen shqiptare*, kurse *Lufta*

Nacionalçlirimtare Antifashiste krahas popujve të *Jugosllavisë* do të shfrytëzohet për rianeksimin serb, malazias dhe bullgaro-maqedon të tokave shqiptare jashtë *Shqipërisë londineze*. Vërtet, koha e vërtetoi se *Deklarimi i Titos*, më 4 dhjetor 1943, para një reporteri anglez të luftës, se "*ardhmënia e Kosovës ka për t'u vendosur me plebishit dhe se kufijtë, nëse tregohet nevoja, kanë për t'u ndrequr në dobi të Shqipërisë*", ishte kurth tradhtie për çlirimtarët antinazifashistë shqiptarë, njësoj si edhe *Rezoluta e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovë* e 2 janarit 1944, në të cilën sublimohej kërkesa politike jetike e shqiptarëve:

"Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banueme në shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmonë ashtu edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipnin. Rruga e vetme që populli shqiptar i Kosovës e i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipnin asht lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjaksuer dhe rroghtarve të tij. Sepse kjo asht rruga e vetme të fitohet liria, kur të gjithë popujt pra edhe shqiptarët do të jenë në gjendje të deklarohen për fatin e vet me të drejtë në vetëvendosje deri në shkëputje.

Garant për këtë asht UNÇJ dhe UNÇSH me të cilën asht e lidhun ngusht. Krahas kësaj për këtë janë garantë aleatët tanë të mëdhej: Bashkim Sovjetik, Anglia dhe Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)".

Mirëpo, porsa shkeli në tokat shqiptare këmba e partizano-çetnikëve serbë, malazez dhe maqedono-bullgarë, aleatë të *Rusisë*, të *Anglisë*, të *SHBA-ve* dhe të *Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare të Shqipërisë*, *UNÇJ-ja* e gjuajti lëkurën e qengjit dhe u rivësh me gunën tradicionanale të ortodoksizmës kundër qenies së *Shqipërisë Etnike*. Më 3 dhjetor 1944, prapë V. Çubriloviç, tashti *Ministër për Ekonomi i Serbisë kominterniste*, lëshoi për përdorim sekret instruksionet për qarqet ushtarake e politike të Jugosllavisë - *për zhdukjen me të gjitha mjetet të shqiptarëve etnikë, të gjermanëve dhe të etnive të tjera josllave "në Jugosllavi"*, dhe përfundonte: "*Dy janë mënyrat të cilat do të merreshin parasysht për spastrimin radikal të shqiptarëve: që t'i shfarosim ose që t'i shpërngulim!*"

Për t'i plotësuar urdhërkërkesat që dilnin nga *Udhëzimet e Çubriloviqit*, në tokat shqiptare, deri në fundnëntorit 1944, do të përqendroheshin 20 - 25 brigada, të quajtura "*partizane*" - serbe, malazeze, bullgare e "*maqedonase*", me udhëzime tepër rezervat: *Të vriten me plumb, thikë e zjarr, më së paku 50% të shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera jashtë Shqipërisë londineze!* Sipas burimeve relevante nga mesi i nëntorit 1944 deri në vitin 1947 u vranë mbi 47 mijë shqiptarë. Të vrarë për rëndësinë e shqiptarësisë së Kosovës janë edhe qindra mijëra të shpërngulur me dhunë në Anadoll. Vërtet, sipas burimeve ushtarake jugosllave sekrete, në *Jugosllavi*, më 1937, kishte mbi 900 mijë shqiptarë. Sipas

regjistrimit të vitit 1948, në Jugosllavi pati 750,431 shqiptarë, që do të thotë mbi 149,569 shqiptarë më pak se para njëmbëdhjetë vjetëve. Edhe 412,000 shqiptarë u ndoqën nga trojet e tyre sipas *Marrëveshjes gjentlemane Jugosllavi - Turqi* të vitit 1953. *Lidhja Socialiste e Kosovës*, më 1976, kishte të dhëna për shpërnguljen e *Një milion shqiptarëve* vetëm nga Kosova midis viteve 1912-1966.

Të dhënat jugosllave policore flasin edhe për mbi 280 mijë shqiptarë të burgosur nga viti 1945 deri në vitin 1966, por burgosje të shumta pati edhe në vitet 1967-1980. Ndërkaq, nga pranvera e vitit 1981 *Kosova* ishte në luftë të hapët me *Jugosllavinë*. Burimet e prejardhjes gjyqësore dhe policore flasin për rreth 900 mijë shqiptarë të burgosur politikë, e të trajtuar në polici, deri në fund të vitit 1991 (750 mijë në Kosovë dhe 150 mijë në vise të tjera: Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Bosnje, Kroaci, Slloveni).

Në vitet '90-ta të shekullit XX, Kosova dhe viset e tjera shqiptare nën Jugosllavinë Versajase-Avnojiste ishin të nxjerra jashtë ligjit. Të gjitha mynxyrat e dhunës kulturocidale, gjenocidale dhe etnocidale kanibaliste serbe mbi shqiptarët, prapë, do të ushtrohen me udhëzime publike e sekrete të *Akademisë së Shkencave e të Arteve të Serbisë*, tashti në krye me akad. *Dobrica Qosiç*. Bazën e këtyre udhëzimeve për zhdukjen e shqiptarësisë së Kosovë dhe të viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavinë Avnojiste, ngërthente *Memorandumi legal i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë* i

vitit 1985. Ky trakt politiko-policor, në fakt, paraqiste *Projektin për Serbinë e madhe nga Vjena deri në Stamboll*, me prejudikim se *Serbi është deri aty ku gjendet një serb, ose një varr serbi!* Me këtë memorandum duhet të nxitej *gjakmarrja dhe hakmarrja* serbe e jugosllave përfundimtare ndaj shqiptarëve, me theks të veçantë ndaj shqiptarëve myslimanë, që shqiptarësia e Kosovës të zhdukej me një *strategji politike* të pranueshme nga sllavët në veçanti dhe krishtërimi në përgjithësi.

Për ta vu në jetë me sukses këtë "*program nacional serb*", *Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë* kujdestaroi në ngritjen politike e shtetërore të personalitetit *Slobodan Milosheviç*, të cilin e nxori në krye të lëvizjes serbomadhe: "*Dogodio se narod*" (Ndodhja e popullit), të mbështetur në trillime, paragjykime dhe në kërkesa hysterike për ekspansion serb: "*Kosova është zemra e Serbisë*", kurse "*Serbia e Madhe - prej Horgoshit – Viroviticë e Karllobag deri në Durrës e Selanik*" - do të realizohej duke u mbështetur në "*të vërtetat*", serbe për Kosovën "*serbe*", - pa serbë historikisht, por me pushtet serb dhunues gjakësor prej tetorit të vitit 1912. "*Kosova është tokë serbe për të cilën kurrë nuk mund të flitet ndryshe përveçse si për tokë serbe të shenjtë*", sepse "*Kisha në krye me mbretin dhe me aparatin propagandues e ka ndërtuar mitin e Kosovës*". Dhe, duke e marrë mitin kishtar për tapi toke, patrikut serb, German, më 28 korrik 1988, i ftonte serbët në luftë "*për hakmarrje të re të Kosovës!*"

Me mbështetje nga kisha dhe me bekimin e patrikut, Slobodan Milosheviç, më 28 qershor 1989, në Mitingun e Gazimestanit, e nxori përfushe planin për ripushtimin dhe për serbizimin përfundimisht të Kosovës, me strategjinë serbe "*Toka e djegur*": "*Është treguar se Kosova dhe përcaktimi për Kosovën e mban të bashkuar tërë popullin serb*", dhe tashti "*Miti i Kosovës nuk është vetëm çështje kishtare*", por "*është çështje e popullit*", ndaj, e vërteta se "*çka është historike e çka legjendë në Betejën e Kosovës (1389), ajo më nuk është me rëndësi*", sepse "*gjashhtë shekuj pas asaj edhe sot, prapë, jemi në beteja dhe para betejave!*"

Vitet '90-ta ishin paraparë për zbritjen e përqindjes së shqiptarëve në Kosovë nga 93% në nën 50%. Kjo do të arrihej me të gjitha metodat dhe strategjitë e njohura në botë për spastrimin etnik të një vendi. Në funksion të këtij qëllimi në vitet '80 dhe '90, me dhunë ekonomike dhe policore, u ndoqën nga Kosova rreth 400 mijë shqiptarë të aftë për luftë, kurse për 14 muajt e fundit të luftës ballore të UÇK-së me soldateskën serbe (28 shkurt 1998 - 10 qershor 1999), nga Kosova u ndoqën me lemeri, ploja e masakra rreth një milion shqiptarë të Kosovës. Shkretërimi i asaj që mund të quhet *shqiptarësi* aty ku shkeli këmba e soldateskës serbe në tokat shqiptare - janë prova. Veçanërisht dhuna dhe dhunimi, plojat dhe masakrat mbi civilët e pambrojtur, burra, gra, pleq e fëmijë anekënd Kosovës, nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999, periudhë kjo e *Bombardimeve të*

NATO-s mbi makinerinë ushtarake të Serbisë, janë plagë të prekshme që vazhdimisht kullojnë gjak. Soldateska serbe zbatoi mbi 30 ploja në fshatra dhe qytete, vrau mizorisht mbi 15.000 civilë - pleq, burra, gra dhe fëmijë (mbi 3400 të zhdukur), plagosi mbi 3.219 dhe burgosi mbi 1.360 veta. Me strategjinë “*Toka shqiptare e djegur*” - dogji 1.007 fshatra (nga 1392 sa ka Kosova), mbi 212.347 shtëpi banimi, objekte përcjellëse, objekte shoqërore (prej tyre 218 xhami) dhe lokale afariste. Dhunë mbi dhuna është dhunimi i mbi 20.000 femrave, prej të cilave 2019 nëna që kanë 3007 fëmijë të traumatizuar përjetësisht. Kjo nuk ka çmim.

Aktualisht mbi dymijë e pesëqind shqiptarë as në jetë as me varre në duar të Beogradit zyrtar - për ta mposhtur fitoren e UÇK-në, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës – janë plumb në zemër të shqiptarëve. E, krahas këtyre rëndon *Masakra serbe në Burgun e Dubravës* ndaj të burgosurve shqiptarë, prej datës 19-24 maj 1999.

Vërtet, retë mbi *Burgun e Dubravës* nisën nga fillimi i vitit 1997, kur në Kosovë ndodhi një varg arrestimesh me goditje të drejtpërdrejta në strukturat e UÇK-së. UDB-ja dhe *ushtria jugosllave* synonin që më këto goditje të dobësonin, apo të asgjësonin në tërësi forcën ushtarake dhe politike UÇK, e cila në programin politik dhe në doktrinën ushtarake kishte çlirimin e Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare, me mjete tjera nga ato që trumbetoheshin në ato vite nga partitë dhe lëvizjet pacifiste shqiptare të kohës.

Burgjet hetuese në Kosovë thuajse ishin të stërmeshura nga këto arrestime dhe në çdo qeli të këtyre burgjeve kishte „terroristë” të pathyeshëm në rrugën jetësore çlirimtare të tyre.

Realisht, pas dënimit të tri grupeve, më 1997, pushtuesi serb sikur planifikonte që burgjet hetuese t'i mbushte me „terroristë” të rinj. Në fillim të vitit 1998 nga *Burgu Hetues i Qarkut të Prishtinës* transferohet në *Burgun e Dubravës* një grup i të dënuarve politikë. Në shikim të parë dukej se nuk po ndodhte asgjë e jashtëzakonshme, mirëpo më vonë u kuptua se aty synohej një grumbullim i madh i të gjithë të burgosurve politikë me autoritet dhe me ndikim në radhët e masave shqiptare.

Nga kjo kohë në *Burgun e Dubravës* ndodheshin në vuajtje të dënimit shumë të burgosur politikë të ndarë nëpër pavijone. Midis këtyre ndodheshin shumë figura të shquara - veprimtarë të devotshëm të çështjes kombëtare të cilët për veprimtari politike patriotike ishin dënuar disa herë më dënime drakonike. Me këta do të solidarizohen politikisht edhe një numër të burgosurish ordinerë.

Zgjerimi i luftës së UÇK-së e sidomos *Ndeshja balllore në Likashan*, më 28 shkurt dhe *Epopeja e UÇK-së në Prkaz*, më 5-7 mars 1998, ndryshoi shumë çka, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar. Tashti u pa se edhe pushteti serb po i ndërronte planet dhe po përgatitej të ballafaqohej me një situatë tjetër nga ajo që kishte menduar. Me një vendim të *Ministritë së Drejtësisë së Serbisë*, më 29

dhe 30 prill 1998, u bë ritransferimi nga *Burgu i Dubravës* në burgjet serbe i të gjithë të burgosurve politikë, me arsyetimin, sa qesharak aq edhe ironik - kinse „*për shkaqe sigurie...*”!?! Ky transferim fillimisht u bë në dy burgje, pikërisht në *Kazamatin e Nishit* dhe në *Kazamatin e Mitrovicës së Sremit*.

Realisht, pas transferimit të të burgosurve politikë nëpër burgjet serbe, nuk vonoj edhe shumë dhe i larguan edhe të gjithë të burgosurit tjerë që ishin të dënuar për vepra ordinere. Të gjithë u dërguan nëpër burgje të ndryshme të Serbisë. Burgu i Dubravës tani ishte i liruar nga të burgosurit, mirëpo aty tashti po ndodhte diçka e paprecedentë. Zhvillimi i *Luftës së UÇK-së* po kalonte në një fazë të re. Përhapja dhe shtrirja e saj ishte më se evidente, andaj edhe serbët po merrnin masa të reja shtesë për të goditur jo vetëm UÇK-në dhe bartësit e organizimit të kësaj lufte, por edhe mbi popullatën civile, si ndëshkim, duke zbatuar strategjinë e *Tokës shqiptare të djegur*.

Në rrethana të tilla, objektet e *Burgut të Dubravës* në këtë drejtim po shndërroheshin në një bazë ushtarake e paramilitare institucionale serbe shumë të rëndësishme për operacionet ndëshkuese që po ndërmernte komanda supreme ushtarake dhe policore serbe për *Rrafshin e Dukagjinit* dhe më gjerë. Në objektet e burgut dhe përreth pushtuesi serb përqendroi një arsenal të madh luftarak, me të cilin operonte kundër UÇK-së dhe *popullatës civile*.

Të burgosurit shqiptarë politikë dhe ordinerë edhe pse ishin dërguar nëpër burgjet serbe jashtë zonës së luftës, për gjoja “*çështje sigurie*”, nuk ishin kurrë të sigurt, sepse serbët e shumë të merrnin pjesë në luftën që po zhvillohej në *Kosovë*, shpesh u vinin dhe i “*vizitonin*”, e sidomos kur pësonin humbje në frontin e luftës. Thjeshtë, shqiptarët në burgjet serbe nuk ishin të burgosur, ishin pengje të luftës, dhe mbi ta ushtrohej dhuna serbe tradicionale sa herë që serbët donin ta demonstrojnë „*fuqinë*” e shtetit policor e ushtarak milosheviçian. Për të burgosurit shqiptarë burgu tashti ishte kamp i shfarosjes dhe asgjë tjetër, pasi që të drejtat që mund t’i gëzonte një i burgosur për ta kishin pushuar së ekzistuari.

Fillimi i bombardimeve të *NATO*-së, më 24 mars 1999, pengjet shqiptare i gjeti gati në të gjitha kazamatet serbe dhe në kushte mjaft të vështira. Autoritetet e këtyre burgjeve më përpikëri u përmbaheshin udhëzimeve nga lartë dhe zbatonin planet antishqiptare në nivele të shtetit që ishin bërë qysh më herët. Për çudi, të burgosurit shqiptarë, kur nuk mund të mendonin fare për përgatitjen e mynxyrës së *Burgut të Dubravës*. Më 26 prill 1999 u bë kthimi i të burgosurve shqiptarë nga *Kazamati i Mitrovicës së Sremit* në *Kazamatën e Nishit*, i cili, për shqiptarët, i tejkalonte edhe kampet më të këqija naziste.

Në *Burgun e Nishit* i mbajtën vetëm tri ditë dhe ndaj të burgosurve shqiptarë këtu tashti do të zbatohesh një dhunë shumë e shfrenuar, që nuk kurseu askënd.

Plak apo i ri, i sëmur apo invalid, i mundur apo i pamundur, të gjithë jetuan një katrahurë të papërshtueshme.

Nga *Kazamati i Nishit*, më 29 prill 1999, të mbërthyer më hekura dhe varganë, më një përcjellje të veçantë, të burgosurit shqiptarë i trusen në autobusë dhe i nisën për në Kosovë. Në një moment, pikërisht në mes të fshatit *Llapushnik* dhe *Arllat* të *Drenicës*, një autobлиндë e ushtrisë serbe hyri në mes të dy autobusëve të fundit në kolonë dhe atë e goditi një aeroplan i *NATO*-s. U shkatërrua autobлиндa dhe u vranë ushtarët serbë që u gjendën brenda. Ushtarë dhe paramilitarë serbë që kishin qenë në pozicione për rreth rrugës, të tmerruar dhe të mllëfësuar për humbjet që pësoi makineria ushtarake serbe, tentuan që më çdo kusht të hakmerreshin më vrasjen e disa pengjeve shqiptarë që gjendeshin në autobusë të lidhur këmbë e duar.

Kërkesës për hakmarrje gardianët shoqërues iu përgjigjën: “*E kemi një urdhër nga Milosheviqi që këta të burgosur duhet më çdo kusht t’i dërgojmë në numër të caktuar në një vend*”. Së fundi, paramilitarët e frustruar iu bindën logjikës ushtarake, e kuptuan se kishte një urdhër nga lartë dhe se atë urdhër duhej respektuar edhe pse e dëshironin hakmarrjen këmbadoras edhe ndaj të pamundurëve. Shqiptari, ushtari i *UÇK*-së dhe ushtari i *NATO*-s për ata tashti ishin një dhe barabartë të urryer.

Të burgosurit shqiptarë nga *Kazamati i Mitrovicës së Sremit* dhe *Kazamati i Nishit* pas një

viti, përsëri, u gjetën në *Burgun e Dubravës*, por nuk mund ta merrnin me mend se çka po përgatitej, në të vërtetë, për jetën dhe për fatin e tyre. Më 30 prill 1999, në *Burgun e Dubravës* i sollën të burgosurit nga *Prizreni*, *Lypjani* dhe *Gjilani*, kurse pas dy ditësh, më 2 maj 1999, i sollën të burgosurit nga *Prokupla* dhe *Vraja*. Në këtë burg, kohë më parë, ishte sjellë një pjesë e të burgosurve ordiner shqiptarë nga *burgjet e ndryshme* dhe aty ishte një pjesë e të burgosurve që ishin gjatë kohë në një pavijon, i cili ishte për nga mbikëqyrja më i veçantë. Vazhdimi i grumbullimit të të burgosurve dhe të pengjeve në këtë kamp tashti do të vazhdojë për çdo ditë, duke i sjellë herë nga burgjet hetuese, herë të arrestuarit në qytetet dhe në fshatrat nën shtetrrethimin ushtarak dhe policor. Më 18 maj 1999 i sollën edhe *155 civilë* nga Gjakova, që ishin arrestuar apo ishin marrë me dhunë nga shtëpitë e tyre.

Sipas informatave të tërthorta, numri i të burgosurve shqiptarë - pengje të luftës në *Burgun e Dubravës* tashti arriti mbi 950 veta, ndaj të të cilëve zbatohej keqtrajtimi dhe dhuna e paparë. Mirëpo, në këso rrethanash ndodhi një përjashtim i papritur. Të burgosurit pritnin me padurim ditën e *17 majit 1999*, kur do t'i skadonte afati i burgut profesor *Mr. Ukshin Hotit*, ndërsa *Ai* do të merret nga burgu, pa pritur, një ditë më parë, më 16 maj 1999, "*lirim*" i pazakonshëm në praktikën e burgjeve serbo-sllave dhe veçanërisht për rrethanat e *Luftës në Kosovës*. Pas marrjes së *Profesor Hotit*, zhvillimet vazhduan rrugëtimin e

zakonshëm deri në gjakderdhjen e llahtarshme të 19 - 24 majit 1999. Më 16, 17 dhe 18 maj 1999 u “*liruan*” nga burgju edhe tre veta, nga të cilët njëri u ekzekutua në afërsi të burgut, njëri është gjetur i ekzekutuar pas Luftës dhe i treti mbahet për i “*zhdukur*”.

Sipas njohurive tona, *Masakrën serbe në Burgun e Dubravës më 19-24 maj 1999*, e ka disejnuar dhe udhëhequr Miki Vidiq, komandant i Burgut të Dubravës dhe Aleksandër Rakoçeviq, drejtor i Burgut të Dubravës, të ndihmuar nga: Mbikëqyrësi i quajtur Branko (personi i cili e mori nga pavijoni U. Hotin); Zhivković Zharko (zëvendës drejtor) dhe Zhivković Dragan (i quajtur “*Kasap*”), pjesëmarrës i njohur në krimet serbe në Bosnje. Këta zyrtarë, për realizimin e skenarit të masakrës, në *Burgun e Dubravës* paraprakisht sollën kriminelë serbë, të dënuar për krime të llahtarshme, të gatshëm për të pirë gjak shqiptari, me çka do të shlyenin dënimet dhe do të rehabilitoheshin në shoqërinë serbe.

Deri në prag të filleve të *Masakrës serbe* të burgosurit ishin të vendosur në katër pavijone: C1, C2, B2 dhe në *Pavijonin Pranues*, në kushte jetësore të pa imagjinueshme të rënda. Makineria ushtarake serbe i kishte bërë me përpikëri llogaritë, duke qenë e sigurt se kishte ardhur koha që NATO-ja t’i bombardojë edhe objektet e burgut, meqë kishte informata paraprake se ai ishte kthyer në bazë ushtarake. Ndërkohë ishin tërhequr “*paramilitarët*” dhe në vend të tyre ishin kthyer të burgosurit shqiptarë. *Logjistika e NATO-s*, si duket, nuk u besoi

informative nga logjistika e UÇK-së - për kthimin e të burgosurve shqiptarë në ambientet e Burgut të Dubravës.

Më 19 maj 1999, diku nga gjysma e ditës, flota ajrore e NATO-s bombardoi objektet e burgut – *dy pavijone brenda mureve dhe disa jashtë tyre*, si dhe *drejtorinë e burgut*, etj. *Pavijoni C1*, që ishte përplot me të burgosur, *goditet me 4 projekteile*. Pas pak çastesh qëllohet edhe *pavijoni B3*, por këtu nuk kishte të burgosur, ngase tashti ai përdorej si depo. Gardianët kishin ikur sapo kishte filluar bombardimi, kurse të burgosurit në pavijonet *C1 dhe B2* ishin të mbyllur. Vetëm të burgosurit në *pavijonit C2* kishin një tretman më të veçantë, ishin kryesisht të burgosur ordinerë. Të burgosurit që përjetuan krimin në *pavijonin C1*, do të përpiqen për t'i thyer grilat, por pa sukses. Ballafaqimi me mundësinë e vdekjes, solli një panik i cili vështirë përballohej. Brenda në gjermadhë kishte të plagosur të ngujuar, të cilëve askush nuk mund t'ju ndihmonte.

Në këto momente të rënda, kur s'dihej se çka po ndodhte, të burgosurit ordinerë nga *C2-shi* u organizuan për t'i hapur dyert e dhomave me forcë, duke nxjerrë, kështu, nga gjermadhat të plagosurit dhe të vdekurit, fillimisht në *pavijonin C1* e pastaj në *B2*. Pasi të gjithë dolën në oborrin e burgut, u konstatua se në *pavijonin C1* kishin mbetur të vrarë tre të burgosur dhe nëntëmbëdhjetë ishin plagosur, prej të cilëve tre shumë rëndë. Njëri vdiq në spitalin e Pejës.

Pas dy orësh, nga dera e hyrjes së burgut, hynë ca gardianë të armatosur. Me ta ishte edhe një i burgosur ordiner serb nga burgu i Nishit me rrobe të burgut dhe me armë në duar. Gardianët fillimisht i urdhëruan të bëheshin reshtë të burgosurit dhe tani dhanë urdhër të hynin brenda. Nga sjellja e tyre dhe zhvillimet e reja u pa se udhëheqja e burgut mezi kishte pritur aktin e bombardimeve të pritura, për të trumbetuar para opinionit ndërkombëtarë, se: “...ja ç’ krime bën NATO-ja, duke bombarduar edhe burgjet dhe të burgosurit e mbrojtur me ligjet ndërkombëtare të Luftës...!?!”

Që pompoziteti i propagandës serbe milosheviqiane *antino*, njëkohësisht dhe *antiuçkë* të jetë sa më i besueshëm, pa vonuar, bashkë me gjithë stafin e burgut, hynë edhe *mantilëbardhë* (me gjasë oficerë ushtarakë) dhe *gazetarë* të mediave të shkruara dhe elektronike. Vërtet, Serbia nuk pati rast më të mirë, për tu tërhequr si humane para botës?! Askush nga blic “*vizitorët*” nuk u mor me fatin e të plagosurve. Bënë incizime dhe fotografime të pamjeve të kurdisura dhe shkuan. *Logjistika e UÇK-së* pa vonuar reagoi dhe ia tërhoqi vërejtjen komandës së fluturimeve të *flotës ajrore të NATO-s*, se makineria ushtarake serbe e kishte hedhur në kurth. Mirëpo, do të ndodh diçka që duhej të përgjigjej dikush nga radhët e *logjistikës së NATO-s*.

Vërtet, të nesërmen, më 20 maj 1999, mbizotëroi heshtja, shqetësimi dhe ankthi para të panjohurës, kurse më 21 maj, prapë, projektilë të

fuqishëm fillimisht do të godasin ndërtesat jashtë mureve të burgut. Në vazhdim, për çudi, cak i sulmeve do të bëhen edhe objektet vitale brenda mureve të burgut. Së pari qëllohet *mensa* dhe vriten e lëndohen dhjetëra të burgosur. Bombardimi vazhdoi me ndërprerje të herëpashershme, deri në mbrëmje. Të burgosurit, pa shtegdalje tjetër, do të tubohen në një hapësirë të ngushtë katërkëndëshe, mes këtyre objekteve: *mensës, ambulantes, pavijonit të pranimit, shkollës, sallës së sporteve, shtëpisë së kulturës, pavijonit B3 dhe B2*. Gjatë kësaj kohe, një projekt il bie afër *shtëpisë së kulturës*, nga e cila goditje prapë e gjejnë vdekjen dhe u plagosën shumë të burgosur.

Duke parë rrezikun brenda hapësirës së këtij katërkëndëshi, të burgosurit do të largohen nga ndërtesat. Vendi më i përshtatshëm dukej *fusha e sportit* nën qiell të hapur. Disa të burgosur do të futen në puseta, apo edhe diku tjetër, ku mendonin se do të ishin më të sigurt. Në këtë ditë tragjike, ku goditet, pothuaj, çdo objekt i burgut, vdiqën 19 të burgosur dhe u plagosën 32 të tjerë.

Pjesa më e madhe e të burgosurve, natën e 21/22 majit 1999, do ta kalojnë nën qiell të hapur. Të nesërmen, diku rreth orës pesë të mëngjesit, të burgosurit urdhërohen të rreshtoheshin për dy, kinse do t'i transferonin në *Burgun e Nishit*. Tani, sipas urdhrin, të burgosurit formuan rreshtin për katër. Ishte llogaritur se me këtë rresht, efekti i ekzekutimit do të ishte më i madh. Dhe, ende pa u rreshtuar mirë, shpërtheu një breshëri gjuajtjesh me automatikë,

snajperë, minahedhës, bomba dore dhe mitraloza. *Ploja e 22 majit 1999* zgjati pak minuta të llahtarshëm. Në këtë plojë ranë martirë mbi 60-80 veta dhe rreth 200 të tjerë u plagosen rëndë e lehtë.

Meqë të burgosurit, pengje shqiptare për kusuritjen me *NATO*-n dhe me *UÇK*-në, nuk kishin kah t'ia mbanin, u grumbulluan brenda dhe jashtë ndërtesës së *mensës* dhe të *ambulancës*, ku mendonim se ishin më pak të ekspozuar. Në ambulancë e sollën edhe ndonjë të plagosur, por ky numër ishte i vogël pasi pjesa dërmuese e të plagosurve rëndë mbetën të shtrirë në fushën e sportit, midis të të vdekurve. Në këto rrethana të jashtëzakonshme dolën mjaft sakrifikues dhe i tërhoqën të gjithë ata të cilët nuk mund të largoheshin vet. Të plagosurit u vendosën në katin përdhes të anës së djathtë të *pavijonit C1*, përgjatë tërë korridorit, pastaj në dhomat e atij krahu dhe në *sallën e TV-së*.

Atë ditë, më 22 maj 1999, para së të errësohej, nga dera e hyrjes së burgut depërtoi brenda në oborr të objekteve një grup mbi 10 veta të maskuar, të uniformuar dhe të armatosur me automatikë, bomba dore dhe minahedhës. Ata shtinë gjithandej frontalisht me armët që kishin, kurse në puseta, ku kishte edhe të burgosur të fshehur, hedhën nga dy bomba dore. Me predha minahedhësi shtinë në drejtim të pavijoneve e sidomos të *mensës*. Pasi vranë e plagosën edhe disa të burgosur, do të largohen prapë jashtë mureve të burgut.

Duke paraparë rrezikun se ata prapë mund të ktheheshin dhe të masakronin edhe të plagosurit, u vendos, nga të burgosurit, të organizohej vetëmbrojtja në *pavijonin C1*, që së paku t'u jepej kuraje të plagosurve. Me të zbardhur dita e 23 majit 1999, njerëzit me maska hynë prapë brenda mureve, madje kësaj radhe ishin edhe më të organizuar. Sulmuesit ishin me maska dhe me uniforma të ndryshme: të *ushtrisë*, të *policisë*, të "*paramilitarëve*" dhe të të *burgosurve*. Duket se kishin njohuri për fortifikimin në *pavijonin C1*, ndaj aty nuk mësyn. Bilanci i këtij krimi ishte 30 të ekzekutuar nga afërsia. Sulmi i parë me bombe dore, u bë në ambientet e ngrohtores. Nga kjo runde e krimit nuk pati shumë të plagosur, sepse të gjithë u qëlluan me plumb në ballë, në gojë, në kokë, në zemër - nga afërsia e dorës.

Pas pak minutash, ekzekutorët e maskuar urdhëruan që të burgosurit t'i linin pavijonet dhe të hynin të gjithë në *Sallën e sportit*, me "*arsyetimin*" se do të transferohen në një burg tjetër. Mirëpo, askush më nuk u besonte. Në pritje të vdekjes dëgjonin gumëzhimin e aeroplanëve të *NATO-s* mbi *Dubravë*. Dhe, meqë *NATO-ja* nuk po godiste, të maskuarit pas një konsultimi të gjatë që bënë jashtë sallës, sollën "*sihariqin*": "...kemi menduar t'ju dërgojmë në burgje tjera, por autobusët që duhej të vinin për t'ju marrë kanë hasur në një urë të prishur nga bombardimi i sotëm, ndaj deri të nesërmen do të jeni këtu...!".

Nuk u besohej, por duhej pritur, pasi edhe ashtu s'kishte rrugë tjetër. Pas tërheqjes së kriminelëve, të burgosurit i tubuan të plagosurit e asaj dite, i bënë bashkë me të tjerët, në *Sallën e sporteve*, dhe vazhduan kujdesin për ta. Kështu, në natën e 23/24 majit 1999, përveç rreth 150 vetave që kishin plagë më të lehta dhe kishin shkuar me shokët nëpër pavijone, në sallën e sportit *ishin 106 të plagosur rëndë*, të pa lëvizshëm.

Të nesërmen, më 24 maj 1999, ndodhi befasia: të gjithë të burgosurit do të transferohen në *Burgun e Lypjanit*. Në oborrin e *Burgut të Lypjanit* kordoni i gardianëve dhe i paramilitarëve të uniformuar ishte përgatitur paraprakisht për të ushtruar dhunë fizike ndaj pengjeve shqiptare. Këta gardianë i udhëhoqi drejtori i burgut të Prishtinës - Lypjanit, oficeri *Luba Qimburoviq* në uniformë ushtarake. Të burgosurit fillimisht i rreshtuan në oborr. I nisen për në dhomat e pavijoneve 2, 3 dhe 4, duke i rrahur me shufra gome, shqelma dhe grushte. Njësoj do të veprohet edhe me trimat që bartnin 106 të plagosurit rëndë, për në *pavijonin nr.1*, duke mos i kursyer as të plagosurit e shtrirë mbi batanije. Kjo dhunë fizike çnjerëzore u bë shkak për vdekjen e tre të plagosurve, po atë ditë, më 24 maj 1999, në *Burgun e Lypjanit*.

Kushtet jetësore në këtë burg ishin kriminale. Dhunë psikike e fizike, mungesë e plotë e ushqimit. Pas 17 ditësh, pikërisht më 10 qershor 1999, pra të nesërmen nga nënshkrimi i *Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake në Kumanovë*, midis Komandës së NATO-s

dhe *Komandës Supreme të Ushtrisë Jugosllave* (Serbisë), ndodhi transferimi i të burgosurve shqiptarë - pengje të luftës në burgjet e Serbisë.

Sipas të dhënave të sistematizuara nga përjetuesit e masakrës, të cilët ushtruan ndihmën e parë për të plagosurit, gjatë gjashtë ditëve sa zgjati *krimi* ndaj të burgosurve shqiptarë në *Burgun e Dubravës*, më 19-24 maj 1999, janë vrarë midis 150 - 165 të burgosur dhe 23 veta nga bombardimet e *NATO-s*, kurse janë plagosur mbi 200 veta, prej të cilëve rreth 120 rëndë. Ky është numër aproksimativ që del nga përlllogaritjet e përjetuesve të masakrës. Numrin e saktë të të vrarëve dhe të të plagosurve ka mundësi ta vërtetojë vetëm një gjyq ndërkombëtar i domosdoshëm, i cili do ta zbardhte krimin monstruoz, në një institucion të mbrojtur me ligjet ndërkombëtare, ende tabu e mbrojtur me heshtje institucionale vendore dhe ndërkombëtare.

Krimi Masakra e Dubravës, për nga përmasat dhe veçanërisht për nga përmbajtja e dhembshme, është padyshim njëra ndër tragjeditë më të tmerrshme që njeh historia e njerëzimit. Shumë njerëz gabojnë kur thonë se numri i të vrarëve në këtë masakër nuk mund të jetë argument i mjaftueshëm që ajo të radhitet në mesin e tragjeditë më të tmerrshme. Pikërisht ana përmbajtjesore është ajo që këtë tragjedi e veçon nga shumë tragjedi të tjera, më të mëdha në përmasën sasiore. *Masakra e Dubravës*, shënon jo vetëm kulmin e shfryrjes raciale shtazarake të një grupi të njerëzve ndaj një grupi tjetër, por veçanërisht

në natyrën juridike është argumenti më i fortë që dëshmon projektin shtetëror serb për gjenocid dhe etnocid ndaj shqiptarëve si dhe teknologjinë faktike të ekzekutimit të atij gjenocidi.

Kjo masakër është dëshmia më e fortë e implikimit të vetë shtetit serb në ekzekutimin e gjenocidit ndaj shqiptarëve, ndërkaq nga qarqet ndërkombëtare, qofshin ato edhe veriatlantike, është mbajtur dhe po mbahet edhe më tutje në heshtje, duke përfshirë këtu edhe heshtjen e pakuptueshme të institucioneve vendore të Kosovës. Madje koha po e vërteton se institucionet ndërkombëtare kanë bërë dhe po bëjnë të pamundurën që zbardhja e kësaj masakre të mos marrë përmasa të fushatës politike e juridike, ose mediale së paku.

Shteti serb ka ditur ta shfrytëzojë, shumë mirë, medialisht dhe politikisht sulmin e *NATO*-s ndaj burgut, duke e akuzuar *NATO*-n për gjoja sulme të qëllimshme kundër civilëve. Por, njëkohësisht me bombardimet shteti serb kreu pjesën më të madhe të vrasjeve barbare ndaj pengjeve shqiptare në *Burgun e Dubravës*, pikërisht duke qenë i bindur se masakra do të heshtej më pas nga vetë shtetet evropatlantike, për shkak të përfshirjes së tyre në vrasjen e të burgosurve pengje të pafajshme të luftës. Shteti serb ka pasur rezultate shumë pozitive në këtë aspekt, sepse, pas vendosjes së trupave të *NATO*-s dhe të pushtetit të *UNMIK*-ut në Kosovë, *Masakra e Dubravës* u hesht në pjesën më të madhe të mundshme, veçanërisht në planin juridik.

Këtu duhet të theksohet fakti se burgu i shkatërruar i *Dubravës* është njëri prej objekteve të para publike të Kosovës i rindërtuar përnjëherë pas luftës me mjete ndërkombëtare. Kjo nuk është bërë për shkak të domosdoshmërisë të nevojave juridiko-shtetërore kosovare për ringritjen e tij pikërisht në vendin e gërmadhës, dëshmi e prekshme kjo e masakrës, por u bë pikërisht për të fshehur atë dëshmi materiale të masakrës së projektuar dhe të kryer nga shteti serb, i cili kishte futur në grackë edhe vetë NATO-n.

Ky është fakt i pamohueshëm. Mirëpo, derisa kjo heshtje politike ndërkombëtare për *Masakrën e Dubravës* mund të kuptohet, heshtja politike rreth kësaj masakre, nga ana e institucioneve të Kosovës, nuk mund të kuptohet assesi. Vërtet, asnjë institucion i Kosovës, i dalë nga vota e popullit, nuk ka bërë, deri tashti, as dhe përpjekjen më të vogël që kjo masakër të ndriçohet nëpërmjet ndonjë projekti juridik hulumtues dhe shkencor historiografik, apo qoftë edhe nëpërmjet ndonjë fushate publike mediale. Përkundër, është hetuar një solidarizim i pakuptueshëm i institucioneve vendore dhe të atyre ndërkombëtare për heshtjen dhe për fshehjen sa më të madhe të mundshme të kësaj tragjedie.

Dhe, duhet të thuhet qartë se për sa kohë që *Masakra e Dubravës* nuk do ta thyejë heshtjen politike dhe për sa kohë që kjo *masakër* nuk do të insticionalizohet juridikisht në përmasat dhe përmbajtjen reale të saj, bota nuk do ta marrë vesh

kurrë se çfarë loje përbindëshi ka luajtur shteti serb në *Ballkan*, veçanërisht në tokat shqiptare në pesëmbëdhjetë vitet e fundit të “*Jugosllavisë*”. *Masakra e Dubravës* shënon një veçanti juridike nga masakrat e tjera ndaj civilëve në Kosovë. *Burgu*, gjithkund në botë është pronë e drejtpërdrejtë e shtetit dhe administrohet nga *Ministria e Drejtësisë*. Në rastin konkret, *Burgu i Dubravës* ka qenë pronë e ministrive serbe dhe jugosllave të *Drejtësisë*, të cilat kanë qenë përgjegjëse për jetën e pengjeve. Meqë masakra ka ndodhur nga po i njëjti shtet dhe po nga e njëjta ministri e tij e drejtësisë, nuk është aspak e vështirë që të dihen me emra e mbiemra të gjithë ata serbë, duke filluar nga krerët e shtetit e deri te gardianët e burgut dhe vetë të burgosurit serbë. Fajtorët të sillen para drejtësisë, me akuzën e qëndrueshme juridikisht, për masakër të paramenduar ndaj pjesëtarëve civilë të një populli tjetër.

Kjo masakër e projektuar dhe e ekzekutuar nga vetë institucionet legale të shtetit serb, është dëshmia më burimore se kur është në pyetje tentim likuidimi i fizikumit të qytetërimit shqiptar, gjegjësisht gjenocidi dhe etnocidi ndaj tij, nuk kanë qenë regjime të caktuara serbe, por ka qenë vetë shteti serb me mekanizmat e tija legalë, të cilat e kanë ekzekutuar masakrën.

Së këndejmi, institucionet e Kosovës, në radhë të parë *Qeveria* dhe *Kuvendi i Kosovës*, paraprkisht duhet që nëpërmjet procedurave të rregullta, ligjshmërisht ta shpallin *Burgun e Dubravës - Kamp i*

instaluar i përqendrimit të periudhës së Luftës Çlirimtare të UÇK-së. Këtë kërkesë arsyeton tretmani çnjerëzor serb i ushtruar ndaj pengjeve shqiptare aty, në vitet 1998-1999. Po ashtu duhet të shpallen për kampe përqendrimi, të instaluara ose provizore edhe burgjet dhe hapësirat tjera publike në Kosovë, në të cilat, në formë të organizuar, janë vrarë, torturuar dhe dhunuar pengjet shqiptare, nga vetë shteti serb.

Vërtet, derisa institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare do të vazhdojnë ta mbështjellin me heshtje politike këtë tragjedi, bota nuk do ta kuptojë drejtë mesazhin e shenjtë të lirisë, të pages dhe të drejtësisë, kurse *Masakra e Dubravës* do të vazhdojë të mbetet ndërgjegje e vrarë kombëtare dhe ndërkombëtare. Të themi qartë: Në asnjë mënyrë nuk guxon që heshtja politike e *Masakrës serbe në Burgun e Dubravës* të mbetet, edhe më tutje, kompromisi më antinjerëzor i ndërtimit dogmatik të multietnicitetit në Kosovë, në favor të relativizimit të krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve. *Burgu i Dubravës*, në një të ardhme të shpejtë, të lirohet nga funksioni i tanishëm dhe të shpallet *muze i një tragjedie* të rëndë dhe shumë ëmblematike.

Sugjerimet e lartshënuara, bazohen në faktin se *gjenocidi i kryer nga Serbia në Kosovë, gjatë Luftës Çlirimtare të UÇK-së*, aktualisht trajtohet vetëm nga aspekti i pasojave statistikore e jo nga aspekti përmbajtjesor, i cili duhet ta definojë fajtorin e vërtetë, qoftë atë kolektiv apo individual, për të dëshmuar ekzistimin e një projekti shtetëror serb për

zhdukjen fizike të qytetërimit shqiptar në Kosovë, në mënyrë që të mos lejohet, edhe më tutje, relativizimi i krimeve shtetërore serbe ndaj shqiptarëve vetëm në nivele të përgjegjësisë individuale, qoftë ai edhe Milosheviq.

Së fundi duhet të theksojmë se *Çështja e Kosovës* gjatë tërë historisë ishte faktikisht, dhe është aktualisht, pjesa piemontale e çështjes shqiptare, pra *çështje ekzistenciale kombëtare shqiptare, paqe ballkanike dhe evropiane* - po u zgjidh drejt. Në funksion të kësaj zgjidhje *institucionet e Kosovës, UNMIK- u, SHBA-të, Evropa dhe KS i OKB-së* duhet ta kenë parasysh konstatimin e *Prokopit të Cezaresë* (mesi i shek. VI), i cili në përmasa gjeniale ka konstatuar: *"Siç tregon historia e vjetër, sllavët janë të gatshëm të marrin armët edhe pa pasur arsye (...), e bëjnë luftën pa shkak dhe pa e shpallur atë dhe nuk duan ta mbarojnë me një marrëveshje. Më në fund e fillojnë pa të drejtë dhe e mbarojnë me dhunë".*

Vërtet, nga këto pak të dhëna që u përmenden mund të përfundohet: Midis serbëve dhe shqiptarëve qëndron një det gjakshqiptari, i derdhur nga thika serbe. Mynxyrat ndaj qindra mijëra familjeve gjithandej Kosovës historike, reaalisht nga viti 1811, kur një hordhi serbe prej 300 vetash masakroi familjen tridhjetanëtarëshe të *Demë Ahmetit në Mavriq të Kryellapit*, deri në qershorin e vitit 1999, janë prova dhe kujtesë trishtuese. Faktet historiografike tregojnë se nuk ka vëllazëri shqiptare në pjesën e *Shqipërisë Etnike* jashtë *Shqipërisë*

londineze, por edhe të atyre në viset kufitare të “*Shqipërisë*” me “*Jugosllavinë*”, në kufijtë ndërkombëtar londinezo-versajas nëpër tokat pastër shqiptare etnike, që nuk kanë përjetuar vrasjen dhe dhunën kanibaliste serbe.

Dhe, nëse historia është mësuesja e jetës, siç besohet nga latiniteti, *Çështja e statusit shtetëror të Kosovës*, në pritje, nuk mund të zgjidhet duke i mbyllur sytë para 188 vjet krimi e etnocidi institucional serb, malazias, grek e bullgar mbi shqiptarët në përgjithësi dhe shqiptarësinë e Kosovës në veçanti. Serbia, veçanërisht, nga janari i vitit 1878 deri në qershor të vitit 1999, pra për 121 vjet rresht, përveç dëmit material të pallogaritshëm, është përgjegjëse për copëtimin e Shqipërisë dhe për jetën e rreth *tre milion shqiptarëve*.

Në këtë krim janë bashkëfajtores Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe Rusia, sepse me zgjidhje të dhunshme në Ballkanin jugperëndimor, duke e ndarë një vend dhe një komb vetëm pse fati ia ngarkoi të mbijetojë si mysliman, krijoi kriza që gjeneruan në gjakderdhje, gjenocid, kulturocid dhe etnocid shekullor ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë historiko-etnike.

Ky është pengu që *Kosovën* dhe *Serbinë* i detyron të mbesin njëra pranë tjetrës dhe kurrë më së bashku nën një çati shtetërore të përbashkët. Dhe, nëse faktori ndërkombëtar i vendosjes aktualisht ngulë këmbë për rilidhjen me dhunë të jetës shtetërore të Kosovë me Serbinë, pa vullnetin e shumicës etnike

historikisht të Kosovës, do të bëhet shkaktar i gjakderdhjeve të reja ndëretnike në Kosovë dhe gjetkë në tokat shqiptare, të copëtuara me dhunë ndërkombëtare.

Se *Serbia* dhe *serbët* nuk mund ta durojnë ekzistimin e kombit shqiptar, se *Serbia* dhe *serbët* janë degjenerik racist antishqiptar përtejmesjetarë, se *Serbia* dhe *Shqipëria* duhet të kufizohen me kufijtë etnikë si ardhmëni e vetme e Ballkanit *ortodokso* - "*islam*" - dëshmi e prekshme është "*notesi*": 29 maj 1968 - 14 shtator 2004, i akademikut monstruoz, Dobrica Qosiq - "*Kosovo. Biblioteka Istine, Knjiga broj 1*", Beograd, 2004, ISBN 86-7446-038-0, fq. 257. Del se nuk ka rrugë të drejtë tjetër, pos dënimit ndërkombëtar të *Serbisë* dhe pranimit të së drejtës ndërkombëtare për vetëvendosjen politike dhe shtetërore të shqiptarëve në shtrirjen natyrore etnike kompakte.

Shteti i shqiptarëve në kufijtë e *Shqipërisë Etnike* nuk është *Shqipëri e Madhe*, gogol serbo-ruso-evropian antiislam të *periudhës së imperializmit*, por është më pak se dy të tretat e *Shqipërisë (Albania, Arnautlluk)* të shekujve XV-XIX - *islame, ortodokse dhe katolike*. Pra, është vetëm pjesa e *Shqipërisë* e vaditur me gjakun shqiptar pa dallim feje deri në ditën e sotme, e ruajtur edhe me mëshirën e Zotit.

Shkretërimi i asaj që mund të quhet *shqiptarësi* aty ku shkeli këmba e soldateskës serbe në tokat shqiptare - janë prova. Veçanërisht dhuna dhe dhunimi, plojat dhe masakrat mbi civilët e

pambrojtur, burra, gra, pleq e fëmijë anakënd Kosovës, nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999, periudhë kjo e *Bombardimeve të NATO-s* mbi makinerinë ushtarake të Serbisë, janë plagë të prekshme që vazhdimisht kullojnë gjak. Mbi tre mijë shqiptarë as në jetë as me varre në duar të serbëve - për ta mposhtur *UÇK-në* partnere të *NATO-s* – janë plumb në zemër të shqiptarëve. Mbi të gjitha, *Masakra serbe në Burgun e Dubravës ndaj të burgosurve shqiptarë, prej datës 19-24 maj 1999, përmasat e vërteta të së cilës ende nuk i dimë, është provë midis provave se Serbia me dorën e vetë e ka vrrarë dhe e ka kallur pjesën serbe, pikërisht atë koloniale, në Kosovë.*

Në *Librin* që keni në duar keni kornizën e denoncimit të krimit për një aktakuzë të një gjyqi ndërkombëtar kundër gjenocidit të Serbisë në Kosovës gjatë historisë, të vulosur me krimet mbi shqiptarësinë e Kosovës në periudhën e bombardimeve të *NATO-s* mbi makinerinë ushtarake e policore serbe më 24 mars-10 qershor 1999.

SERBIAN MASSACRE IN THE PRISON OF DUBRAVA 19 – 24 MAY 1999

Scientific Session, on 23 May 2004

Summary

Serbian platforms on carnages and massacres over Albanians date back since the period of Serbian state building. They were inaugurated by Voyvoda *Milos Obrenovic*, by an order in 1832: *To give "25 stick beats" to any Albanian or Bosniak that will be caught in the Serbian Principality*, and in 1834 he used the military *"to burn their villages"* and *"city quarters"*, since Albanians and Bosniaks were put into the national movement for their liberation from the *Ottoman Empire* and the liberation of *Albania* and *Bosnia* would become a barrier to *new expansions of Serbia*.

Hence forth all *Serbian expansions into Albanian lands* were done by using carnages and massacres upon the Albanian population. This strategy was institutionalised by a political and legal platform of the Serbian national state "*Nacertanie*" in 1844, which stated: *"Serbia should make its efforts to pull out only stones from the Turkish building one by one and obtain whatever possible from this good material to build on again the ancient and good foundation of Ancient Serbian Empire and erect its new own Serbian state"*.

Actually, in the period of *Eastern Crisis* from the beginning of 50-s of 19th century and to the *Russian-Turkish War in 1877-1878*, an entire

Christian world (European and Russian) will dirt itself with Albanian blood. Then, Serbian historiography has never hidden the order of *Prince Milan Obrenovic* on Serbian paramilitary and military forces: "*The more Albanians you can expel, the higher your merits will be for the country....!*" This order had the power of a Serbian Law for ethnocide against Albanians. With its strategy of "*a burnt land*" the ethnic cleansing of Albanians took place from more than 640 Albanian villages and towns of the Sanjak of Nis.

European Aeropagus – *The Congress of Berlin* (13 June – 13 July 1878) awarded the genocide of Orthodox Christians of the neighbouring countries of Albania, recognising them the right to about *24,458 km² of Albanians' lands*. The annexed regions were de-Albanised according to the strategy of "*the burnt land*", expelling by dreadful forceful ethnocide about 250 – 300 thousand ethnic Albanians. After international bloodshed partition in 1878, *The Ethno-cultural and Geopolitical Unit of Albania*, separated into four administrative and military Ottoman units, had a surface of 90,100 – 90,270 km² with 3,804,000 residents, more than *three million of whom were Albanians*. At that time, *The Vilayet of Kosova* had a surface of 32,900 km² with more than 1,270,000 residents. The current territory of Kosova, of

10,887 km², had only around 3.7 per cent Serbs in 1912, although *Jovan Cvijic* speaks of 5 per cent.

In 1912, a general uprising of Albania under the leadership of *Hasan Prishtina* marked a decisive turn to the autonomy of Albania. To prevent this Albanian victory, Russia put the *Balkan Alliance* onto the war, under the slogan: "*A War to liberate the Christian population from the Turkish many-century occupier and from Islamic Tyranny...*" Accordingly, since the Albanian population constituted around 88% of the Muslim religious people, the war of the *Balkan Alliance* was in fact a Serbian and Greek Orthodox and Slavic cultural-ethnocide, ethnocidal and genocidal anti-Albanian enterprise by the support of Russia and Europe.

Any Albanian resistance would be extinguished by bloodsheds, carnages and massacres awarded by Russia and Europe, similar to those in 1877-1881, of the resistance of the *Albanian League of Prizren*. This fact was indicated clearly at the proclamation in Albanian written in Cyrillic: "*To all tribes in Albania, you brothers!*", of General *Božidar Janko*, addressed to Albanians immediate after the Serbian military stepped on *Merdare and Prepalac*, on 18 October 1912: "*We shall shoot on those who will shoot on us, and God help us, we shall turn into ashes a house or village that turns arms against us...*"

This Serbian platform on carnages on Albanian being in historical Kosova was legalised internationally by a public request of the Prince of Serbia, *Aleksije Karadjordjevic*, as soon as he stepped on the Albanian land in the regions of Kumanovo: *"I wish to come here several thousands of European people of responsibility and see the Albanians, who we caught ad war captives, and they could become convinced that the people can hardly be called human beings and be convinced that the Balkans should be cleansed from these wild beings..."*

The victory of the *Balkan Alliance* was crowned at the *Ambassadorial Conference in London*, by which *61,510 km²* and more than *three million* residents in majority Albanians were detached from the Albania of 1912. *The London Conference* approved the project of the *"Albanian Principality"*, on 29 July 1913, as a monstrous state, without a full body, too much crippled, without any limb for living. This state could have a surface of about *28,760 km²* with around 800 thousand residents.

Serbian, Montenegrin, Bulgarian and Greek occupiers in 1912/13, exerted cultural-ethnocide, ethnocide in Albanian lands similar to that in 1877-1881. Three contemporary persons threw light on the platform of this state of emergency. The Serbian military man *Dimitrije Tucovic*, a socialist, informing the public about the Serbian crimes in an Albanian village in Luma, now in Albania, wrote in 1913,

“The village was extinguished in two hours, with the scenes that are difficult to imagine. Platoons attacked women carrying breast-sucking babies (...), approximately 500 souls were liquidated within two hours (...), dead bodies were put into houses and the houses were burned down – in order to hide the crime tracks. This is the truth about the horrible wildness”.

This picture is more complete if the statement of the socialist M. Kaclerovic is added to it - *“The Serbian Army set fire to 35 Albanian villages, without allowing the residents to get away from there (...). The Serbian Army massacred 120 thousand Albanians on its government order”.* According to systematised data by the Italian scholar A. Baldacci, - *“there were some 150 thousand Albanians killed by Serbs in 1912-13”.*

In fact, the source data indicate clearly that during the *Balkan Wars* and *the First World War* in the areas of *ethnic Albania*, besides the number of the killed people mentioned above, by the strategy *“the burnt land”*, 800 Albanian localities were ruined down and more than 500 thousand Albanians were expelled to Asia and elsewhere. Similarly, from December 1918 to the close of the *Versailles Peace* – in Paris, in 1920, Serbian-Yugoslav cannibalism was exerted in Albanian areas. According to the data of the *Headquarters for the War of the Movement or Freedom of Albanian Lands*, included in the *Proclamation of early November 1945*, *“in 1918, during the creation of the mosaic Yugoslavia,*

again according to the order of Belgrade, thousands of Albanians were slaughtered and killed. At that time, a register of eighty thousand victims was brought to the Conference of Peace, followed by an energetic protest, but this was also, as always, 'Vox clamantis in deserto' to the ears of Europe.

From the documents of Albanian origin, sent to the *Conference of Versailles*, it can be seen that the number of Albanians in Albanian ethno-cultural and geopolitical regions in 1912, ran below the number of Albanians in the 50-s of 19th century. Only 1,779,929 residents (833,000 in the area of the *London Conference Albania* and 946,929 of them in *Albanians' lands annexed to Yugoslavia and Greece*) were *Ethnic Albania* in the area then. It comes out that between 1912 and 1920, the number of Albanians in *Ethnic Albania* was reduced for over 1,220,000 residents and this without the *natural increase of three million Albanians*, as many as there were in 1912.

Albanians, being mainly a Muslim population, were further presented by Serbian pseudoscience before the Christian anti-Islamic world, as an amorphous mass decomposed from the spiritual and civilian aspects, without a national prospective, dignified for assimilation into Serbs, as a civilian act. Due to this objective, Serbian anti-Albanian propaganda had an unreserved support by certain European circles. Here is an obvious

example: *Herman Vendel, in 1920 and 1921, would present Albanians as a "Balkan semi-wild rudiment population, dangerous for European civilisation" and Serbian genocide upon Albanians would be justified as a necessary measure of "Christian civilisation", since, according to him, "history cannot stand a threat of millennium years (...) of a race dying out..."!?!*

Extinction based on this Serbian platform for culture-ethnocide, ethnocide and genocide against Albanians continued for a long period of time in the Yugoslavia of Versailles. This was the Serbian strategy "*the burnt land*", with clear pretences: "*To change the physiognomy of the areas purely inhabited by Albanians*" – would read the Yugoslav socialist press. According to the actions of *L. Trocki* in the place of bloodshed events, in Kosova in the 20-s of 19th century: "*There existed a labour division. In case it had to do with some displaced persons, their houses were first destroyed by the regular military. Then came reserve forces in turn, which performed their part of the job. After them came the police members and finally committee members*". This strategy was implemented in the same way in 1999.

That this objective was carried out by the blessing of Europe, can be proved by the sole pronunciation of the Yugoslav representative to the *League of Nations* in Geneva, on 13 March 1929, who would tell lies without making any sign on his face: "*In our southern regions, which were constitutive parts of our*

state, or were given to our Kingdom before 1 February 1913, there are no national minorities"!! This is the moral of diplomacy and Serbian occupying gene.

In the function of Serbian platform on de-Albanisation of Albanian lands parallel to carnages exerted upon Albanians was also the behaviour of the Slavic element in their lands. This fact was reflected by an anonymous person from Peja to the JCP publication, "*Proleter*", on 15 December 1929: "*We, Albanians are forced to build houses for colonists. We are obliged to purchase the rope with which they are going to hang us (...). They are burning a series of villages in order to make place for colonists. With guns, gun machines and bombs they are sending away thousands of Albanian families from their own hearths*". In this spirit was stated, on 15 September 1931, also in the publication "*National Freedom*" of Geneva: "*Almost a million people are expelled by the greater-Serbian power*" and that "*the names of people and villages are turned into Serbian ones by means of knives, so that any Albanian evidence would disappear, any ethnic character of Kosova would change*".

With such aspirations they continued ethnic cleansing of the Albanians of Kosova in the 30-s. In 1937 even Serbian academic, political and military circles requested that within a very short deadline *the percentage of Slavic element – Serbian and Montenegrin - in Kosova should rise to 67.5%, and the percentage of Albanians from 80% to go down to 21.5%*. There were

complaints to the orders of local police and administration in Kosova: *"Southern Serbs are not devoted to proper attention. If that becomes a Serbian place the Yugoslav issues will be solved"*. To reach this, it was required to remove another 400 thousand Albanians from Kosova to Turkey, and parallel to 143 thousand Serbian and Montenegrin colonists that were brought to 1937, to be brought another 470 thousand colonists of Slavic origin.

Serbian academicians, writers, university professors, gathered to "Serbian Cultural Club" in Belgrade were put to the service of these plans. However, the *Elaboration* of academician Vasa Cubrilovic: *"Iseļjavanje Arnauta"* (The Expulsion of Albanians), of 7 March 1937, is the *most dreadful project known in the history of cultural-ethnocide, genocide and ethnocide* exerted on an entire people, which would remain unobserved and unpunished by the civilised world, by Europe!?! It was précised in this project: *"To recapitulate: It is impossible to extinguish the Albanians only by permanent colonisation (...).The sole manner and sole means – for the extinguishing Albanians and Albanian being from Kosova – is a rude force of an organised state power, which we were convinced of"* in 1878/79.

Actually, it is impossible to reflect here the whole complexity of a cannibalistic Slavic cultural-ethnocide, genocide and ethnocide between the *Two*

World Wars against Albanians, and all the manners of resistance for Albanians' survival against such violence cannot be reflected either. The *Yugoslav Military Headquarters*, evaluating that civilian and police power could not manage to extinguish the Albanian population in the regions annexed to the Yugoslavia of Versailles, in 1938 they required from the *Military Ministry* that *breaking the Albanians should be left on the competence of Serbian and Montenegrin elements and military, which means: to chetnik paramilitaries supported by military*, and it précised: "*Our military will have the duty, similarly to the present one, and particularly now, to carry out its state duty and national and cultural mission in these regions*".

On the eve of the *Second World War*, a great barrier for extinguishing the Albanians in Yugoslavia was presented by the existing of the *London Conference Albania* as a state, so by the end of 1938, *Yugoslavia* would propose to *Greece* and *Italy* an alliance for the division of *Ahmet Zogu's Albania*, by what there would be created circumstances for physical disappearance and assimilation of Albanian surplus into Serbs, Greeks and Italians: "*There has never been a sympathy for Albanians among our people, neither earlier nor nowadays. They have been seen as enemies of our country and our people. In our political and diplomatic combinations and our Balkan policy, we have always aimed at turning down all Albanians' demands for the*

establishment of an independent state, due to the simple fact that such a state could be created against us and against our national objectives."

On this Serbian *anti-Albanian* platform was erected the *Elaborate* of the academician and Nobel-prize winner *Ivo Andric*, on 30 January 1939: "*With the occupation of Albania the attraction centre of Albanian minority in Kosova would disappear, which would, in a new situation, be assimilated much more easily.*" According to the Serbian Academic directives, the Yugoslav diplomacy against the Albanian being in *historical Kosova* would be based on the killing of Albanian personalities - "*as if they were wild animals!*" This Serbian state strategy for extinguishing the Albanians was pictured well by the Montenegrin communist colonist, *Radovan Zogovic*, a lifelong friend of Albanians: "*The greater-Serbian power does its utmost to put out the law and extinguish the Albanian residents by economic pressure, police education, by cutting off medical assistance against malaria etc.*"

It was said above that by the sources of the provenience of the *League of Nations* it can be proved that there were 946,929 *Albanians* in the Yugoslavia of Versailles in 1920. According to natural growth of 4 *per cent*, that Albanians had up to 1941, the number of Albanians in Yugoslavia would reach to more than *two million*. Accordingly, it comes out that the Serbian-Yugoslav power between the *Two World*

Wars liquidated and expelled more than a million Albanians.

The Nazi-fascist occupation of the Albanians outside the *London Conference Albania*, from mid April 1941, although it came as some *infusion to the Albanian being* in agony, it did not resolve the *Albanian issue*, and the *National-Liberation Anti-Fascist War*, parallel to other peoples of *Yugoslavia* was used for Serbian, Montenegrin and Bulgarian-Macedonian re-annexing of Albanians' lands outside the *London Conference Albania*. Actually, the time proved that Tito's *Declaration* before an English war reporter, on 4 December 1943, that "*the future of Kosova would be decided by a plebiscite and the borders would, if necessary, be corrected to the benefit of Albania*", was a betrayal trap to the Albanian anti-Nazis liberators, the same as the *Resolution of the National-Liberation Council of Kosova* of 2 January 1944, in which was included the vital political demand of Albanians:

"Kosova and the Dukagjin Plain is a province inhabited by the Albanian majority population, who as always wants to join Albania. The only way for the Albanian population of Kosova and the Dukagjin Plain to join Albania is the common war with other peoples of Yugoslavia against the Nazi-bloody occupiers and their servants, as this is the sole way to win freedom, when all the peoples, then Albanians as well, will be able to declare of

their own fate with the right to self-determination and to separation.

The warrant to this is the Yugoslav National-Liberation Army (YNLA) and Albanian National-Liberation Army (ANLA), which are closely connected. Apart from this, guarantee is obtained also from our great allies: the Soviet Union, England and America (The Atlantic Chart, the Conference of Moscow and Teberan)".

